

M. FETHULLAH GYLEN

Nga fara te lisi

(Edukimi familjar nga një këndvështrim tjetër)

M. FETHULLAH GYLEN

Nga fara te lisi

(Edukimi familjar nga një këndvështrim tjetër)

Tiranë, 2012

© Shtëpia Botuese "Prizmi"

M. F. GYLEN: Nga fara te lisi

(Edukimi familjar nga një këndvështrim tjetër)

Titulli i origjinalit turqisht:

M.F. GÜLEN : Çekirdektekden Çınara

(Bir Başka Açıdan Ailede Eğitim)

E përktheu nga origjinali: Dr. Mithat Hoxha

Redaktor : Arian Dodona

ISBN : 978-99927-944-3-7

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

PËRMBAJTJA

Hyrje	
1. Botëkuptimi ynë mbi moralin.....	
2. Shkaqet e shembjes së popujve.....	
3. Të imitosh kombet e tjera	
4. Krijesë e nderuar	
5. Sundimi i Kishës dhe klerikalizmi në Perëndim	
6. Marrëdhëniet shtet-fe në Islam.....	11
7. Parimet morale	11
8. Të jetosh një jetë të planifikuar dhe me parime	13
9. Moral i lartë.....	15
10. Stolitë e jetës së kësaj bote	15
11. Të jesh i mëshirshëm.....	16
12. Njerëzimi i gradës së përsosur.....	17

PJESA E PARË

Martesa	21
1. Edukata familjare.....	21
2. Rëndësia e folesë familjare.....	24
3. Qëllimi i martesës	25
4. Kushtet e martesës.....	26
5. Debatimi i argumenteve	30
6. Parimet e krijimit për martesën	34
a) Hapi i parë i çdo mbarësie: Bismil'lah	34
b) Zgjedhja e bashkëshortit/es	36
c) Rritja dhe përgatitja e fëmijëve të mirë.....	38
7. Vlera e lartë e nënës	42

PJESA E DYTË

Familja	47
1. Çfarë familjeje?	47
2. Prindër dhe fëmijë	52
3. Detyrat e kryetarit të familjes	53
a) Masat para lindjes së fëmijës	54
i) Fara e pastër	54
ii) Ushqimi duhet të jetë hallall.....	55
b) Mësim dhe edukim.....	57
c) Ndjenja e përgjegjësisë në edukim.....	58
d) Të jesh përherë një mbështetës i mirë	60
4. Përgjegjësia e nënës dhe babait.....	62
a) Ruajtja e drejtësisë mes fëmijëve.....	65

- b) Fëmijët duhen trajtuar me seriozitet 69
- c) Përfitimi i ndjenjës së bindjes 69
- d) Një edukim hap pas hapi..... 70

PJESA E TRETË

Delikatesë në edukim	75
1. Sëmundja e banalitetit.....	76
2. Detyra e gruas	78
3. Cilësia mbi gjithçka	78
4. Detyrat ndaj fëmijës	80
a) Përgatitja e mjedisit të edukimit	80
b) Ushqyerja e fëmijës me gjëra hallall	80
c) Mbrojtja nga syri i keq.....	81
d) Rregullimi i mjedisit familjar	81
e) Sistemimi i dozës së dashurisë	82
f) Shembulli i mirë	83
g) Edukimi i fëmijëve me ndjenjën e vlerësimit dhe tëdashurisë për Allahun	84
h) Tregimi me qëndrim ose komunikimi pa fjalë.....	85
i) Dhembshuria.....	87
j) Autoriteti.....	88
5. Pajisja me moralin e Allahut	89
a) Edukata e të folurit	89
b) Masa në bujari dhe në dhembshuri	90
c) Shpërblimi.....	91
d) Përgatitja e fëmijës për të ardhmen.....	92

PJESA E KATËRT

Edukimi fetar i fëmijës	99
1. Përgatitja e fëmijëve të shumanshëm	100
2. T'i ambientojmë fëmijët me xhaminë që kur janë të vegjël	101
3. Mënjanimi i pikëpyetjeve qysh në fillim.....	102
4. Të falemi dhe lutemi në një mjedis ku të mund të na shohë fëmija.....	103
5. Respekti për Kuranin	106
a) Të mos shkaktojmë neveri	109
b) Kryerja e rregullt e adhurimeve të detyrueshme, madje më tepër	111
c) Ndjenja e nderimit për simbolet e shenjta	113

PJESA V

Si duhet treguar?	119
1. Shembulli personal	120
a) Nxënësi, mësuesi dhe prindërit.....	121

b) Klithma e të rënëve në perversitet	122
c) Rruga për në xhenet dhe xhehenem	123
2. Kuptimi i leximit	124
a) Leximi dhe shkrimi.....	125
b) Dituria të çon te frika ndaj Allahut	127
c) Heqja e mëdysheje.....	127
3. Tregimi për Profetin dhe kohën e Tij	129
4. T'i njohësh të tjerët me Kuranin, duke u folur atyre sa më shumë për Të	132
5. Të flasësh për ringjalljen.....	133

PJESA E GJASHTË

Dimensionet e edukatës	137
1. Vepra e mirë duhet paraqitur bashkë me punën e mirë	137
2. Përfitimi nga shkencat e natyrës për edukimin fetar .	139
3. Përgatitja e një mjedisi të mirë.....	140
a) Zgjedhja e shokut	141
b) Ta bëjmë fëmijën të thithë një atmosferë fetare të sinqertë dhe ta mbajmë larg nga dyfytërsia	142
c) Zgjedhja e personave dhe mjediseve për të krijuar lidhje	142
d) Zgjedhja e programeve televizive që do të shohë fëmija juaj	143
e) Rritja e fëmijëve me edukatë Kuranore.....	144
4. Vazhdimi i ndjeshmërisë në edukim.....	145

PJESA E SHTATË

Krahasimi mes edukatës kuranore dhe jo-kuranore	151
1. Edukata dhe edukimi jo-kuranor	151
2. Edukata kuranore.....	155

PJESA E TETË

Pasthënie

me fragmente të zgjedhura nga “Kriteret ose Dritat e Krugës”	161
Fëmija.....	161
Martesa dhe foleja familjare	162
Prindërit.....	165
Edukata dhe i riu.....	166

Përmbajtja.....	171
------------------------	------------

Hyrje

1. Botëkuptimi ynë mbi moralin

Mendoj se më parë duhet të merremi vesh me lexuesin mbi një sërë çështjesh, sepse mendoj që, nëse nuk merremi vesh mbi një sërë çështjesh themelore, nuk do të jetë e lehtë që ai të përfitojë nga ky libër. Me të vërtetë, duke trajtuar çështjet mbi edukimin në familje, a mund të arrihet marrëveshje me ata që nuk shqetësohen nga grumbulli i madh i imoraliteteve që përjetohen sot në të katër anët e vendit tonë, në fshat e në qytet, në mjedisin e jashtëm e në familje?

Ç'është e drejta, ç'mund të thuhet nëse ne jemi të kënaqur me gjendjen dhe nëse fëlliqësitë e mjedisit tonë nuk na prekin? A mund të mendohet se diskutimi mbi çështjet morale do të ketë ndonjë dobi nëse nuk na dridhet zemra përballë rrënimit moral të fëmijëve, nipërve e mbesave apo të të afërmeve e fqinjëve tanë?

Historia na tregon se asnjë shoqëri nuk ka përparuar dot me anë të imoralitetit. S'e di a ka ndonjë përjashtim kjo, por nuk ka dyshim se popujt që kanë mundur të mbeten për një kohë të gjatë në këmbë pa u rrëzuar nga historia, janë ata që kanë respektuar siç duhet vlerat morale!

2. Shkaqet e shembjes së popujve

Kur u hedhim një sy qytetërimeve të kaluara, shohim se shembja pothuajse e të gjithave ka lidhje me një brejtës moral. Disa herë mund të mos ndjehet asgjë ndërsa vlerat e shoqërisë gërryhen nga poshtë heshturazi me anë të imoralitetit. Ndërkaq, kur ta ndjejmë, çdo gjë do të ketë marrë fund, ashtu siç nuk e kuptojmë se jemi sëmurrur nga kanceri gjersa të ketë lëshuar metastaza gjer në pikat tona më të ndjeshme. Asisoj, që kur e marrim vesh, udhëtimi për matanë ka kohë që ka nisur...

Ashtu siç është kanceri është rrënues për trupin e njeriut, edhe imoraliteti është rrënues për jetën e popujve. Nëse drejtuesit e shtetit, pastaj kryetarët e familjeve, edukatorët dhe shoqëria janë mospërfillës ndaj një shthurjeje morale të tillë, kombi shembet me zhurmë e potere pa e marrë vesh kush këtë gjë, e pa i rënë askujt në sy gërmadhat. Kush e di, mbase disa, ashtu si qeniet që strehohen nën gërmadha, e shohin këtë si diçka të natyrshme, duke menduar se ja, kjo qenka jeta!

Po, nëse do të zbresim në shkaktarët më të mëdhenj të shkatërrimit të popujve, do të shohim se kanë qenë të njëjta: bohemizimi i të rinjve dhe, në këta shpirtra të shkujdesur, dëshira për përjetimin e ndjenjave shtazore, shtënia pas ndjenjave epshore, cilësimi i kësaj jete si synim, ndërkohë që nxitet harrimi i tjetrës, të përtejshmes. Largimi nga Allahu dhe kthimi i shpinës Kuranit, fshirja nga zemrat e ndjenjave të frikës dhe ndjeshmërisë për ta lidhur çdo gjë vetëm me lëndësoren e saj.

Gjer te osmanët, të gjitha këto elemente janë të pranishme në shembjen e shumë shteteve. Mbi vorbullat e krijuara nga boshllëqet moralo-shpirtërore është shkuar me interesa materiale që do t'i harbonin më keq, duke hyrë sakaq në një rreth vicioz. Kurse lëngata buronte ngaqë populli e kishte humbur botën e tij shpirtërore, ishte larguar nga Kurani dhe parimet islame, e kishte harruar Allahun. Atyre që kërkonin shpëtim për lëngatën e ndjenjave, u ofrohej shpëtim nga burimi i lëngatës! Kurse çështja qëndronte ndryshe: nëse njërën anë të njeriut e përbën ajo çka është materiale, e kësibotshme, anën tjetër, madje esencën e tij, e përbënte dhe e përbën kuptimi dhe bota tjetër, e përjetshmja. Pika e thyerjes ishte e qartë: çdo gjë buronte nga shtënia pas formës dhe nënvleftësimi i kuptimit, përmbajtjes. Dhe mbyllja e një mangësie të tillë përsëri me lëndën apo materien ishte e pamundur. Në fakt, po të trajtoheshin të dyja së bashku dhe sipas dimensioneve të veta, domethënë, po të zbatohesh drejtësia (e drejta) e Allahut sipas madhësisë së vetë Allahut, po të pranohej e drejta e Kuranit po në atë masë, po t'i jepej vlerë botës sa dimensionin e saj dhe përjetësisë sa përjetësia, çdo gjë do të gjente ekuilibrin e nevojshëm.

Kurani shprehet: *“Kërkoje vendin e përjetësisë me atë që të ka dhënë Allahu (duke e shpenzuar në udhën e Tij), por mos e harro as pjesën që të takon nga kjo botë!”*¹. Po, duhet përgatitur për jetën e pasme duke i vlerësuar shëndetin, vitalitetin, pasurinë dhe mendjen të favorizuara nga Allahu, por duke mos e harruar edhe pjesën që i takon nga kjo botë! Ky është kriteri i Kuranit. Nëse ekuilibri botë-përjetësi do të rregullohej sipas këtij parimi, ndoshta nuk do të shkatërroheshim dhe merreshim nëpër këmbë gjer në këtë masë. Ja pra, kur në ditët tona, gjërat materiale të tërheqin më së tepërmi kah vetja janë të shumta, individit privohet nga kujtimi i Allahut, është e domosdoshme që, duke e zhvilluar çështjen e edukimit në familje, para së gjithash, të përcaktohen specifikat që do të çonin drejt një marrëveshjeje mbi parimet moralo-etike.

Çdo komb ka pasur ngritjen dhe rënien e tij. Kombi është lartësuar me anë të parimeve lartësuese dhe është përmbysur me anë të faktorëve rrënues. Sepse ligjet e natyrës veprojnë brenda një detyrimi të kushtëzuar. Edhe natyrën si një pjesë të gjithësisë, Allahu (xh.xh.) e ka krijuar formalisht të varur nga këto ligje të detyruara. Prandaj duhet respektuar ligjet e natyrës dhe argumentet e krijimit. Nëse duke pasur siguri në mirëkuptimin e tyre, krijoni të meta në një sërë detyrash tuajat, atëherë rrezikoni të shkatërroheni, madje të eliminoheni prej tyre. Ato janë ligje që nuk të falin. Allahu ju fal, por ligjet dhe argumentet e krijimit, e thënë ndryshe, ligjshmëria e krijimit, është diçka që nuk të fal kurrë. Po qe se metoda përcaktohet drejt sipas këtyre ligjeve, Allahu ju ngjit në shtresën më të lartë qiellore, por nëse shkaqet respektohen me mangësi (kur nuk bëhet fjalë për një trajtim të veçantë), ju rrëzon në gjendjen më të fëlliqur që mund të mendohet për qenien njerëzore.

Nëse do t'i kthehemi problemit të kreut, duhet t'u gjejmë përgjigje këtyre pyetjeve: A jeni të bindur se ekzistojnë disa faktorë seriozë dhe disa shkaqe objektive që çojnë në prishjen e moralit? A mendoni me të vërtetë se ka një vorbull morali? Kjo jetesë e trazuar aktuale, a është një imoralitet apo shfaqje e një gjendjeje normale?

3. Të imitosh kombet e tjera

Profeti bujar, Muhamedi (s.a.s.) duke ia tërhequr vëmendjen bashkësisë së tij në lidhje me gjendjen e popujve të shembur për shkak të shthurjes morale, ka thënë:

*“Do ta ndiqni hap pas hapi, gjurmë pas gjurme, metër pas metri, rrugën e paraardhësve tuaj...”*²

Në shembjen e shoqërive që përjetojnë rrënim moral, vihen re çrregullime të tilla, si mashtrimi prej kësaj bote, pamundësia për të ngritur ekuilibrin trup-shpirt dhe paaftësia për ta përcaktuar veten. Për fat të keq, ky defekt ka filluar qysh në thellësi të historisë, është përcjellë gjatë epokave nga brezi në brez, dhe mandej, Perëndimi e ka trashëguar këtë të keqe, dhe duke e stolisur me fantazira qytetërimi, ua ka përcjellë ndjekësve apo imituesve të vet. Prandaj, hadithi i mësipërm konsiderohet i mrekullishëm.

Këtu nuk do të kaloj dot pa prekur edhe një çast tjetër të veçantë: kur i shohim disa vende dhe njerëzit e tyre, na duken, nga mundësitë materiale, në mirëqenie e të lumtur dhe pandehim se i kanë kapërcyer të gjitha problemet. Mirëpo njeriu përëndimor është gjithnjë jo i qetë; ai kërkon qetësi e lumturi, por gjithsesi nuk i gjen dot. Së pari, përqindja e vetëvrasjeve në Perëndim është shumë më e lartë se në çdo vend tjetër. As nuk mund të mendohet se mund të jetë i lumtur një popull a një komb, njerëzit e të cilit vetëvriten, qofshin ata meshkuj ose femra!

Në një konferencë me temë familjen në Islam, të zhvilluar në Rabat, nën titullin “Sistemimi i familjes”, bëhej e ditur se në Amerikë, përqindja e çifteve të divorcuara ishte 40%. Sot kjo shifër mund të jetë rritur. Mes popujve të degjeneruar në botë, Amerika duket si më e ekuilibruara. Meqë është e ndjeshme në çështje të caktuara, mund të quhet se s'ka hyrë plotësisht në falsitetet e Perëndimit. Megjithëkëtë, edhe atje gjendja është aty-aty.

4. Krijesë e nderuar

¹Shih Kuran, Kasas: 77. Të gjitha interpretimet nga Kurani në këtë tekst janë të autorit.

²Buhari, *i'tisam*, 14; *enbija*, 50; Muslim, *ilm*, 6.

Çdo gjë duhet t'i kushtëzohet vetëm për lumturinë e njerëzimit. Njeriu është mëkëmbësi i Zotit mbi tokë dhe qendra e vëmendjes së Tij. Allahu e ka rregulluar gjithësinë për njeriun dhe sipas tij. Nisur nga kjo, edhe qytetërimet duhet të jenë për njeriun dhe në çdo qytetërim, synimi i tij duhet të jetë njeriu. Së pari, njeriu është qenia më e respektueshme. Kurani thotë:

“Pa dyshim, ne e bëjmë njeriun të nderuar e të respektuar. I bartëm ata (me anë të mjeteve të ndryshme) në tokë e në det, i furnizuar ata me gjëra nga më të mirat dhe, ndërkaq, disa prej tyre i lartësuam ndaj shumicës.”³

Këtë të vërtetë të Kuranit, shejh Galibi e thekson kështu në një dyvargësh të tij:

Shihe mirë veten tënde, që je i zgjedhuri i gjithësisë ti,

O njeri, bebja e syrit e gjithësisë je ti.

Po, në vështrimin e Allahut, njeriu është një qenie e nderuar. Të gjitha qytetërimet, të gjitha sistemet politike, ekonomike e kulturore s'janë gjë tjetër veçse një akt më vete i pranimit të vlerës së tij. Nga ky këndvështrim, pa u vënë si synim lumturia e njeriut, sistemet e ngritura nuk kanë asnjë vlerë dhe nuk premtojnë asgjë për njerëzimin!

5. Sundimi i Kishës dhe klerikalizmi në Perëndim

Në këtë çështje, ndërmjet Islamit dhe botës perëndimore mund të vërejmë një dallim të rëndësishëm. Ndërsa në Perëndim, me përparimin e shkencës, u shemb mbretërimi i Krishtërit dhe i klerikalizmit, në botën islame, përkundër Perëndimit, me përparimin e shkencës është shtuar edhe orientimi kah feja.

Në Evropën para Rilindjes dhe Reformës, nën sundimin e Kishës, mbi individët zbatoheshin taksa të rënda. Përballë ligjeve përherë në ndryshim të Kishës, secili ishte i shqetësuar, i paqetë dhe me tërë frikë për të nesërmen.

Ndër liderët shpirtërorë kishte një armiçësi serioze ndaj shkencës. Ata nuk tregonin asnjë lloj mirëkuptimi ndaj zbulimeve shkencore. Të gjitha zbulimet shkencore dhe shpikjet kundërshtoheshin dhe hidheshin poshtë pa lëkundje, pa u hedhur një kundrim në përmbajtjen e tyre. Dhe nuk ishte aspak i paktë numri i atyre që Inkuizicioni i dënonte rëndë për shkak të zbulimeve apo përfundimeve shkencore që ata arrinin.

Njerëzit nuk kishin se ç'të thoshin para këtij botëkuptimi shtypës. Si rezultat i shtypjes së ushtruar mbi të gjithë njerëzit, me përjashtim të disa aristokratëve, veçanërisht mbi të varfrit, i mohimit absolut të të drejtave të femrës, madje i një koncepti të tillë, i shfrytëzimit të punës së femrës në disa vende pune, duke i konsideruar ato si gjysmë njeri, për pasojë, duke i paguar me gjysmë page, lindi një zemërim ndaj fesë, pothuaj në çdo klasë shoqërore.

Ja, si rrjedhojë e kësaj antipatie të përgjithshme, në vende të ndryshme, me anë të lëvizjeve reformiste, u shemb çdo gjë që kishte të bënte me kishën dhe, ndërsa kisha shembej nën veprimin e kësaj tronditjeje, edhe vlerat morale shtriheshin përtokë.

6. Marrëdhëniet shtet-fe në Islam

Në botën islame nuk ka ndodhur asnjëherë që të përbuzet një njeri i ditur. Në Islam kurrë nuk është bërë fjalë mbi shtypjen e fesë mbi shtetin apo mbi popullin. Në çdo kohë, forca ka qenë nën urdhrin e të drejtës, kurse drejtuesit, në shërbim të popullit. Para një fjale të thënë në emër të së drejtës, mund të përgjunjeshin edhe sundimtarët, duke treguar kështu se sa e rëndësishme ishte e drejta për ta..

Edhe kalifët e nderuar si Omeri dhe Aliu (r.a.) mund të dilnin para gjykatësit si palë e akuzuar nga një hebre! Sajë faktit që forca shfaqej në anën e së drejtës, kurrë nuk pati ndodhur ndonjë përcudnimi së drejtës në atë masë që pati ndodhur në perëndim. Për rrjedhojë, askush nuk kishte ndonjë pakënaqësi apo zemërim ndaj fesë. Jeta e kërkuar nga të tjerët nëpër utopi, ekzistonte në këtë botë si realitet.

7. Parimet morale

³Isra: 70

Çfarë shohim si të mirë e ç'shohim si të keqe? Si duam që të na rriten fëmijët? A ka në këtë drejtim ndonjë plan dhe projekt të përgatitur për t'u realizuar?

Si mendojmë ta rrisim djalin? Pasi themi se, "kështu dua ta shoh djalin tim", ç'bëjmë për ta arritur këtë? Si e vështrojmë faktin që ai e kalon kohën jashtë gjer në orët e vona të natës? Dhe, a do t'ia hapim derën, vallë a do ta përqafojmë pavarësisht se në ç'orë kthehet në shtëpi?

Ç'gjë e pranojmë dhe gjer ku e pranojmë? Çfarë quajmë *moral* dhe ç'gjë mund ta konsiderojmë si të pamoralshme? Ç'gjëra i shohim me sy të mirë e ç'gjëra i shohim me sy të keq?

Deri ku do t'i lejojmë fëmijët tanë? A do të kemi një parim për ndërhyrjen në veshjen dhe pamjen e jashtme të tyre?

Nëse s'jemi të kënaqur prej tyre, ç'kemi menduar gjer tani? A i jemi drejtuar ndonjë zgjidhjeje? Në rrugën e kërkimit të zgjidhjes, në sa dyer trokitëm, sa specialistë pyetëm, sa pika loti derdhëm? Kjo çështje që na intereson ne, mund t'i interesojë edhe një të afërmi, një fqinji ose edhe krejt kombit, mirëpo a ia përveshëm krahët ndonjë kërkimi për të?

Po s'patëm ndonjë llogari, ndonjë plan rreth kësaj çështjeje, do të thotë se, ashtu siç shprehet Profeti (s.a.s.), s'kemi bërë e s'bëjmë gjë tjetër veçse të ndjekim hap pas hapi, madje qorrazi, paraardhësit tanë, duke u zvarritur saora drejt gropës ku ata vetë ranë. Në fakt, në themel të të gjitha këtyre qëndron nënshtrimi ndaj dëshirave dhe pasioneve tona, duke i lënë mënjane Allahun, të Dërguarin e Tij dhe parimet e shenjta të Kuranit.

Sot, pothuaj të gjithë kanë nga një fëmijë për të cilin ankohen pak a shumë. Ç'mendojmë vallë, ne, para një sërë zigzagesh që bën ai? Edhe vetëm mendimi është shumë i rëndësishëm. Sigurisht, në një mënyrë a në një tjetër, patjetër jemi të detyruar të mendojmë! Duke u kthyer nga vetvetja, duhet të përqendrohemi mbi pyetjen: "Vërtet, ç'mund të bëjmë ne në këtë drejtim?" Natyrisht, edhe veten duhet ta gjykojmë nëse jemi të mirëkuptueshëm, të ashpër apo mospërfillës, nëse gjërat që na ngajnë në shtëpi, mjaftohemi t'i shohim në një pandjeshmëri dhe heshtje të vdekuri, apo çdo ditë kërkojmë nga një zgjidhje të re.

Këto pyetje mund t'i shtojmë edhe më tej. Për shembull, a bëjmë ne përpjekje për ta ndjekur nga pas fëmijën tonë, për t'i njohur ata me të cilët ai ka lidhur shoqëri? A mundemi ne t'i përgatisim atij çdo herë një mjedis të mirë? Me ç'miq e kemi njohur atë deri më sot? Po s'e patëm njohur ne, me kë shëtiti dhe ku kalojnë kohën? A është e mjaftueshme vetëm ta regjistrujmë në shkollë, apo t'ia dorëzojmë një mësuesi; apo ta regjistrujmë në një kurs Kurani? Ose, a është e mjaftueshme vetëm t'i tregojmë xhaminë, e ta njohim me imamin e saj?

Është shumë e rëndësishme, që krahas këtyre pyetjeve të ndërthurura me njëra-tjetrën, krahas kërkimit të përgjigjeve për to, të tregohet kujdes edhe ndaj rregullsisë, thellësisë, sinqeritetit, vendosmërisë në jetën tonë, si dhe sa ajo na tërheq ne.

8. Të jetosh një jetë të planifikuar dhe me parime

Është shumë me rëndësi që, qysh në krye, të mund ta shohim dhe vlerësojmë jetën tonë si një tërësi parimesh, dhe ta jetojmë atë si të tillë. Po, të mund të themi: "Këtë vit e kam bërë plan kësaj, vitin tjetër, kështu, ndërsa vitin më pas, kështu", etj.. Kur të mund të themi kështu, do të përballemi vazhdimisht me një sërë të njohurash të projektuara e të planifikuara, do të jemi të aftë të vendosim më me lehtësi dhe s'do të hutohemi kurrsesi. Por po të mos kemi një sërë principesh dhe planesh për të ardhmen, duhet të bëhemi gati që qysh nesër, që ashtu të hutuar, të zvarritemi nëpër një batac të panjohurash. Mendoni sikur ky grumbull të panjohurash t'ju bjerë menjëherë përsipër. Ka shumë mundësi që do t'u bini gjunjëve me pëllëmbë e do të rënkoni me dëshpërim, kur, në fakt, për të gjitha këto duhet të keni vendosur ende pa dalë në shesh.

Tani, duke dalë mbi sipërfaqen e të gjitha këtyre gjërave, le t'i hedhim një vështrim gjendjes miliarda myslimanëve. Dhe shohim se janë duke u djegur bashkë në të njëjtin oxhak dhe në të njëjtin zjarr me flakët gjer në qiell edhe ati, edhe biri, dhe se të dy e shohin njëri-tjetrin në indiferentizëm dhe moskokëçarje të plotë. Ndërsa një komb apo disa kombe janë duke u zhytur, me sytë çelur, e duke e parë njëri-tjetrin, në të

njëtin llum, ata që vijnë nga pas, krejt si një turmë e verbër, janë duke u zhytur, pa parë as majtas as djathtas, po aty dhe janë duke rendur drejt mjerimit, duke mbetur ndër mendje si një kujtim i padëshiruar...

Me forcën e Tij të mrekullueshme të shprehjes, Profeti ynë (s.a.s.) na tërheq vëmendjen dhe na paralajmëron kështu:

“Do ta ndiqni hap pas hapi, gjurmë pas gjurme, metër pas metri, rrugën e paraardhësve tuaj...”⁴

Nga kjo shprehje e Tij mund të nxjerrim paralajmërimin: “Merrni mësim, kini kujdes, ecni sikur të ecnit në truall të minuar, dhe tregohuni përherë të matur me frikën se në çdo çast mund të përballeni me një shpërthim!”

Le t'i nënvizojmë këto vargje prekëse të të ndjerit Mehmet Akif në përshkrimin e botës islame:

*Cipa është zhveshur e ka rënë: kudo një pafytyrësi që...
Ç'fytira të shëmtuara mbuloka një perde e hollë!
S'ka më besë, fjalë të dhënë, amaneti-fjalë pa rëndësi;
Gënjeshtër shkon; tradhtia, duhet; të drejtën s'e njeh njeri.
Zemrat, pa mëshirë; ndjenjat, të ulta; qëllimet, të përvëllojnë;
Kuptimi i dalë nga vështrimet të tjerët i nënvleftëson.
Mendjet rrëqethen, o Zot, ç'përmbysje e frikshme ka ngjarë:
As fe s'ka mbetur, as besim; besimi bërë dhé; feja, gërmadhë!
Krenaritë le të vlojnë, ndërgjegjet të ngecin në belbësi...
Ndërsa ky rrënim moral përparon, s'mbetet pavarësi!*

Jo vetëm në një vend, kudo grindje dhe rrënim moral, aq sa edhe ata që janë të shqetësuar prej kësaj, nën ndikimin radioaktiv të tij, të pandjeshëm, ngjan të mos dinë asgjë!

9. Moral i lartë

Profeti (s.a.s.) thotë kështu: “Unë jam dërguar vetëm për të plotësuar moralin e lartë!”⁵ Dhuntitë e jashtëzakonshme të Zotit për ne dhe mundësitë tona që mund t'i zhvillojmë. Po, ne jemi të pajisur me mundësi të atilla që të mund të zëmë vendin tonë mes banorëve të botës së lartë. Njohja e Tij është domosdoshmëri e respektit tonë ndaj vetes sonë të pajisur prej Tij me shumë e shumë të mira potenciale. Librat hyjnorë janë zëri dhe frymëmarrja e këtij mesazhi; profetët, përfaqësuesit më të drejtë të kësaj të vërtete, kurse hallka e fundit e vargut të artë të profetëve, Muhamedi (s.a.s.), prova më e shkëlqyer e kësaj të vërtete dhe sovranit më i shquar i moralit të lartë.

Mbi këtë gjerësi dhe thellësi të personalitetit të Tij, Kurani shprehet kështu:

“Pa dyshim, ti qëndron mbi një moral të lartë!”⁶ dhe “Ky është morali i të dërguarve të ardhur para teje!”⁷.

10. Stolitë e jetës së kësaj bote

Duke u shprehur si më poshtë, Kurani, thekson se, në kuptim të përgjithshëm, pasuria dhe fëmijët janë stoli dhe madhështi e jetës së kësaj bote, duke na kujtuar se nuk mund të nënvleftësohen. Ndërkaq, këta janë aspekti material i kësaj bote, pra që zbehet, prishet e që të shqetëson:

“Pasuria dhe fëmijët janë stolitë e jetës së kësaj bote, kurse gjërat e pavdekshme, punët e mira, kanë më shumë vlerë te Zoti yt dhe janë të denja për ta lidhur shpresën pas tyre!”⁸.

Kjo do të thotë se pasuria e kësaj bote nuk është diçka me të cilën duhet të krenohemi. Në vetvete, as fëmija nuk është një gjë me të cilin do krenuar. Vetëm në jetën tjetër, do të arrijnë vlera mbi vlera, nëse kthehen kah Allahu, duke u futur sakaq në radhën e gjërave të mira, e që mbesin gjatë. Dhe, nëse kënde

⁴Buhari, *i'tisam*, 14; *enbija*, 50; Muslim, *ilm*, 6.

⁵Ibn Abdilberri, *et-tehmid* 16/254; Bejhakiu, *es_sunnetul kubra*, 10/191.

⁶Kalem: 4

⁷Shuara: 137

⁸Kehf: 46

janë vetëm në madhësinë e një fare, në jetën tjetër bëhen pemë madhështore me degët gjer në qiej, që u rëndojnë nga frutat!

Këto specifika që u përpoqëm t'i shtjellojmë, janë specifika jetëdhënëse, që si principe të parashtruara nga Kurani për ne, përcaktojnë njëkohësisht rrugën dhe mënyrën më të drejtë të të jetuarit. Këto ndodhen vetëm në barnatoren e lartë të Kuranit dhe brenda sistemit të thurur me duart mirësi dhe begata të të Dërguarit të Madh (s.a.s.) dhe të përfaqësuar prej Tij. Kurse kthimi i zbulesës hyjnore në vesh të thirrjes së lartë të Sunetit dhe marrja jetë prej tij është veçse një çështje përkatësie.

11. Të jesh i mëshirshëm

Si në shembullin e Ejubit⁹ (a.s.), Kurani nënvizon domosdoshmërinë e mbështetjes së njerëzve të mëshira e Allahut përballë problemeve të ndryshme. Po, të mbështetesh në mëshirën dhe bamirësinë e Tij, do të thotë edhe të kërkosh ndihmë për veten, familjen, fëmijët që i ke nxjerrë në jetë dhe të afërmit, edhe të pranosh dhe pohosh, duke shpallur dobësinë tënde, se është pikërisht Ai që e zotëron çdo gjë. Veçanërisht, mëshira është shkas për mëshirë. Po të jesh i mëshirshëm, edhe Allahu të mëshiron. Po të tregohesh i ndjeshëm ndaj prishjeve dhe dekompozimeve, edhe Ai i merr në mbrojtje gjërat që prishen.

Profeti (s.a.s.) na porositi: *"Kini mëshirë për ata që ndodhen në tokë në mënyrë që banorët e botës së lartë – ose Allahu – të kenë mëshirë për ju!"*¹⁰

Vdekja dhe fatkeqësitë e vërteta nuk janë ato që vijnë nga një aksident trafiku, e të ngjashme. Vdekja dhe fatkeqësia më e madhe janë humbja e botës ndjesore. E keqja më e madhe është të mos e shohësh dot zjarrin që të ka rënë brenda në shtëpi, të mbetesh i pandjeshëm ndaj fëmijës që po të ikën dore!

Nëse nëna dhe babai s'dinë gjë për zjarrin shpirtëror brenda shtëpisë së tyre, atëherë nuk ka fatkeqësi më të madhe se kjo, moskokëçarje më të madhe se kjo, perversitet më të madh se ky! Edhe sikur njerëz të tillë të zënë të qajnë, të ulërijnë e të çirren për hallin që u ka rënë mbi kokë, është me vend, megjithëse për të qarë duhet sërish ndjenjë!

12. Njerëzimi i gradës së përsosur

Dekadencia morale është ndoshta fatkeqësia më e frikshme. Prandaj mendoj se parimet morale të Kuranit janë burimi i shërimit më me rëndësi për njerëzit që përjetojnë sot një krizë morale. Kurani thotë: *"Ne e krijuam njeriun në formën më të bukur, pastaj e shtymë atë në nivelin më të ulët!"*¹¹

Ky ajet duhet kuptuar kështu: Ne në fillim e bëmë njeriun të merituarin e krijimit të përsosur, pastaj e shtymë atë në zgripin më të ulët të krijesave, domethënë në atë gjendje që të luftojë vazhdimisht me vetveten, që, edhe nëse herë pas here rrëzohet, të ngrihet përsëri me anë të besimit e të punëve të mira për të fluturuar në nivelin më të lartë të të qenit njeri!

Ky ajet na jep neve krahë për t'u ngjitur në nivelin më të lartë të të qenit njeri. Po, na jep krahë për t'u ngjitur lart ndërsa jemi rrëzuar, ndërsa na ka pushtuar moskokëçarja, apo jemi rrokullisur në nivelin e qenieve më të ulta, duke qenë se jemi të dobët e të paaftë!

⁹Enbija: 83

¹⁰Tirmidhiu, *birr*, 16; Ebu Davud, *edeb*, 58.

¹¹Tin:4

PJESA E PARË

Martesa

Martesa

1. Edukata familjare

Në kreun pararendës u rrekëm që të mendoheshim pak thellë-thellë në disa çështje tejet të genësishme, në të cilat duhet të arrijmë medoemos marrëveshjen. Këto çështje, mbi të cilat është detyrë e gjithsecilit që të qëndrojë e të mendohet, u trajtuan më tepër në trajtën e pyetjeve, si: “Cili është mendimi ynë i përgjithshëm për gjendjen e sotme të botës? Si i vlerësoni ndodhitë e fundit përreth? Cili do të jetë reagimi ynë ndaj ndodhive që janë jashtë kufijve të moralit?”

Nëse s’jemi të kënaqur nga gjendja e sotme e botës, nëse disa gjëra aspak të mira na ngulen në shpirt si heshtë, nëse s’jemi të kënaqur prej atyre që e kanë përgatitur këtë mjedis, e që pastaj i kanë sendërtuar të gjitha këto gjëra, cilat janë zgjidhjet dhe propozimet tona? Sigurisht, është e domosdoshme që ne t’i dimë të gjitha këto!

Edhe nëse disa njerëz e quajnë si domosdoshmëri lirie ta nënvleftësosh namazin e të mos falesh, të të duket i rëndë agjërimi e të mos agjërosh, të vish vërdallë kot më kot rrugëve e të grindesh me këtë apo atë, njerëzit besimtarë i quajnë ato si imoralitet. Prandaj ne do të përpiqemi që të parashtrijmë se ç’janë morali dhe imoraliteti, ç’është edukata dhe ç’kuptojmë me të, duke i analizuar nën dritën e Kuranit dhe në kuadrin e parimeve të Tij.

Parimi më i rëndësishëm i moralit është besimi dhe marrëveshja për të besuar. Megjithatë, kjo marrëveshje s’është gjithçka. Nëse marrëveshja e besimit nuk mbështetet me vepra në jetën e përditshme, me veprimtarinë praktike, dhe njeriu nuk ndjek një vijë në përputhje me gjërat që beson, besimi tek ai mbetet thjesht një opinion, për rrjedhojë, siç nuk ushtron ndikim as në jetën personale të individit, as në jetën e tij familjare e shoqërore nuk ka për të ushtruar, e po ashtu dhe nuk mund të bëhet orientues për të. Ç’është e vërteta, ndërsa besimi është një dritë dhe burim force, mosbesimi është dobësi dhe zbrazëti. Besimi i vërtetë e vë në shesh forcën e tij me anë të veprimit. Nuk është parë ndonjë njeri që të mos ketë besuar, dhe të jetë bërë i dobishëm për shoqërinë e tij, ndërkohë që të dobishmit numërohen me gishta! Për shembull, dikush nuk beson, por është i ndershëm. Nuk e di nëse persona të tillë janë apo s’janë të virtytshëm mjaftueshëm sipas kriterëve tona themelore. Sepse virtyti i vërtetë është virtyti i bazuar në besim dhe ndjenjën e vetëllogarisë. Sigurisht, besimi te Allahu, ringjallja dhe jeta e mbrame, Xheneti dhe Xhehenemi janë elemente shumë të rëndësishme që na e formësojnë jetën dhe na japin mundësi të kalojmë një jetesë të rregullt.

Zbatimi i domosdoshmërive të këtyre specifikave të besuara ka një vlerë të madhe jetësore. Jeta e mbrame është gjyqi ku jepet llogari për ekzistencën në këtë botë, është vendi ku ne japim llogari nëse e kemi falënderuar apo jo Allahun që na krijoi në këtë botë si njerëz, duke na dhënë trajtën më të përsosur. Në këtë botë ka turma të tëra njerëzish të padrejtë e mosmirënjohës, të cilët këmbëngulin për të mos e kuptuar Zotin, për të mos i parë artet e Tij të përsosura që na i ka shtrirë dhe ekspozuar para syve, madje që i mbyllin sytë duke bërë sikur nuk i shohin tërë ato bukuri që duken ashiqare, si dhe shumë e shumë qorra, vuvë e të pandjenjë, pavarësisht nga mijëra ngjyra, tinguj, dekoracione, variante; pavarësisht nga rregulli dhe harmonia që na rrethon nga të gjitha anët! Ja pra, Allahu është Ai që do ta bëjë ringjalljen, grumbullimin dhe llogarimarrjen edhe për këta, edhe për besimtarët, dhe do t’i përgatisë Xhenetin dhe Xhehenemin e Tij. Njerëzit e mirë, e virtytshëm, që kanë jetuar të hapur ndaj jetës ndjesore e shpirtërore, dhe me dëshira ndaj gjërave të larta e sublime, pasi të japin llogari, ashtu siç të kenë jetuar në këtë botë si njerëz të lartë, të përsosur e të virtytshëm, edhe në atë botë do të shpërblehen me Xhenete të premtuara për njerëzit e virtytshëm.

Kështu, besimtar do të thotë, njeri që i mendon këto dhe që e rregullon jetën e tij sipas këtyre kriterëve. Prandaj, më së pari, besimi, kontrata besimore duhet të jenë shumë të shëndosha edhe te individi edhe te shoqëria në mënyrë që me anë të forcës së besimit të mund të ruhet orientimi përballë ndjenjave çorientuese dhe devijuese. Nuk ka bekim, dobi e perspektivë as në familjen, as në shoqërinë e formësuar prej individëve që herë duken se besojnë e herë se nuk besojnë. Gjithashtu as në kombin e formuar nga një shoqëri e tillë. Më së pari njerëzit duhet të besojnë shumë mirë, për më tepër duhet edhe të besojnë në mënyrë të prerë e të palëkundshme në të nesërmen e kësaj bote, pra në Ahiret ose ringjalljen

dhe jetën e mbrame në mënyrë që të bëhen të afërt ndaj Allahut si dhe elementë të vlefshëm për shoqërinë ku bëjnë pjesë.

Sigurisht, aq sa ç'është shumë e rëndësishme që çdo individ ta bartë frikën, se nëse nuk punon, do të mbetet pa ngrënë, është shumë e rëndësishme edhe që të ketë një besim aq të shëndoshë saqë të besojë pa lëkundje se, po të mos kryejë detyrat fetare, po të mos punojë dhe po të mos ta jetojë besimin siç duhet në praktikë, do t'i duhet të përballlet me një llogaridhënie shumë të rëndë para Zotit! Individi me një besim të tillë, me një fuqi tërheqëse gravitacionale të krijuar nga ky opinion, do të priret kah punët e mira dhe do të bëjë çmos për të dalë faqebardhë para Zotit!

Çështjen e familjeve të formuara prej individësh të tillë do ta trajtojmë në një pjesë më vete. Aspektet e ndryshme të familjes, faktin se si fëmijët duhet të edukohen me edukatën dhe moralin islam në familje, do t'i trajtojmë më tej nën dritën e ajeteve kuranore dhe disa haditheve profetike.

*"Fëmijët dhe pasuria janë stolia dhe zbukurimi i kësaj bote"*¹². Nëse vlerësohen siç duhet, janë edhe investim për në jetën tjetër. Me anë të këtyre, Allahu (xh.xh.) u jep gëzim zemrave të njerëzve me anë të tyre, duke i kthyer ato në stoli për syrin dhe ushqim për zemrën. Ai, duke i parë këto stoli, mund të ndjejë në praktikë lumturinë e kësaj bote dhe në shpresë, lumturinë e së përtejshmes. Por ç'e do që, po s'u dhatë përjetësi këtyre stolive, nuk mund të bëheni të lumtur; edhe po të bëheni, do të jetoni të mrrudhur. Patjetër, fëmija, nipi e mbesa, e gjithë bota juaj mund t'ju sjellë shqetësime! Por, nëse i përjetësoni këto gjëra të përkohshme e të asgjësueshme, duke i parë në emër të Krijuesit të gjithësisë, po i përdorët dhe i zhvilluat në rrugën e Tij dhe në drejtimin që do Ai, do të shihni se çdo çasti pandehur si fund është një fillim. E gjithë stolia e përkohshme dhe e asgjësueshme, madhështia, shkëlqimi dhe pompoziteti që marrin fund me mbylljen e jetës së kësaj bote, kur kjo të ketë arritur në pikën e konsumimit të plotë, do të shfaqen në trajtën më të përsosur e të mrekullueshme të tyre me hapjen e botës tjetër dhe për të vazhduar atje.

2. Rëndësia e folesë familjare

Përsosmëria e një kombi dhe një shoqërie nis nga familja, nga foleja familjare e ngritur nga bashkëshortët e lidhur dorë për dorë po për këtë qëllim. Nisur nga kjo, edukimi duhet filluar nga familja që të mbetet i qenësishëm. Nëse familja ngrihet mbi parime edukative, as për shoqërinë nuk mund të mendohet se mund të jetë me edukatë. Madje, edhe nëse një politikë arsimore-edukative e patëmetë është shumë e rëndësishme për formimin e njeriut ideal, familja do të vazhdojë ta ruajë rëndësinë e vet përse i përket kontributit të saj në edukimin e individit.

Po qe se mendjet e ushqyera mirë në familje, veçanërisht në periudhën e ushqyerjes së nënvetëdijeshme, nuk vihen nën goditjen e erërave të kundërta serioze, në të ardhmen, me anë të disa vërejtjeve të vogla, mund të na dalin para si heronj të trashëgimit nënvetëdijësor, duke na lënë sakaq të shastisur. Sigurisht, sukcesi në folenë familjare është etapa e parë e suksesit në vetë jetën në përgjithësi. Dhe kjo etapë varet drejtpërsëdrejti nga një martesë e shëndoshë.

3. Qëllimi i martesës

Familja nuk është fabrikë e prodhimit të fëmijëve, siç e mendojnë disa autorë. Familja është pjesa më jetësore e shoqërisë dhe embrioni i parë i çdo kombi. Për rrjedhojë, ajo s'është as inkubator, as mjet për të kënaqur dëshirat trupore që ka çdokush. Familja është një institucion i shenjtë. Kurse vija më e shquar e shenjtërisë së saj është kurora martesore. Kurorë martesore quhet bashkimi i çiftit me anë të një akti kontraktual në kuadër të parimeve të caktuara, pra një marrëveshje me qëllim të qartë. Allahu (xh.xh.) i sheh si adulter të gjitha bashkimet që s'kanë për qëllim parimet e kurorës martesore.

Bashkimin legal nën emërtimin "kurorë", feja e pranon si themelin, shtyllën, fundamentin e një kombi të mirë. Ndërkaq, edhe bashkimet legale e kanë një synim përfundimtar, ndaj të cilit janë të kushtëzuara. Meqë martesat spontane, pa kurrfarë qëllimi i cenojnë kufijtë e legjitimitetit, myslimani është, në këtë

¹²Kehf: 46

çështje, mjaft i ndjeshëm. Sigurisht, synimi i martesës duhet të jetë rritja dhe përgatitja e një brezi që aspiron të fitojë pëlqimin e Allahut (xh.xh.) dhe Profetit Muhamed (s.a.s.).

Martesat pa qëllim janë të pabegata ashtu si edhe adhurimet e bëra pa asnjë qëllim. Kur mungon synimi, bashkimet që i përngajnë një martesë të bërë me një person të panjohur, duke parë vetëm pamjen e jashtme të tij, pa u interesuar për fenë, besimin, etj., krahas mungesës së thellësisë sublimë, shpesh herë përfundojnë me mospuqje dhe pashkueshmëri ndër veti. Sidomos po të jenë bashkuar dy njerëz, nga të cilët njëri i beson Kuranit, kurse tjetri, jo; njëri e njeh Profetin (s.a.s.), e tjetri, jo! Po qe se bëhet fjalë për mendime të kundërta mes pjesëtarëve të familjeve lidhur me besimin, fërkimet besimore e ideore bëhen të pashmangshme dhe nxjerrin krye mospërputhje që janë të pamundura për t'u rikuperuar.

Po të mendohet gjerë e gjatë, "martesa me synim" është, krahas të qenit ndjesore, edhe racionale. Dhe në familje ka qetësi e kënaqësi kur në martesë veprohet duke u menduar synimi për të cilin po veprohet. Kurse në përfundim të martesave të bëra pa pasur një synim të qartë dhe pa u menduar përfundimi, shfaqen shqetësime nga më të ndryshmet. Në një fole të tillë, pjesëtarët e familjes jetojnë vazhdimisht të paqetë e të pakënaqur.

Feja, duke e konsideruar, nga njëra anë, martesën legale, e duke e nxitur atë kësodore, nga ana tjetër, e kufizon çështjen brenda kornizës së synimit. Fundja, në çdo punë dhe sjellje të njeriut duhet të ketë një synim të caktuar, në mënyrë që njeriu të jetë i vendosur në iniciativat që do të marrë dhe hapat që do të hedhë dhe të përpiqet për të arritur në atë synim. Po qe se njeriu nuk ndjek një synim të caktuar, as veprimtarinë e tij nuk e rregullon dot dhe kurrë nuk arrin në ndonjë finalizim. Është e vërtetë se, po qe se në veprimet dhe sjelljet tona nuk ndjekim ndonjë synim, mendohet se edhe shansin për sukses e kemi humbur në një masë të konsiderueshme!

4. Kushtet e martesës

Çështjes së martesës feja i jep rëndësi më shumë se sa mund të merret me mend. Paralel me këtë, edhe juristët islamë që e kanë trajtuar kurorën si një çështje të rëndësishme, kanë shkruar vëllime të tëra rreth saj duke qëndruar posaçërisht mbi të. Juristët e kanë ndarë kurorën në kategoritë *detyrim* (farz), *domosdoshmëri* (vaxhib), *traditë* (sunet), *ndalim*, *shkelje* (haram) dhe *papëlqyeshmëri* (mekruh) si dhe e kanë kushtëzuar pak edhe me gjendjen specifike të çdo personi. Kjo do të thotë kështu: Askush nuk mund të martohet si t'i vijë për mbarë; personi i ardhur në një nivel të caktuar, është i detyruar të martohet; madje, ndërsa martesa e disave është *domosdoshmëri* (vaxhib), martesa e disa të tjerëve, për shkak të gjendjes së tyre të posaçme, është e *papëlqyeshme*, e shëmtuar (mekruh).

Gjithsesi, vetëm duke mbajtur parasysh kuadrin fiziologjik e material të njeriut, kuptohet pa mëdyshje se ai që martohet, do t'i përftojë shoqërisë një familje ose një fëmijë.

Nga juristët islamë, ata që janë hanefi dhe maliki konsiderohen të afërt me njëri-tjetrin lidhur me këtë çështje; dallimet mes tyre kanë të bëjnë më së tepërmi me hollësitë. Po qe se do ta parashtronim çështjen e martesës sipas përcaktimeve të këtyre juristëve të mëdhenj islamë në vijat kryesore, do të na dilte parasysh një klasifikim i tillë si më poshtë:¹³

a) *Martesa e detyrueshme (farz)*

Personi që ka rrezik të bjerë në adulter dhe, përgjithësisht, në situata të ndaluara fetarisht (haram), e ka të detyruar (farz) të martohet nëse ka mundësi ta paguajë garancinë e kurorës (mahr) dhe të sigurojë mjetet për mbajtjen e familjes. Sipas disave, duhet të martohet edhe nëse nuk agjëron dot (me qëllim për të mposhtur dëshirat seksuale).

Me fjalë të tjera, martesa për të mos rënë në faj (haram) është parim, dhe martesa duhet të jetë zgjidhja e vetme për dikë që përballlet me rrezikun për të rënë në faj. Largimi, ikja nga martesa me rrugë të panatyrshme është kundërshtim i natyrës dhe shpallje lufte ndaj asaj, dhe disfata e atij që tenton të luftojë kundër natyrës, është e pashmangshme!

¹³shih Vehbe Zuhajli, Enciklopedia e jurisprudencës islame, 9/28-31.

b) Martesa e domosdoshme (vaxhib)

Martesa e personit që ka mundësi ta paguajë garancinë e kurorës dhe ta mbajë familjen, ndërkohë që nuk ndodhet para ndonjë rreziku imediat për të rënë në faj me përjashtim të një dyshimi, është e domosdoshme. Kjo formë është mendim i vetëm disa juristëve, andaj nuk përbën pikëpamje apo opinion juridik të përgjithshëm.

c) Martesa traditë (sunet)

Është traditë (sunet), domethënë normale dhe e mundshme martesa e personit që nuk ka asnjë rrezik apo shqetësim dhe që ka dëshirë dhe është i interesuar të martohet.

d) Martesa e palejueshme (haram)

Është e palejueshme, e ndaluar dhe e dënueshme martesa për personin që do ta shtynte në veprime të fajshme, që do ta detyronte të përdorte rrugë të ndaluara e të dënueshme për ta mbajtur familjen. Një martesë e tillë është, më e pakta, e papëlqyeshme dhe e shëmtuar (mekruh). Ka juristë që e quajnë të ndaluar ose të papëlqyeshme edhe martesën e një mashkulli me çekuilibrim mendor-shpirtëror të tillë që do ta keqtrajtonte të shoqen.

e) Martesa e papëlqyeshme (mekruh)

Sipas disave, është e papëlqyeshme edhe martesa e dikujt për të cilin rreziqet për të rënë në gabim, për të përdorur dhunën, nuk janë kategorike, por vetëm paraqiten si mundësi.

f) Martesa e zakonshme (mubah)

Martesa e një personi të matur e serioz i cili fiton me të drejtë (hallall), për të cilin nuk ekziston mundësia të bjerë në adulter, i cili ka mundësi ta japë garancinë e kurorës dhe të mbajë familje, është e pëlqyeshme (menduh) ose e zakonshme, asnjënjëse (mubah). Një person i tillë po të dëshirojë mund të martohet, po nuk deshi, nuk martohet.

* * *

Imam Shafiu (r.a.) thotë se martesa është, në vetvete, një akt i zakonshëm, domethënë një akt neutral (mubah). Ndërkaq, është e domosdoshme (vaxhib) të shmanget nga fajësia (haram). Në të vërtetë, këtu, edhe shkolla shafi parashtron një pikëpamje të afërt me konsideratat hanefi. Imam Ahmed bin Hanbeli mbron pikëpamjen se, përballë rrezikut për të rënë në adulteri, martesa është e detyrueshme për çdo njeri, pavarësisht nëse ai mundet apo jo ta sigurojë jetesën e familjes e ta japë garancinë e kurorës. Në fakt, kur këto pikëpamje shqyrtohen me hollësi, kuptohet se nuk janë shumë larg njëra-tjetrës.

Me këto çështje specifike, u përpoqëm të tregojmë se ç'lloj synimesh ndjek feja, se martesa nuk është një çështje e thjeshtë dhe e lidhur veç me ndjenjat. Po qe se kjo punë e rëndësishme nuk kushtëzohet me parime të shëndosha në mënyrë që të mos u japë shkas zbrazëtive në arsye dhe në ndjenja, fundi i saj i pashmangshëm do të jenë dyert e gjyqeve dhe vargjet e grave të veja e të pazot, të fëmijëve të mbetur në mes të udhës! Duke ngritur pritë që në krye të herës para këtyre, feja e pengon martesën, përfundimi i së cilës është zvarritje në këto lloj situatash negative e të rënda, duke e kategorizuar si haram (e ndaluar), mekruh (e papëlqyeshme, e shëmtuar); në një çështje ku mbisundon ndjenja, feja i jep prioritet rrugës së arsyes, logjikës dhe gjykimit.

Specifika që ne deshëm të theksonim këtu, është që martesa është një institucion shumë i rëndësishëm, që me të formohet dhe ngrihet familja si elementi më i rëndësishëm i shoqërisë. Nisur nga kjo, kur mendohet e flitet për martesën, nuk duhet menduar e folur për të si për një situatë mediokre të lidhur vetëm me sensualitetin e individit, por si një çështje fetare, kombëtare dhe gjithënjëzore që ka lidhje me lumturinë e një shoqërie a të një grupi shoqëror, madje të gjithë një kombi. Sa për specifikën e ndjesive

dhe egoiste të martesës, kjo është vetëm një “parapagesë dhe bakshish” i Zotit për njeriun për të siguruar arritjen e “synimit të madh” përfundimtar. Në qoftë me vend të shprehemi kështu, kjo duhet vlerësuar si një “paradhënie” dhe duhet parë si një “shpërblim në dorë” për shërbimin e rëndësishëm që i sjell individi vazhdueshmërisë së brezit njerëzor me martesën, dhe rritjes e përgatitjes së individëve me karakter të lartë, të cilët bëhen mandej garanci e vitalitetit të një kombi!

Ç’është e vërteta, mund të thuhet se feja islame i jep mjaft rëndësi kësaj çështjeje. Në përgatitjen e martesës çdo gjë do të mendohet me hollësi, do të bëhen një mijë e një llogari dhe do të silltet me një kujdes që nuk do t’i linte hapësirë asnjë gabimi në mënyrë që foleja familjare e ngritur të mos prodhojë shkaqe që do të çonin në shembjen e saj.

5. Debatimi i argumenteve

1. Sipas një hadithi të nivelit *hasen*, Profeti (s.a.s.) porositi:

“Martohuni e shtohuni; unë do të krenohem ditën e kiametit me shtimin tuaj!”¹⁴

2. Edhe sipas një hadithi tjetër, Profeti (s.a.s.) porositi:

“Martohuni me femra pjellore, që mund të bëjnë shumë fëmijë!”¹⁵

3. Lidhur me këtë çështje, në një ajet kuranor thuhet:

“Martojini beqarët mes jush me skllavet dhe shërbëtoret tuaja të përshtatshme (nëse s’keni mundësi me të lira). Po qe se këta beqarë janë të varfër, Allahu, me favorin e vet, i bën të pasur. Allahu është Mirëbërës i madh dhe di çdo gjë!”¹⁶

Sa për personin që nuk ka mundësi të lidhë kurorë, domethënë, të mbajë e të ushqejë familje, ose që nuk mund të japë garancinë e kurorës, ai duhet të durojë virtytshëm derisa Allahu t’i japë mundësitë e duhura, për të jetuar ndershmërisht pa rënë në veprime të ndaluara (haram).

Edhe nëse argumentet profetike e kuranore në fjalë, dhe komenti i tyre duket sikur në pamje të parë bien në kundërshtim me argumentet e tjera, nuk ka dyshim se, përse i përket idesë themelore, ato theksojnë të njëjtat të vërteta.

Duke bërë analogjitë, pranimet dhe përjashtimet e duhura logjike, porosia profetike, *“Martohuni e shtohuni; unë do të krenohem ditën e kiametit me shtimin tuaj!”*, mund të thuhet se na kujton këto gjëra: Po qe se me martesën nuk kihet për synim një brez me të cilin Profeti Muhamed (paqja qoftë mbi Të) të krenohet, ajo martesë ose ai shtim nuk ka asnjë kuptim. Sigurisht, është krejt e qartë se Profeti nuk do të krenohet me një brez të përlyer me terrorizëm ose dëfrim, me njerëz që s’u bie balli asnjëherë në sexhde, me ndërgegjeje të ndryshkur e me sy të përgjakur! Brezi, shtimin e të cilit Ai e dëshiron, duhet të jetë brezi i pranuar edhe në lartësinë e Allahut, që përpiqet të fitojë pëlqimin e Tij, që e jeton dhe e mban gjallë fenë e cila ndan të mirën nga e keqja. Me deklaratat e tij dritëshpërndarëse, Kurani është referenca më e shëndoshë e kësaj konsiderate: *“Pasuria dhe fëmijët janë për ju stoli e jetës së kësaj bote, kurse punët që premtojnë amshueshmëri, janë, në lartësinë e Allahut, më të dobishme për të mirë dhe më të denja për të lidhur shpresën ndaj tyre.”¹⁷* Po, nëse punët tuaja shohin kah amshueshmëria, thuhet se keni hyrë në një rrugë, nga e cila edhe Zoti juaj do të jetë i kënaqur nga ju, edhe ju do të jeni të kënaqur nga Zoti juaj!

Përfundimi që arrijmë me këtë konsideratë, është ky: Synimi thelbësor në martesë është rritja dhe përgatitja e një brezi që do t’i bënte të kënaqur Allahun dhe të Dërguarin e Tij (s.a.s.). Prandaj, njerëzit që përqendrohen me kujdes të veçantë mbi edukimin e fëmijëve me besim fetar, atdhedashës e të lidhur fort pas familjes, pavarësisht nga mendimet e ndryshme e të shtrembra, kurrsesi nuk duhet të lëkunden të kenë fëmijë me rrugë të rregullta e legale. Shtimi i një brezi të tillë ka për ta bërë të qeshur fytyrën e umetit të Profetit Muhamed (s.a.s.).

¹⁴Abdurrezak, *musannef*, 6/173; el-Bejhaki, *Marifetus’suneti uel athar*, 5/220.

¹⁵Ebu Davud, *nikah*, 3; Nesai, *nikah*, 11.

¹⁶Nur: 32

¹⁷Kehf: 46

Lidhur me konsideratat e parashtruara gjer këtu, është mjaft me rëndësi edhe kjo këshillë dhe porosi e Profetit (s.a.s.) për të rinjtë:

“O ju të rinj! Ata prej jush që kanë mundësi për martesë, të martohen, kurse të pamartuarit ende, të agjërojnë, sepse kjo është parzmore ndaj haramit (gjërave të ndaluara).”¹⁸

Së pari, në kuptim të përgjithshëm, agjërimi është një pehriz. Duke i marrë nën kontroll, bashkë me stomakun, edhe ndijimet dhe ndjenjat e tjera njerëzore, lehtëson përdorimin e saj në drejtimin e urdhëruar nga Zoti.

Së dyti, martesa është një gjë serioze. Ajo s’është një punë e thjeshtë që njeriu mund t’ia hyjë duke marrë vendim të hëpërhëshëm, pa e menduar e pa e peshuar më parë. Mosmarrëveshja dhe mungesa e qetësisë në martesat e nxituara, të bëra pa kaluar nëpër filtrin e arsyes, është një ngjarje e hasur shpeshitazi. Në mënyrë të pashmangshme, fëmijët e rritur në një familje ku sundojnë mosmarrëveshja e grindja, nuk do të marrin edukatën e duhur; do të rriten me prindër, por sikur të ishin jetimë dhe, disa herë, do të rriten të pandjeshëm e armiq ndaj prindërve, madje edhe ndaj gjithë shoqërisë që i rrethon.

Në shumicën e vendeve perëndimore gjendja përqendrohet në këtë pikë.

Në këto vende martesa nuk trajtohet si një çështje serioze dhe nuk realizohet brenda disiplinave të duhura. Kjo ngjarje tejet serioze dhe jetësore shihet si një mundësi konkrete për plotësimin e disa nevojave njerëzore, për t’u ushqyer e pushuar, kuadri i synimit përfundimtar të saj ngushtohet, duke u zhveshur krejtësisht nga domethënia që zotëron. Evropa e sotme po vërtitet sot buzë greminave ku qe vërtitur Roma e djeshme dhe po i afrohet vdekjes hap pas hapi, sepse asnjë komb që ka institucionin e familjes të prishur, e me individë të degjeneruar, nuk ka mundur të qëndrojë më këmbë.

Unë nuk e di se çfarë mendon Kisha përballë këtij problemi, ç’thonë sociologët, ç’pikëpamje kanë edukatorët. Nëse di diçka, di se me këtë pandjeshmëri e me këtë mungesë logjike, shoqëritë e sëmura nuk do ta kenë të gjatë.

Kutubi i ndjerë, një mbresë të tij lidhur me këtë çështje, e përcjell kështu: *“Në Amerikë, duke shqyrtuar jetën e tyre fetare, unë u përballa me gjëra interesante. Një radhë, erdhën në kishë shumë meshkuj e femra së bashku dhe bënë aty adhurimet e duhura. Pas lutjes, prifti i futi ata në një sallë tjetër ku do të kërcenin, do të dëfreheshin e do të bënin edhe gjëra të tjera. Prifti shoi dritat dhe nisi argëtimi. Duke ndjekur argëtimin e tyre, prifti thyhej më dysh nga kënaqësia dhe emocioni. Po, prifti qe shumë i kënaqur që i kishte sjellë ata në kishë!”*

Mirëpo, ashtu siç të shkuarit në kishë nuk është qëllim në vetvete, as të shkuarit në xhami nuk është qëllim në vetvete, madje edhe vetë tavafi rreth Qabes nuk është i atillë. Qëllimi është ta bësh të kënaqur Allahun (xh.sh.) dhe të jesh në rrugën që urdhëron Ai!

Një shoku im mjek, pati shkuar në Amerikë për specializim. Kur u kthye, m’i përshkroi kështu mbresat e tij:

“Në Amerikë, shumica e njerëzve që shkojnë në kishat e qendrave të qyteteve, në tregjet dhe ndanë rrugëve me publik të dendur, janë pleq të moshuar, të kërrusur, që dremisin ku të ndodhen. Dhe mendova: Mos vallë rinia amerikane është prishur krejt?”

Pastaj shkova në një kishë jashtë Nju Jorkut. Kisha ndodhej në një majë. Kur arrita, pashë se të rinjtë pothuajse rridhnin si lumë për atje, se atje shkonin të gjithë, burra e gra. Prifti u jepte këshilla të vazhdueshme, por ata as që ua vinin veshin fjalëve të tij. Secili shihte qejfin e vet. Edhe prifti, duke menduar se, sidoqoftë, ardhja e tyre në kishë ishte fitim, mbyllte sytë para bëmave të njerëzve. Dikush përdorte heroinë, dikush, morfinë, dikush merrej me punë të tjera.”

Nuk e di, ç’dobi mund të ketë një vajtje e tillë në kishë? Nëse të shkuarit në kishë nuk ia pasuron botën shpirtërore njeriut, nuk ia vë në lëvizje ndjenjat njerëzore dhe nuk e shtyn të jetojë si njeri, do të thotë se ajo s’ka ndonjë synim për të qenë, prandaj s’ka edhe kuptim!

6. Parimet e krijimit për martesën

a) Hapi i parë i çdo mbarësie: “Bismil’lah”

¹⁸Buhari, *saum*, 2; Muslim, *nikah*, 1, 3.

Bashkëshortët që kanë arritur të ngrenë një fole familjare brenda kritereve tona, quhet se kanë realizuar një ngjarje me rëndësi shumë të madhe. Një fole e tillë, kur duhet, shërben si faltore, kur duhet, si shkollë dhe shërben si një "Shtëpi e Zotit" që i fryn ringjallje tërë një kombi! Fole të tilla të lidhura ngushtë pas parimeve të vendosura nga Allahu, disa herë kanë shërbyer si një ADN për të gjithë shoqërinë.

Këtu kërkoj t'ju tërheq vëmendjen edhe mbi një tjetër moment. Kur nisim të hamë bukë, ne themi "Bismil'lahi Rrahmani Rrahim". Madje besojmë se, po ta themi nga zemra, na shtohet bereqeti, begatia. Mes nesh, ata që besojnë mirë, shumë herë edhe e kanë parë haptazi këtë begati.

Po kështu, në shumë punë, ne mbështetemi te Allahu (xh.sh.) nga e keqja e shejtanit dhe i lutemi Atij të na mbrojë. Kësaj disipline i kushtojmë kujdes në çdo çështje, gjer në ato më intimitet. Dhe besojmë se fëmijët që do të na vijnë në botë si rezultat i mbështetjes sonë te Zoti duke e kërkuar ndihmën dhe udhëzimin vetëm prej Tij, do të bëhen të mirë dhe se djalli nuk do të mund të fusë gishtin në këtë rezultat.

Atij që nuk e bën këtë mbështetje te Zoti duke e kërkuar ndihmën dhe udhëzimin vetëm prej Tij, i bien në kokë, si rezultat i nënvleftësimit të kësaj gjëje që mund të duket si e vogël, shqetësime të tilla që ai nuk e di se nga i vijnë, por shembet nën peshën e tyre! Në këtë çështje, njeriu nuk duhet të nënvleftësojë as grimë-çastin më të shkurtër. Duhet ta kryejë çdo gjë të madhe ose të vogël që është ngarkuar për ta kryer, duhet t'i plotësojë të gjitha kushtet e provës para së cilës është vënë. Duke çuar në vend përgjegjësitë që ia ka ngarkuar feja, duhet të sillet jashtëzakonisht i kujdesshëm e i ndjeshëm për të mos rënë kurrë në kapitje.

Disa herë, një çast plogështie mund të japë si përfundim një fatkeqësi të tillë si ajo që jep topitja dhe mungesa më e vogël e vëmendjes së njeriut që ndodhet në timon. Po, besimtari duhet çdo çast të mbështetet te Allahu (xh.xh.), të strehohet te Ai! Po me këtë ndjenjë duhet vepruar edhe në kurorën që duket si një trajtim i thjeshtë. Kurora lidhet në emër të Allahut. Nuk mund të mendohet që kurora e lidhur pa u mbështetur te Allahu, të ketë begati, të bëhet pretekst për dobi. Sigurisht, kurora është një lidhje shpirtërore, sublime; edhe perspektiva e saj varet nga raportet me Allahun.

Nisur nga kjo, kurora do të lidhet në emër të Allahut që të ketë begati. Brenda saj do të ketë lutje, dhe do të realizohet brenda kuadrit të parimeve të vendosura nga Allahu, madje do të përcaktohet garancia e kurorës në mënyrë që të pretojë të ardhme të sigurt. Allahu (xh.xh.) e bën kurorën e lidhur në emër të Tij, të bekuar e të lumtur. Një kurorë e tillë është nën përkujdesjen hyjnore të Allahut (xh.xh.). Ajo premtun mundësi e të ardhme, duke u bërë kësaj shkak për të shkuar mirë dhe në harmoni mes bashkëshortëve.

Në ditët tona po bëhemi dëshmitarë të ndarjeve të shpeshta dhe në martesat po shihet një mosshkuarje mirë, një mungesë mbarësie dhe qetësie. Fakti që punët nuk bëhen në emër të Allahut, që janë spontane e pa kurrfarë synimi, që çdo gjë lidhet me parimin e kënaqjes vetëm të ndjenjave epshore dhe hedhja pas krahëve e të gjitha vlerave njerëzore, ashtu siç e ka tronditur nga themelet sistemin familjar perëndimor, ashtu na ka shkundur edhe ne. Gjendja e përgjithshme këtë tregon. Zoti na ndihmoftë!

b) Zgjedhja e bashkëshortit/es

Çështja e parë që mendon personi që nisat për t'u martuar, është të kërkojë një bashkëshort(e) në përshtatje me ndjenjat dhe mendimet e veta. Në këto kohë, shumë të rinj e vlerësojnë këtë punë jetësore vetëm me ndjenja dhe përpiqen të krijojnë fole të familjare me dikë që kanë njohur në rrugë, në treg apo në shëtitje. Është e qartë se martesat e bëra duke lënë mënjanë gjykimet mbi kuptimin, natyrën dhe rëndësinë e martesës e të ngritjes së folesë familjare, sjellin fatkeqësi. Ndërkaq, po qe se para këtij hapi të madh do të kërkohej ndihma e mendimeve dhe pikëpamjeve të një personi të tretë i cili do ta shihte çështjen me një sy tjetër dhe do të bënte llogari e vlerësime, duke iu referuar momenteve dhe analogjive të tjera, rezultati do të ishte krejt i ndryshëm dhe përfitimi më i madh.

Disa herë, martesat e bëra me një trajtim të thjeshtë, bazuar veçse në ndjenja, fole të familjare të konsideruar si një kënd Xheneti mund ta shndërrojë në një gropë Xhehenemi. Ka shumë njerëz që i njohim e i dimë, përkushtimi fetar i të cilëve është i njohur, por që si familje, për shkak të kapitjes së

rrezikshme apo llogarive të gabuara të bëra në pragun e ngritjes së familjes, jetojnë në kaos dhe krizë të thellë.

Në një familje të tillë, fërkimet dhe përplasjet nuk ndërpriten kurrë. Burri kërkon ta jetojë fenë, gruaja shqetësohet, ose e kundërta. Për rrjedhojë, në një familje të tillë, burri dhe gruaja kurrë nuk mund të përbëjnë një unitet, nuk mund ta bëjnë familjen një dhe të përbashkët, nuk mund të bëjnë një ndarje të përbashkët të detyrave, përgjegjësi, të drejtave dhe respektit personal. Përkundrazi jetojnë si pole të kundërta me njëri-tjetrin. Në një familje të tillë, lexohen dy libra e dy gazeta të ndryshme; rrefehen dy lloje tregimesh; bëhen dy lloje mbledhjesh familjare. Gruaja kërkon një gjë, burri e kundërshton. Gruaja kërkon besim, moral, kurse burri i kthen këto në shkaqe grindjesh. Kështu, në një familje të tillë, bëhet një jetë dualiste, në i thëncin jetë një jete të tillë!

Në mjedisin e një përplasjeje dhe kapërfytyjeje të tillë, fëmijët disa herë lidhen pas njëres anë, kurse, disa herë, mbeten në mes, krejt pandjenja e mospërfillës ndaj ç'ndodh, dhe për më tepër armiq të familjes dhe shoqërisë. Prandaj, duke hedhur hap drejt martesës, mashkulli dhe femra duhet ta mendojnë shumë mirë çdo gjë, e po të jetë nevoja, duhet të këshillohen me ata që kanë përvojë dhe t'i përcaktojnë shumë mirë shkaqet e parapëlqimit të tyre.

Lidhur me këtë çështje, Profeti Muhamed (s.a.s.) arrin në këtë përfundim: *“Gruaja merret për këto katër arsye: për pasurinë, fisin, bukurinë dhe besimin. Ti zgjidh atë që ka besim që të gjesh lumturinë!”*¹⁹

Feja dhe besimi janë shkak më i rëndësishëm për parapëlqim. Sikur para një mashkulli të paraqiten dy kandidate, njëra prej të cilave është shumë e bukur, kurse tjetra, me bukuri mesatare, por me ndjenjë besimi të fortë, epërsia morale dhe fetare duhet të bëhet shkak për parapëlqim. Jeta familjare nuk i përket vetëm kësaj bote, ajo vazhdon me bijtë, nipërit e mbesat dhe e ruan këtë njëshmëri edhe në jetën tjetër. Në të vërtetë, ndërsa një fole familjare e mirë mund të jetë një kënd parajse në këtë botë, ka ndodhur, që, si rrjedhojë e disa gabimeve, të kthehet në varr dhe t'i bllokohet e t'i shembë edhe rrugët që çojnë në lumturinë e natyrshme të botës së mbrame.

Nisur nga kjo, patjetër i duhet kushtuar vëmendje mendimit, veprimit, dhe veçanërisht, besimit fetar të bashkëshortes së ardhshme. Personi që i jep vajzën një mashkulli me të meta në besim, është përgjegjës për të gjitha pasojat negative të mundshme që mund të burojnë prej asaj martese. Kjo është e vlefshme edhe për femrën me mangësitë përkatëse. Ndërkaq, nëse mashkulli ka ndonjë problem serioz besimi, do të thotë se çështja është negative që në themel, sepse besimi është një element themelor i vlefshmërisë së kurorës. Njeriu që nuk i beson Allahut (xh.xh.), që i nënvleftëson urdhrat e fesë, ka një problem serioz besimi. Për rrjedhojë, mungon elementi më i rëndësishëm dhe i domosdoshëm për lidhjen e aktit të kurorës.

Është e qartë se për të realizuar martesën për pozitë, post, përkatësi familjare e fisnore, famë e popullaritet, para, rrogë, etj., feja dhe besimi janë nënvleftësuar dhe autorët, në vend që të fitojnë, kanë humbur. Së pari, cilësia e kërkuar me përparësi në martesë është karakteristika fetare. Themeli i fesë është besimi. Martesa me një njeri pa besim kurrë nuk është një martesë në kuptimin e plotë të fjalës, ajo është thjesht një bashkëjetesë.

Përfundimet tona janë, sigurisht, për njerëzit fetarë dhe për ata që i pranojnë ligjet dhe kriteret e fesë. Le ta bëjmë të qartë edhe një herë këtë që martesa është një mbështetje shumë e rëndësishme e lumturisë materialo-shpirtërore. Ai që bën gabim në një çështje të tillë të rëndësishme, ia ka nxirë vetes që të dyja botët.

Para çdo gjëje tjetër, në qoftë se mjedisin jua kanë rrethuar fëmijë të paushqyer mirë me ndjenja fetare, do ta keni shumë të vështirë ta drejtoni situatën. Ndërkaq, po që se një dorë bujare ju vjen në ndihmë në mënyrë të mrekullishme dhe i ndreq çrregullimet që kanë pasuar nënvleftësimet dhe gabimet tuaja, themi “ndihma e Allahut” dhe lutemi për më tej. Por ç’e do se kjo mund të mos ndodhë gjithnjë...

c) *Rritja dhe përgatitja e fëmijëve të mirë*

¹⁹Buhari, *nikah*, 15; Muslim, *rada'*, 53.

Në çështjen e rritjes dhe përgatitjes së fëmijëve, nëna dhe babai duhet të jenë medoemos në të njëjtën mendje. Fëmijët që ndodhen nën prindësinë e një nëne pa aftësi për të rritur dhe përgatitur fëmijë, ose të aftë por që nuk merr përsipër asnjë përgjegjësi, dhe të një babai që nuk merret me asnjë problem të tyrin, janë jetimë edhe pse me nënë e baba.

Nëna, të cilën Allahu (xh.sh.) e ka pajisur me mëshirë, dhembshuri, ndjeshmëri e delikatesë, aftësinë e së cilës për të rritur e përgatitur fëmijë e ka kthyer në një cilësi të thellë të natyrës së saj, këtë potencial të shpirtit të saj duhet ta përdorë patjetër për t'i lartësuar ata në vlerat si njeri. Fundja, për nga krijimi i saj, nëna është njëherazi mësuese, edukatore dhe udhërrëfyese. Detyra më e rëndësishme e saj duhet të jetë përgatitja e fëmijës së vet. Edhe porosia profetike, sipas së cilës, *“atë që i ndan nënën me fëmijën nga njëritjetri, në ditën e kiametit Allahu e ndan nga njerëzit e dashur”*²⁰, e paraqet në mënyrë mjaft të qartë rolin e qenësishëm të nënës në edukimin e fëmijës.

Kur nëna e përdor domosdoshmërinë imediate të pajisjes së saj, edhe babai, ashtu siç e kërkon krijimi dhe pozicioni i tij, duhet të jetë gjithmonë i matur, serioz, i zgjuar dhe i vëmendshëm. Babai merret me politikë, nëpunësi, tregti, bujqësi etj. dhe, pak edhe si domosdoshmëri e natyrës së tij, mbush në familje një zbrazëtitirë tjetër të saj. Sigurisht, ai, me forcën, qëndresën dhe strukturën e tij të veçantë, është i përcaktuar për punë të veçanta. Fundja, qysh në krye të herës ai ka qenë gjithmonë njeriu i një përgjegjësie të posaçme, dhe si i tillë ka ardhur deri në ditët e sotme. Nisni me prerjen e druve në pyll, me plugimin e tokës, me mbjelljen dhe vjeljen e të lashtave e gjer te punët e rënda të ndërtimit apo industrisë; çdo gjë është kryer dhe çuar para duke u lidhur me qenien e tij, e duke u mbështetur te ai. Sipas meje, burri duhet ta ruajë vendin e vet të qëndresës ndaj punëve të tilla të rënda në saje të trupit dhe vullnetit të vet dhe s' duhet të ngatërrohet me punët e femrës; po kështu edhe femra nuk duhet vënë në punë të rënda që e kapërcejnë forcën fizike të saj.

Sidomos mashkulli, i cili është monument qëndrese, por jo hero dhembshurie! Dhembshuria është thellësia veçanërisht e femrës. Ajo e shëtit fëmijën në bark për nëntë muaj. E sjell në botë me njëqind mundime, kujdeset dhe e rrit me një mijë vështirësi. Kur fëmija rënkon natën, nëna ngrihet dhe i shkon menjëherë në ndihmë dhe, kur qan e merr në gj. Me një dëshirë dhe instinkt që buron prej natyrës së saj, nëna jeton për ta mbajtur atë gjallë. Ja pra, nga njëra anë femra e nga ana tjetër mashkulli, me unitetin familjar të përbërë prej tyre, ngrenë një fole familjare që të kujton pallatet e Parajsës, në fytyrën e së cilës mund të sodisin botën e përtejme!

Në Perëndim, burri punon në një vend pune e gruaja në një vend tjetër. Në këto kushte, fëmijët ndodhen ose pranë dikujt të tretë ose në çerdhe apo në kopsht. Kështu, kur punojnë edhe babai, edhe nëna, fëmijët braktisen, në një farë mase, në vetmi, në pakujdesi. Mandej, këta njerëz ngushëllohen kështu në vetvete: *“Atje ka njerëz shumë të dhembshur e të mësuar. Ata kujdesen për fëmijët tanë më mirë se ne!”* Kurse përtej kësaj ekzistojnë edhe shumë gjëra për të cilat ka nevojë fëmija!

Në çerdhe apo kopsht, fëmijës mund t'ia lajnë rrobën, mund t'ia japin ushqimin në kohë, mund ta nxjerrin jashtë kur duhet, për pushim ose shëtitje në ajër të pastër, ose edhe e çojnë për të dëfryer në një park lojërash. Por ata që i bëjnë të gjitha këto, kurrë nuk mund të bëhen nëna dhe babai i fëmijës, nuk mund t'ia japin atij dhembshurinë për të cilën ka nevojë më tepër se për çdo gjë tjetër. Dhembshuria është interesimi, lidhja e bashkëlindur të cilën fëmija e lexon në sytë e nënës, e gjen në gjirin e saj, e ndjen në prehrin e babait. Nëse institucionet në fjalë nuk ia japin dot këtë, nuk mund ta kënaqin fëmijën me asnjë lloj fantazie tjetër!

T'i lëmë fëmijët e vegjël të braktisur në çerdhe apo kopshte e të shohim se ç'ndodhte me fëmijët e rritur të dorëzuar ustait apo kallfës në periudhën e zejtarisë. Në qoftë se ustai apo kallfa do të ishin të mangët nga dhembshuria, dhe pak edhe të ashpër, këta fëmijë të trajtuar vazhdimisht me ashpërsi, me kohë bëheshin aq të pa ndjenjë, aq zemërgurë e aq të pamëshirë, saqë jo vetëm ndaj të huajve, por edhe ndaj prindërve paraqisnin një sjellje harbute. Dhe kështu, nëse ndikimi negativ i ushtruar nga njerëz të tillë të ashpër si ustai dhe kallfa të periudhës së çirakllëkut në shpirtat e butë të atyre fëmijëve të pafajshëm do të lindte rezultate negative të këtyre përmasave, nuk do të ishte e vështirë të përcaktonim

²⁰Tirmidhiu, *buju*, 52; *sijer*, 17; Darimiu, *sijer*, 39.

se ç'ndryshime pësojnë fëmijët tanë të sotëm nën ato vështrime të huaja, teksa i dorëzojmë në çerdhe apo kopshte ende pa lindur ose pa u rritur ende mirë!

Allahu i Lartë (xh.xh) që gjithmonë na e prezanton neve veten si Mëshirëplotë (Rahman) dhe Mëshirues (Rahim), që na i tregon mëshirën dhe bamirësinë e Tij brenda fjalës së lartë, *"Bismil'lahi Rrahmani Rrahim, Me emrin e Allahut Mëshirues e Bamirës"* e cila përsëritet në Kuran njëqind e katërbëdhjetë herë, duket sikur shfaqet te nëna me të dyja këto cilësi të bekuara. Po, shfaqjen e Allahut (xh.xh.) me mëshirën dhe bamirësinë e Tij në një banesë mund ta lexojmë në përqendrimin e nënës me një mijë kujdesje mbi fëmijën dhe shërbimet e saj për të. Nuk ka dyshim se një dinjitet dhe meritë e tillë është aq e lartë sa të mos mund të shkëmbehet me asgjë tjetër në botë!

Në një periudhë, pati ca të rinj që kishin mbaruar universitetin, madje që kishin bërë studime pasuniversitare, madje edhe ishin doktoruar, por që kishin rënë në duar të qendrave terroriste dhe u rritën breza pa ndjenja e pa mëshirë, që i bënë prindërit të qanin, duke ua copëtuar zemrën. Vetëm se këta qenë një përjashtim dhe jo gjëra që do të përbënin argument kundër mësimi dhe arsimit. Askush nuk e rrit dhe përgatit fëmijën që të vritet prej plumbit, ose që të prishë qetësinë e shoqërisë; nuk e rrit, por disa herë edhe nuk e parandalon dot që fëmija të rrëmbehet nga rryma krejt të papritura. Ja pra, qoftë para gjërave të tilla negative të papritura, qoftë para rreziqeve të mundshme, nëna dhe babai gjithmonë duhet ta përdorin follenë familjare si një serë mbrojtëse, edukimin moral të fëmijëve duhet ta bëjnë synim parësor dhe nuk duhet t'i japin kurrsesi shkas humbjes së fëmijëve!

Si përfundim, mund të themi se nëna dhe babai duhet të bëjnë gjithçka që është e nevojshme për rritjen dhe përgatitjen e një brezi të ndjeshëm, të vetëdijshëm dhe të lidhur fort pas atdheut, kombit dhe fesë dhe nuk duhet të japin rast që ai të përjetojë boshllëk mendor, ndijesor apo logjik. Po qe se prindërit do të jenë besimtarë, të lidhur pas Kuranit dhe njohës të mirë të Islamit, edhe fëmijët, në dashtë Zoti, do të rriten dhe përgatiten të vetëdijshëm dhe do ta bëjnë të valëvitet flamurin e kombit të tyre!

7. Vlera e lartë e nënës

Nëna është elementi më i rëndësishëm i familjes, që përgatit një komb. Në botëkuptimin e Islamit ajo është aq e shenjtë, saqë i Dërguari i Allahut (s.a.s.) ka thënë:

"Xheneti ndodhet nën këmbët e nënave!"²¹

Ashtu është, sepse nëna është dora e shenjtë që gatuan një komb të tërë, si dhe ngritësja e folesë familjare, që përbën qelizën e parë të shoqërisë; ngritësja e një foleje ku reflektohen gëzimet dhe lumturia e fëmijëve që cicërojnë si zogjtë...

Me këtë aspekt, Islami i jep nënës një vend dhe vlerë të tillë që përpjekja për t'i dhënë asaj vend tjetër, dhe vlera të tjera përtej kësaj, është ta vulgarizosh atë, është njësoj sikur t'i heqësh nga koka kurorën me margaritarë për t'i vënë një kësulë të "stolisur" me copëra qelqi! Allahu (xh.xh.) që i ka krijuar mashkullin dhe femrën, i ka pajisur ata sipas vendit dhe vlerës të tyre dhe u ka dhënë ato që duhen dhënë sipas kapaciteteve përkatëse. Femra është e dobët dhe delikate. Ajo preket më shpejt nga ndodhitë. Ja pra, ta marrësh njeriun me një natyrë të tillë e ta largosh nga punët e përshtatshme me natyrën e tij me qëllimin për ta shtrënguar në punë që nuk mund të përputhen me hijeshinë, dobësinë, delikatesën dhe respektin për të cilin është i denjë, është drejtpërsëdrejti padrejtësi dhe dhunë ndaj tij!

Në të vërtetë, kjo qenie delikate që i themi femër, është e pajisur me gjëra të tilla që, në këtë aspekt qëndron tejet para mashkullit. Femra është një heroinë dhembshurie; ajo dridhet mbi kokë të bijve të saj asisoj, saqë në këtë gjë mashkulli as që mund të vihet në krahasim me të! Ndërkaq, kjo nuk është e kufizuar vetëm me botën e njerëzve. Megjithëse e gjithë pasuria e pulës është jeta e saj, ajo është gati ta flijojë veten për ta shpëtuar të voglin e saj nga dhëmbët e qenit. Ja pra, kjo ndjenjë e thellë dhembshurie ndaj fëmijëve dhënë gjithë frymorëve nga Allahu, është për nënën një kapital aq i madh, saqë çfarëdo vlere që t'i jepni asaj, do të mbetet e zbehtë para kësaj vlere që i ka dhënë Allahu!

Në këtë pjesë ku kaluam duke e parë çdo gjë në mënyrë të përgjithshme, u përpoqëm të japim një mendim se si duhet ngritur foleja familjare. U ndalëm mbi çështjet e besimit, aspektin praktik të Islamit,

²¹El-Kudai, *Musnedu'shahab* 1/102, për të parë hadithet me të njëjtën domethënie shih: Nesai, *xihad*, 6; Ibn Maxhe, *xihad*, 12.

aspektin fetar të bashkëshortëve, ndarjen e punëve mes tyre, mbi ndihmën reciproke, rritjen dhe përgatitjen e mirë të fëmijëve. Theksuam, ndërkaq, disa çështje të ndjeshme siç është të qenit një bashkësi (umet) me të cilën të krenohet i Dërguari i Madh (s.a.s). Në pjesën në vazhdim duam të qëndrojmë pak edhe mbi kuadrin e familjes.

PJESA E DYTË

Familja

Familja

1. Çfarë familjeje?

Në pjesën e kaluar qëndruam mbi lidhjen e familjes ose folesë familjare, si njëra prej shtyllave më të rëndësishme të shoqërisë, ndaj parimeve fetare, dhe duke e kushtëzuar realizimin e çdo gjëje në mënyrën më të përsosur me një plan të përsosur, kujtuam se kjo punë jashtëzakonisht e rëndësishme duhet trajtuar me seriozitet qysh se ajo është vetëm një ide. Sigurisht, nëse një punë çfarëdo nuk merret seriozisht qysh në plan dhe nuk lidhet pas një logjike të shëndoshë, mund t'u japë shkak problemeve të papërbalueshme. Po qe se duke bërë një ndërtesë, nevojat dhe estetika e saj nuk paraqiten në një plan, më pas nuk e ngremë dot kokën prej prishjeve dhe ndreqjeve të njëpasnjëshme.

Familja është shtylla më e rëndësishme e shoqërisë. Fortësia dhe qëndrueshmëria e saj është edhe fortësia dhe qëndrueshmëria e kombit dhe e shtetit. Atëherë, kjo shtyllë themelore e kombit dhe e shtetit nuk duhet lënë kurrsesi pa një plan dhe pa një projekt. Sepse një nënvleftësim në këtë çështje konsiderohet nënvleftësim në emër të një kombi të tërë. Prandaj ne besojmë se duhet qëndruar me seriozitet mbi çështjen e familjes duke e parë këtë si shumë të rëndësishme dhe dëshirojmë ta theksojmë edhe një herë besimin tonë se shoqëria merr plagë nga bashkimet e jashtëligjshme.

Sigurisht, një fole familjare pa synim, e ngritur mbi dëshira, pasione, qejfe, zili apo smirë, jo vetëm që nuk premtan të ardhme, por do të mbetet në trup të popullit si një element përkeqësues potencial. Sipas të gjitha gjasave, një familje e tillë do të përgatisë vazhdimisht endacakë rrugësh. Sepse duke u ngritur, ajo nuk është ngritur me llogari dhe plan që t'i sjellin begati. Këtij plani ne i themi "kurore" dhe mendojmë se në rrugën që shkon drejt kurores, duhet të lihen mënjanë egoizmi dhe dëshirat për të sunduar; mendimi, logjika dhe zemra dhe besojmë se në një martesë të tillë do të jetë shumë e dobishme që të merren për bazë mendimi dhe ndjenja fetare. Në qoftë se femra dhe mashkulli nuk kanë lidhje me Allahun (xh.sh.), nuk ka mundësi që fëmijët që do të vijnë prej tyre të jenë të vetëdijshëm, të ndjeshëm, të ekuilibruar për të bartur ndjenjën e përgjegjësisë. Nëse, pavarësisht çdo gjëje, arrihen rezultate të mira, gjë që është tejet e vështirë, ne e konsiderojmë këtë si një bujari të jashtëzakonshme të Zotit dhe përkulemi para Tij me ndjenjën e një mirënjohjeje të thellë!

Në fakt, çdo gjë e kësaj bote bërje-zhbërjeje brenda së cilës jetojmë, varet nga një shkak. Në të shumtën e rasteve, çështjet që ndjekim duke mbajtur parasysh shkaqet përkatëse me të cilat ato kushtëzohen, mund t'i realizojmë, me ndihmën dhe përputhshmërinë e dhënë gjërave nga Zoti, në atë formë që i mendojmë. Nëse nismat dhe "medikamentet" e ndryshme i trajtojmë duke bërë sikur nuk i shohim shkaqet, rezultati mund të jetë aspak i dëshiruar. Nisur nga kjo, nëse s' duam të biem në zhgënjim dhe disfatë, në çdo çështje, shkaqet dhe premisat duhet t'i trajtojmë me vëmendje të plotë dhe pastaj, duke i besuar mirësisë dhe bujarisë së Zotit, do të presim vetëm e vetëm prej Tij, që edhe rezultatet t'i kemi të shëndosha. Sigurisht, duke marrë vendim, bindja te Allahu duhet të jetë e plotë, por edhe veprimet e karakterit të lutjes veprimore si dhe vlerësimi i shkaqeve duhet të bëhen pa të metë. Këtë e tregon shprehja "vlerësimi i shkaqeve nuk është pengesë për nënshtrimin dhe dorëzimin te Zoti", e cila është, në të njëjtën kohë, një rregull i fesë islame. Ne besojmë se këto parime duhen respektuar edhe në ngritjen e një institucioni serioz, siç është familja.

Pasi të pranohet dhe përvetësohet se kështu duhet ngritur familja, edhe parimet për të përfutur breza të përsosur do të shprehin diçka. Por nëse në themel të çështjes ka ndonjë dëmtim, edhe ndikueshmëria e "mjekimeve" të mbrame do të pakësohet në përpjesëtim të drejtë me atë dëmtim. Në një familje në themel të së cilës ka mbarëvajtje e begati, domethënë në follenë familjare ku janë bashkuar femra e mbledhur me mashkullin e mbledhur, femra myslimane me mashkullin mysliman, femra besimtare me mashkullin besimtar, femra dhe mashkulli që i u japin jetë një më një përgjegjësive të tyre, çdo gjë është në vendin e vet dhe kjo fole familjare është si një kënd Xheneti. Më duket edhe bërtitjet e atyre të vegjëlve të ardhur në këtë botë nën një çati të tillë, janë, te Allahu, të shenjta si dhe tesbihet e engjëjve, merren sikur të ishin nga një lutje më vete.

Duke e trajtuar shoqërinë e lumtur me gratë e me burrat e saj, Kurani, nja dy fjalë të bekuara të të cilit i prekëm më lart, e përvijon kështu çështjen:

“Për burrat myslimanë e për gratë myslimane, për burrat besimtarë e për gratë besimtare, për burrat që falen e për gratë që falen, për burrat fjalëdrejtë e për gratë fjalëdrejta, për burrat që bëjnë durim e për gratë që bëjnë durim, për burrat e thjeshtë e për gratë e thjeshta, për burrat që japin sadaka e për gratë që japin sadaka, për burrat që agjërojnë e për gratë që agjërojnë, për burrat që e mbrojnë nderin e për gratë që e mbrojnë nderin, për burrat që e përmendin shumë Allahun e për gratë që e përmendin shumë Allahun, Allahu ka përgatitur një falje të madhe dhe një shpërblim të madh!”²²

Këta burra e gra janë bashkuar me njëri-tjetrin në familjen, e cila është qeliza më e vogël e kombit, i kanë besuar Allahut, janë orientuar kah Ai me zemër, janë bashkë me Të dhe e kalojnë jetën në bindje dhe adhurim të vazhdueshëm.

Po, tek këta burra besnikë e gra besnike, as fjalët që thonë nuk ua përgënjeshtrojnë sjelljet e veprimet, as sjelljet e veprimet që bëjnë nuk bien në kundërshtim me fjalët që thonë. Brenda folesë familjare të përbërë prej tyre nuk rastiset asgjë kundërtënëse. Në atë shtëpi, çdo gjë shkon drejt dhe është krejt ashtu siç duket. Për rrjedhojë, ashtu si njeriu që i jep një rregullim të përgjithshëm vetes para pasqyrës në këmbë, edhe fëmija i kësaj shtëpie, para tablove të drejtësisë, të fjalëve, sjelljeve e veprimeve të drejta, e në përputhje me njëra-tjetrën, vazhdimisht ka për ta korrigjuar e rregulluar veten. Ai as ka për t’u bërë dëshmitar i ndonjë shprehjeje apo pohimi kontradiktor, i ndonjë sjelljeje apo veprimi në kundërshtim me fjalët, as vetë nuk do të bjerë në pozita të tilla. Çdo gjë që ndodh në atë shtëpi, është e drejtë, sepse në atë shtëpi ka një burrë besnik e një grua besnike, një burrë të drejtë dhe një grua të drejtë!

Gratë që bëjnë durim, burrat që bëjnë durim, ata që shtrëngojnë dhëmbët e qëndrojnë para rëndesës dhe vështirësisë së adhurimit e bindjes, para pamëshirës së fatkeqësive që u bien mbi kokë, ata që tregohen të vendosur para mëkateve dhe e mbrojnë nderin e tyre, ata që e quajnë rënien në mëkat të barasvlershme me rënien në Xhehenem, ushtrojnë me gjuhën e qëndrimit të tyre një ndikim aq të madh mbi mjedisin, e po aq të madh edhe mbi fëmijët e tyre, sa pandeh që çdo gjë që mund të thonë me fjalë, do të mbetet krejt e zbehtë!

Çdo gjë që ka për të parë fëmija në këtë shtëpi të mbushur plot respekt për Allahun, ku burri e gruaja dridhen gjithmonë me frikën ndaj Tij, përpiqen t’i përjetojnë në mënyrën më të mirë përgjegjësitë e veta me mendimin se i pret një jetë serioze dhe një fund i tmerrshëm dhe në çdo çast të jetës arrijnë në fund të rrugës e presin ftesën për në jetën tjetër, çdo gjë që ka për të parë fëmija pra, do të jetë gjithmonë serioziteti, rëndësia, ndjeshmëria dhe kujdesi. Në një familje të tillë fëmijët do të shohin të ndërthuren në fytyra një frikë e butë dhe një ëmbëlsi që e ndjek atë, gëzimin që prodhon nëpër fytyra droja ndaj madhësisë së Allahut (xh.xh.) dhe shpresa e Xhenetit, ata do të shfaqen si njerëz të qetë por të kujdesshëm, të lumtur por largpamës, të kënaqësisë dhe dëfrimit, por edhe të së ardhmes.

Në një shtëpi duhet të ndodhen një burrë që jep sadaka dhe një grua që, gjithashtu, jep sadaka në mënyrë që te fëmijët e tyre të zhvillohet shpirti i bujarisë. Sigurisht, në fillim ne duhet të jemi bujarë që edhe ata të bëhen të atillë pas nesh. I varfëri unë, kam qenë bërë dëshmitar i një ndodhie të tillë. Gruaja jepte vazhdimisht sadaka fshehur pa e ditur burri. Edhe burri, po kështu, jepte sadaka fshehur pa e ditur gruaja. Dhe nuk e di se ç’bënin kur viheshin ballëpërballë, kur “kapnin në flagrancë” njëri-tjetrin duke dhënë sadaka fshehurazi! Vetëm një gjë është e sigurt: gruaja ishte një grua e drejtë e besnike dhe burri ishte një burrë i drejtë e besnik. Po kështu edhe fëmijët që do të dilnin në një shtëpi të tillë, ishin kandidatë për t’u bërë njerëz të drejtë, të ndershëm e besnikë!

Familja e krijuar prej gruas dhe burrit që zbatojnë disiplinën e agjërimit të urdhëruar nga Allahu, si dhe shoqëria dhe kombi të formuar prej familjesh të tilla janë kandidatë për një dimension tjetër të qetësisë dhe sigurisë.

Krahas këtyre cilësive, këta njerëz janë jashtëzakonisht të ndjeshëm edhe për ruajtjen dhe mbrojtjen me fanatizëm të nderit dhe dinjitetit të tyre. Nëse jetojnë, jetojnë për besimin, fenë, nderin dhe dinjitetin e tyre. Ja, këta janë të lumturit në këtë botë e në jetën e mbrame në Ahiret! Nëse struktura e organizuar nga Kurani, që i trajton gruan dhe burrin bashkërisht, gjen mishërimin e vet, është më e shenjta e strukturave. Nëse në familjen e formuar nga këto dy shtylla fryjnë flladet e shpirtit kombëtar, edhe te bijtë, nipërit dhe

²²Ahزاب: 35

mbesat e tyre do të ndjehet e njëjta frymë. Përmirësimi social është në raport të drejtë me vazhdimësinë e kësaj atmosfere të të gjithë individët e familjes, pra, te qelizat e shoqërisë. Në të kundërt, të gjitha ato që priten kthehen në fantazi.

Dhe tani të përpiqemi që të bëjmë një përmbledhje të çështjeve shoqëri, familje, fole e lumtur duke i parë nga tjetër pikëvështrim.

2. Prindër dhe fëmijë

Kur e shohim këtë çështje nën dritën e teksteve të shtrenjta të Islamit, shohim se Kurani dëshiron që personat që Allahu (xh.sh.) i do, do t'i dojë e do të jetë i kënaqur me ta, të jenë sa më shumë. Në të vërtetë, edhe të gjithë profetët, të urtët dhe njerëzit e tjerë të pëlqyer, kanë dëshiruar shtimin e brezave të pastër dhe kanë zhvilluar sisteme në këtë drejtim.

Lutjen dhe përgjërimit me ndjenjat më të sinqerta të profetit Zekerija drejtuar Allahut, Kurani e përshkruan kështu në suren Al-i Imran:

“Aty Zekerija iu lut Zotit: “Zoti im, më fal mua një pasardhës të pastër! Pa dyshim, Ti e dëgjon lutjen ashtu siç duhet!”²³

Po ta vëmë re me kujdes, profeti Zekerija nuk kërkoi vetëm një pasardhës çfarëdo, por “të pastër”! Ai donte të thoshte: *“Më fal një pasardhës të pastër që ta bëjë Allahun të kënaqur, Profetin, me pëlqim, të atin, të lumtur e që të bëhet një element i rëndësishëm mes shoqërisë!”* Edhe Ibrahim i nderuar (a.s.) me të birin, Ismailin (a.s.), kur po ndërtonin Qaben, i luteshin Zotit kështu:

“Zoti ynë! Na bëj ne nga ata që të binden Ty! Nxirr prej brezit tonë një bashkësi të bindur ndaj Teje, ..., na trego sesi duhet të të falemi Ty dhe na i prano pendimet, se vetëm Ti je Pranues i pendimeve dhe Mëshirues i madh!”²⁴

Pastaj, fakti që ndër pasardhësit e tyre, krahas shumë profetëve e qindra prijësve shpirtërorë, doli faja e bardhë e njerëzimit, Profeti Muhamed (s.a.s.), është shprehje e pranimit të kësaj lutjeje të rëndësishme. Në mënyrë të veçantë, të gjithë njerëzit e shquar të umetit, po kështu janë lutur dhe kanë kërkuar nga Allahu (xh.sh.) breza pasardhësish të pastër e të mirë.

“(Dhe ata robtë) thonë: “Zoti ynë, falna ne bashkëshorte që të na i ndriçojnë sytë dhe bëna ne prijës të të devotshmëve!”²⁵

Si këta, edhe në tekste të tjera të shenjta mund të vërehet se kërkohen breza të pastër si fryte të krijimit të familjes. Po, në të gjitha këto lutje është tërhequr vëmendja mbi breza të pastër, të pafajshëm, të pamëkatë, besimtarë e të bindur. Me një fjalë, çështja nuk qëndron te sasia e personave që do të dalin dhe rriten në shtëpitë tona, por thellësia e tyre cilësore si dhe pranueshmëria e tyre në lartësinë e Allahut (xh.sh.). Arritja e kësaj pranueshmërie duhet të ketë rrugë dhe metoda të caktuara.

Dhe tani dëshirojmë të hedhim një vështrim të shkurtër mbi disa prej tyre.

3. Detyrat e kryetarit të familjes

- a) Masat para lindjes së fëmijës: mjedis banimi, ushqime, veshmbathje, etj.
- b) Praktikë dhe edukim: vënia e një emri të bukur fëmijës, mëkimi me gji, planifikimi i shpenzimeve dhe edukimit sipas moshës dhe veçorive të tjera personale.
- c) Ndjenja e përgjegjësisë në edukim.
- d) Të mëdhenjtë e familjes duhet të jenë të pajisur me moralin e lartë islam, duke qenë njëkohësisht shembuj të mirë për më të vegjlit.

Le të përpiqemi t'i shohim këto një e nga një.

²³Imran: 38

²⁴Bakara: 128

²⁵Furkan: 74

a) Masat para lindjes së fëmijës

i) Fara e pastër

Hedhja e farës në një truall të pastër, pastaj, ajrimi me ajër të pastër tek zhvillohet aty ku është hedhur, ujitja me ujëra të pastra dhe kryerja e shërbimeve të duhura, të gjitha këto kanë shumë rëndësi për përgatitjen e një brezi cilësor. Vetëm për ta mbështetur këtë konsideratë, hadithi i mëposhtëm i Profetit (s.a.s.) përbën një vlerë më vete: *"I ulëti është qysh në bark të nënës i pafat, kurse i larti është qysh në bark të nënës me fat!"*²⁶

Po, duhen marrë të gjitha masat para se fëmija në bark të nënës të marrë rrugën e të përfunduarit në një të ulët dhe të pafat! Qysh në çastin kur bashkohen spermatozoidi me vezën, ushqimi i fëmijës së ardhshëm, sjelljet e nënës, si dhe qëndrimet e mëparshme e të mëpasshme të nënës e të babait janë pretekste me rëndësi në shkrimin e tij si i ulët a i lartë.

Duhet të dihet mirë që për asnjë lloj vendimi nuk mund të bëhet fjalë pa u vënë në llogari vullneti dhe sjelljet tona. Krijuesi i Lartë e di se si do të veprojmë ne, ç'hapa do të hedhim, ç'do të rezultojë nga këto hapa dhe, duke futur në llogari edhe vullnetin tonë, është programuar çdo gjë. Sa fëmijë ka që, si rrjedhojë e mjedisit ku kanë dalë dhe faktorëve shkakësorë të tij, janë të pafat qysh nga çasti kur vijnë në këtë botë. Ndërkaq, është një përjashtim nëse Allahu (xh.xh.), me bujarinë dhe mirësinë e Tij, e kthen gjendjen e tyre në lumturi!

Po, çdo gjë nis qysh në çastin kur hidhet fara. Po qe se fëmija i ardhshëm është i ulët apo i lartë qysh në vezë, ndikimi negativ në këtë fatalitet i ushqimit të pabekuar (gjësë së ngrënë pa të drejtë), mëkatësia e nënës dhe babait nuk mund të nënvleftësohen. Nëse fara është hedhur pa nisur me emrin e Zotit, mbirja prej saj e një prodhimi të dobishëm i ka mbetur mirësisë së Zotit në dorë. Edhe në mos qoftë e pamundur të merret rezultat i drejtë nga një iniciativë e shtrembër, është shumë e vështirë. Nuk po themi është e pamundur, sepse, meqë edhe nga Ebu Xhehli ka dalë një njeri i tillë si Ikrimja, edhe nga familjet me jetesë shumë negative, madje, disa herë mund të dalin njerëz me besim.

Në mënyrë të veçantë, ajeti i mëposhtëm, nga njëra anë parashtron se nëna dhe babai mund të kenë një sërë dëshirash dhe kërkesash, nga ana tjetër orienton se ata duhet t'i kthejnë sytë kah Allahu (xh.xh.) për t'i kërkuar Atij fëmijë të mirë!

ii) Ushqimi duhet të jetë hallall

Njëra prej detyrave të prindërve është edhe që, ashtu siç duhet t'i kushtojnë kujdes ushqimit të vet, edhe fëmijët t'i ushqejnë me gjëra të mira, të këndshme dhe të bekuara, hallall. Nëse një mysliman u jep për të ngrënë pjesëtarëve të familjes një gjë haram, ju patëm kujtuar se martesë e tij konsiderohet haram ose mekruh (e papëlqyeshme), megjithëse këto konsiderata, nga pikëpamja juridike, janë të diskutueshme. Por, pa dyshim, askush s'ka të drejtë t'i ushqejë të tjerët me gjëra haram!

Nisur nga kjo, jemi të detyruar t'i ushqejmë fëmijët dhe pjesëtarët e tjerë të familjes që kemi në ngarkim, me gjëra të mira, të këndshme e të bekuara. Nuk mund të justifikohemi duke e quajtur këtë një "shqetësim të përgjithshëm" ose të themi, "si të gjithë, edhe ne!" Edhe nëse koha ka ndryshuar, edhe nëse ka ardhur një epokë tjetër, edhe nëse çdokush vepron në rrugë të paligjshme, ne nuk mund t'i ushqejmë ata me gjëra të pabekuara. Pa dyshim, edhe fitimi që kemi arritur me rrugë të gabuara, edhe fëmijët tanë të ushqyer me atë fitim, vjen një ditë që, si oleandra e ferrit, të na e helmojnë trurin, ndoshta të na bëjnë të vjellim gjak!

Nëse i kemi bërë detyrat e mëparshme, mund të presim që çdo mik i ri që do të na vijë në botë, të jetë një i lumtur, i mbrojtur, në një farë mase, ndaj fatkeqësive. Por, po qe se ajo që hamë është haram, ajo që pimë është haram, ajo që vishemi është haram dhe, në përgjithësi, jetojmë në mes të haramit, do të thotë se e kemi asgjësuar mundësinë që fëmija ynë të bëhet i lumtur e i lartë!

Sigurisht, nëse hamë haram, pimë haram, ushqehemi me haram, quhemi se botën tonë shpirtërore po e mbajmë të hapur ndaj djallit. Ai qarkullon nëpër damarët e gjakut të njeriut: *"Shejtani lëviz me lëvizjen e*

²⁶Et-Taberani, *el-Muce'mul eusat* 3/107, 8/323; Për një qasje më të afërt shihni: Ibn Maxhe, *mukadime*, 7.

gjakut në damarët e njeriut!"²⁷ Ai ua shalon rruazave të kuqe e të bardha, duke ua ngjitur nga pas shkëndijat e veta edhe fëmijëve, edhe sojit të tyre!

Prandaj, qysh në fillim, përkujdesja për fëmijën, ushqimi dhe veshja, çdo gjë duhet kryer duke mbetur brenda kuadrit të konsideruar legjitim nga feja. Fëmija nuk duhet ushqyer, veshur e mbathur me gjëra të ndaluara, të siguruara me rrugë jo të drejta e të pabekuara!

Me sa kemi parë nëpër hadithe, ndërsa personi që po bën tavaf Qaben e Allahut (xh.xh.), hedhur krahëve një mbulesë të fituar haram dhe ushqyer me me gjëra të palejuara, thotë: "Lebbejk Allahumme lebbejk", "Urdhëro, Allahu im, urdhëro!" – e cila është një thënie e shenjtë, që thuhet gjatë haxhit dhe periudhës kur je i veshur me ihramin – Allahu (xh.xh.) do t'i thotë atij "La lebbejke ve la sa'dejk"²⁸. Shqip kësaj i thonë: "Mbaji për vete, edhe leb'bejkun, edhe sa'dejkun!"

Prandaj duhet të bëjmë kujdes që edhe peri me të cilin kemi qepur rrobën, të mos jetë haram ose me dyshim, të mbështetemi te Allahu (xh.xh.) nga gjëra e dyshimtë ose gabimi i bërë pa dashje dhe, për këto gjëra, zemra duhet të na dridhet gjithmonë. Duhet ta dimë jashtë çdo diskutimi se çdo farë që do të mbjellim, ose do të bëhet oleandër për t'i helmuar të tjerët, ose, si një pemë me rrënjët e përhapura thellë në tokë, me frutat, hijen, degët dhe gjetet, do t'i shërbejë njerëzimit, madje edhe tjetërkujt breza me radhë, do të kontribuojë për lumturinë e njerëzimit dhe rregullimin dhe zbukurimin e faqes së tokës!

b) Mësim dhe edukim

Një ndër detyrat e para të prindërve është t'i vënë fëmijës një emër të mirë sipas porosive të Profetit Muhamed(s.a.s.). Profeti ynë i ka dhënë rëndësi të veçantë vënies së emrit. Ai ka porositur: "*Merrni emrat e profetëve. Emrat më të pëlqyer te Allahu i Lartë e i Shenjtë janë Abdullah dhe Abdurrahman. Emrat më të drejtë janë Harith (sjellës fitimi, fitues i ahiretit, jetës së pasme) dhe Humam (i vendosur). Kurse emrat më të shëmtuar janë Harp (luftë, dhunë) dhe Murre (koprrac)*"²⁹ Gjithashtu, Profeti ka hequr emrin Asije (kundërshtuese, kryengritëse) dhe në vend të tij ka vënë emrin Xhemile (e bukur, Bukuri).³⁰

Pas kësaj vijnë çështjet e procedurës ligjore të dhënies gjë fëmijës dhe, pas prerjes së gjirit, të marrjes përsipër të rritjes dhe edukimit të tij.

Çdo fëmijë lind me një natyrë të pastër.³¹ Pothuajse si një letër e bardhë ku nuk është shkruar asgjë më parë. Jeni ju që do të shkruani mbi të,, vetëm se veç ato gjëra që i pëlqejnë Allahut! Këto janë gjëra që u jep vlerë engjëlli, që janë të vlefshme pas ringjalljes në sheshin e grumbullimit dhe llogaridhënies, që, kur të vihen në pjatën e djathtë të peshores, të peshojnë e të kenë vlerë.

Ajo çka u bie si detyrë prindërve, është t'i bëjnë këto shkrime dhe qëndisma mbi shpirtin e fëmijës në stinën e vet dhe në atë mënyrë që të mos prishen e fshihen dot me kalimin e kohës. Sigurisht, çdo nënë dhe çdo baba janë të detyruar që një pjesë të jetës ditore t'ia kushtojnë mësimimit dhe edukimit të fëmijëve të tyre. Sa për institucionet e tjera të mësimimit dhe edukimit, përveç familjes, do të flasim më tej në pjesët në vazhdim.

Në arsimimin dhe edukimin e fëmijës, familja është mjedisi, vatra dhe shkolla e parë. Pa diskutim, kohën që veçojnë prindërit për mësimin dhe edukimin e fëmijëve, duhet ta parapëlqejnë më shumë se koha që veçojnë për disa detyra fetare apo edhe personale, individuale. Në rritjen e fëmijëve, mësimi mbi Allahun (xh.sh.), shtresimi i idesë së besimit në Allahun sipas moshës dhe nivelit kulturor të fëmijëve, kanë përparësi jo vetëm në begatimin moralo-shpirtëror të prindërve, por edhe në shumë detyra vetjake të tyre. Nisur nga kjo, po qe se ju shkoni për ta vizituar Qaben duke lënë në shtëpi ca fëmijë të prapë e të paedukuar, detyra do t'ju thërresë nga pas: "Ku po shkoni duke braktisur detyrën e këtushme, që është kaq e rëndësishme?"

²⁷Buhari, *ahkam*, 21; *bedu'l-halk*, 11; *i'tikaf*, 11, 12, *edeb* 121; Muslim, *selam*, 23, 24.

²⁸El- Bezar, *el-Musned*, 15/221; et-Taberani, *el-Muxhem'ul-esuat*, 5/251.

²⁹Ebu Davud, *edem*, 61; Nesai, *hajl*, 3; Ahmed bin Hanbel, *el-Musned*, 4/345.

³⁰Muslim, *adab*, 14; Tirmidhiu, *edeb*, 66; Ebu Davud, *edeb*, 62.

³¹Buhari, *xhenaiz*, 80, 93; *tefsiru sure*, (30) 1, *kader* 3; Muslim, *kader* 22-25.

Veçanërisht, babai duhet t'ia mësojë djalit jetën dhe fenë, shkrimin dhe këndimin, madje, sipas moshës, edhe notin, qitjen apo kalërimin. Duhet t'ia mësojë, jo sportet që ia kushtojnë fuqinë e mendjes vetëm zhvillimit të muskujve, por të gjitha sportet e dobishme për jetën dhe shëndetin dhe të tilla, që secila prej tyre, në fushën e vet, të përbëjë një parathënie për të ardhmen.

c) Ndjenja e përgjegjësisë në edukim

Po dua ta bëj titull të kësaj çështjeje një citat me burim imamí. Në veprën e tij, *"Risaletul Hukuk"*³², imam Zejnul Abidini jep këtë këshillë:

"Duhet ta dish se fëmija, produkti i përpjekjes sate, është prej teje; po kështu, edhe e mira apo e keqja e tij ka për të t'u kthyer po ty!"

Pak kohë para se të vdiste, Profeti Muhamed(s.a.s.) e pati parandjerë vdekjen. Një ditë, papritmas, u pati thënë kështu sahabëve: *"Robi u la i lirë të zgjidhte mes kësaj bote dhe ahiretit (jetës së pasme) dhe ai zgjodhi ahiretin!"* Ndërkaq, Ebu Bekri që e pati rrokur menjëherë kuptimin e këtyre fjalëve, pati thënë duke shpërthyer në lot: *"Nënë e babë t'u bëfshin fli, o i Dërguari i Allahut!"*³³ Robi për të cilin kishte folur Profeti, ishte vetë Ai!.. Veç kësaj, në një hutben e tij gjatë Haxhit të Lamtumirës, ai i pati pyetur njerëzit: *"Së afërmi do t'ju pyesin për mua nëse e kreuva detyrën e kumtesës; ç'përgjigje do të jepni?"* Ai i pati pyetur njerëzit sepse kishte kryer një detyrë, por nuk ishte i sigurt nëse e kishte kryer me të drejtë dhe plotësisht, apo jo, megjithëse puna vetë bërtiste me të madhe se s'kishte vend për një pasiguri të tillë. Të gjitha zemrat që ndodheshin aty patën bërtitur me të madhe, madje gjithë sheshi pati jehuar nga pohimi i njëzëshëm: *"Po, e mbarove, përgjegjësinë në vend e çove, na mësove e na këshillove!"* Atëherë ai e pati ngritur gishtin tregues lart drejt qiellit duke thënë tri herë: *"Ji dëshmitar, o Zot! Ji dëshmitar, o Zot! Ji dëshmitar, o Zot!"*³⁴

Ai fliste me shqetësimin e thellë për një përgjegjësi të gjerë në kuadrin e umetit, dhe në fund merrte medoemos dëshminë e sahabëve të Tij. Dhe tani, a jemi vallë, ne, në gjendje ne të themi para fëmijëve tanë, të cilat janë drejtpërsëdrejti nën përgjegjësinë tonë dhe me kujdesin ndaj të cilëve jemi ngarkuar, *"Së afërmi do t'ju pyesin për mua, si do të përgjigjeni?"* Ose, a kemi shpresë të marrim prej tyre përgjigjen, *"Po e keni kryer detyrën siç duhej?"* Nëse jo, atëherë të mjerët ne!.. Prandaj, imami i madh, Zejnul-Abidini, thotë: *"Ti do të merresh në pyetje përpara Allahut(xh.xh.), ti do të merresh në pyetje!"* Dhe, duke u dridhur i drejtohet sërish Allahut: *"Allahu im, ndihmomë mua në edukimin e fëmijëve mi! Bëmë mua të mund t'i mësoj ata të bëjnë mirë!"* Sepse çështja më e rëndësishme, madje e domosdoshme e çdo njeriu është që, duke i lartësuar pjesëtarët e familjes në vlerat e përsosmërisë njerëzore, t'i bëjë ata të ndjejnë ëndjet e të qenit i përjetshëm!

Ndonjëherë, u marrim dhurata fëmijëve dhe përpiqemi që t'i gëzojmë. Madje, shkojmë në haxh dhe, edhe në kohët kur ndodhemi para Qabesë ose të Dërguarit të Allahut (s.a.s.), i ndjejmë vazhdimisht tek i kemi në zemër. Edhe shërbimet më të shenjta e të rëndësishme nuk na bëjnë dot t'i harrojmë ata. Në të vërtetë, mënyra më e mirë e kujtimit të fëmijëve është t'u japim atyre edukatën islame dhe edukatën e të jetuarit që kemi mësuar prej Profetit Muhamed paqja qoftë mbi Të. Unë them se nuk duhet të ketë dhuratë që të mund të matet me këtë.

Përsëri, në një hadith me burim imamí, Profeti Muhamed (s.a.s.) porositi:

*"Bëjuni dhurata fëmijëve dhe edukojini në një mënyrë të mirë!"*³⁵ Po, një edukatë me orientim për ta ringjallur rrugën e Profetit (s.a.s.) është dhurata më e madhe që mund t'i jepet një fëmije!

³²(arab.) Traktat mbi drejtësinë

³³Buhariu, *menakibu'l ensar*, 45, fezaailu as'hab, 3; Muslim, *fedailu's-sahabe*, 2;

³⁴Buhariu, *haxh*, 132; Muslim, *haxh*, 147; Ebu Davud, *menasik*, 57.

³⁵Ibni Maxhe, *edep*, 3; el-Kudai, *musnedush'Shihab*, 1/389.

d) Të jesh përherë një shembull i mirë

Çdo nënë e baba mysliman, në mënyrë mjaft të natyrshme, mendojnë t'i edukojnë fëmijët në formën e një pjese të shëndoshë e të përkryer të asaj shoqërie ideale të cilën përpiqemi ta përfytyrojmë dhe përvijojmë sipas Kuranit. Ç'e do se, në qoftë se këto ndjenja të tyre nuk reflektohen në jetën praktike dhe nuk thellohen me adhurime të tilla si namazi, agjërimi, haxhi, zekati, ose, më e drejta, fjalët e bukura të thëna me gojë, nuk i përforcojnë me veprime dhe sjellje të bukura, nëse këto veprime dhe sjellje nuk duken më të bukura se fjalët, rezultati do të jetë i dobët ose i paqenë; pa le kur prindërit bëjnë të kundërtën e atyre që thonë ose këshillojnë! Prindërit që dëshirojnë që fjalët e tyre t'u dëgjohen prej fëmijëve, më së pari duhet t'i jetojnë vetë thellësisht.

Po përcjell këtu një rrëfim që i atribuohet imam Adhamit.

Në atë kohë, na ishte një djalë që i bënte dëm mjalti dhe, me gjithë këshillat për të mos ngrënë mjaltë, djali vazhdonte të hante. Ndërkaq, një ditë, e marrin djalin për dore, e çojnë te Imami dhe i thonë: "Këtij djali i bën dëm mjalti, por ai, megjithëse e këshillojmë, vazhdon të hajë!" Imam Adhami u thotë: "*Merreni djalin, shkoni në shtëpi dhe sillmani pas 40 ditësh!*" Pas dyzet ditësh e çojnë përsëri djalin te imami, i cili e merr djalin para vetes dhe e këshillon të mos hajë më mjaltë. Djali ngrihet nga vendi, ia puth dorën të atit dhe i thotë: "Baba, nuk kam për të ngrënë më asnjëherë mjaltë!" Atëherë, të pranishmit e pyesin imamin: "O imam, pse nuk e këshillove djalin kur e prumë për herë të parë, por na bëre të prisnim dyzet ditë?" Dhe ja ç'përgjigje u jep imam Adhami:

"Atë ditë që e prutë djalin te unë, unë kisha ngrënë mjaltë. Sikur të përpiqesha për ta bindur djalin të hiqte dorë nga një gjë që e kisha bërë vetë, ka shumë mundësi që të mos dukeshja i besueshëm para tij, dhe fjala ime të mos zinte vend. Gjatë këtyre dyzet ditëve, unë jo vetëm që s'hëngra më mjaltë, por e hodha atë krejtësisht nga trupi. Desha që të isha i besueshëm kur ta këshilloja djalin!"

Krahas fjalës së drejtë, ka shumë rëndësi veprimi i drejtë. Në sy të fëmijës, kundërshtia mes fjalëve dhe veprimeve tuaja e trondit besimin e tij tek ju. Në jetë, sikur edhe një herë të vetme t'ju kapë fëmija në gënjeshtëri ose në kundërshtitë mes fjalëve e veprimeve apo sjelljeve tuaja, për sa kohë do ta bartë këtë në mendje, në sytë e tij ju do të vazhdoni të mbeteni një njeri që s'i besohet. Po qe se pastaj, më vonë, nga sjelljet tuaja rrjedh ndonjë pakënaqësi e vogël, ajo del në mbivetëdijë dhe, në vështrimin e fëmijës, ju ngjani me dikë për të cilin ndihet neveri. Për pasojë, fjalët tuaja s'gjejnë aspak pasqyrim tek ai. Atëherë, sjelljet duhet t'i rregullojmë të tilla që, brenda shtëpisë, ata të na konsiderojnë neve jo nënë e baba, por engjëj. Ata duhet të shohin tek ne seriozitet, rëndësi, ndjeshmëri dhe duhet të na besojnë gjer në fund. Ja pra, prindërit që arrijnë me sukses t'i përcjellin mendimet dhe ndjenjat me një rrugë të tillë, quhen mësuesit më të suksesshëm.

4. Përgjegjësia e nënës dhe babait

Çdo njeri është përgjegjës për aq sa përfshihet brenda fushës së tij të përgjegjësisë, si dhe për ata që ka nën vete. Të gjitha sukseset në vëzhgimin dhe kujdesin përkatës do të shkruhen në shtyllën e mirësive dhe bukurive tuaja, kurse të gjitha e papëlqyeshme, në shtyllën e të këqijave dhe shëmtive.

Në një hadith të Tij që përmbahet te Buhariu dhe Muslimi, Kryeprofeti (s.a.s.) porositi kështu: "*Secili nga ju jeni çoban dhe përgjegjës për ata që keni nën vete. Kryetari i shtetit është çoban dhe përgjegjës për nënshtetasit. Çdo person është çoban dhe përgjegjës për tufën e vet. Gruaja është çobaneshë e shtëpisë së burrit dhe përgjegjës për gjërat që ka nën kujdes. Shërbëtori është çobani i mallit dhe pasurisë së të zotit, dhe është përgjegjës për t'i ruajtur ato. Secili prej jush është çoban dhe secili prej jush përgjegjës për tufën e vet!*"³⁶

Meqë tema ka lidhje me pranimin e faktit që fëmijët janë nga një amanet i mëvetësishëm, mund të thuhet edhe se ky hadith ka një lidhje të drejtpërdrejtë me çështjen tonë: "*Çdo fëmijë që lind, lind me natyrë islame, pastaj prindërit e bëjnë atë krishterë, hebre ose idhujtar.*"³⁷

Po, çdo fëmijë që lind, lind me një natyrë të pastër e të përshtatshme për t'u bërë gjithçka, pastaj ju dorëzohet juve për t'i zhvilluar atij dhuntitë dhe aftësitë, pra, puna për edukimin e tyre ju lihet juve në

³⁶Buhariu, *ahkam*, 1; *xhuma*, 11; Muslim, *imaret*, 20.

³⁷Buhari *xhenaiz*, 80, 93; Tefsiri i sures 30, ajeti 1; *kader*, 3; Muslim, *kader*, 22-25.

dorë. Kështu, fëmijët, në përputhje me atë ç'janë prindërit e tij, bëhen ose krishterë, ose hebrenj, ose adhurues të zjarrit, zoroastrianë. Natyrisht, këtu mund të shtohet edhe një tjetër specifikë: përsëri në përputhje me mjedisin e prindërve, fëmijët, të cilët bëhen ose renegatë, ose ateistë. Në këto kushte, themi se aq sa ç'është i rëndësishëm besimi dhe individualiteti i prindërve në rritjen e fëmijëve, është i rëndësishëm edhe për t'u marrë për bazë në edukimin e tyre.

Është një e vërtetë kjo që, nëse fëmijët e përshtatshëm për çdo gjë, të cilët i prumë në këtë botë të përshtatshëm ndaj çdo përparimi, nuk i formësojmë sipas rrënjëve tona shpirtërore e kuptimore, është e pamënjatshme që të rriten e formohen si njerëz të një kallëpi të veçantë. Për rrjedhojë, mund të bëhen babai i një renegati pa i rënë aspak në të kësaj. Atëherë themi se në kohën e duhur, duhet që ta parandalojmë tjetërsimin e tyre, duke ua shartuar atyre esencën e shpirtit tonë, ta parandalojmë tjetërsimin e tyre. Ne u bëjmë shërbimet e duhura pemëve duke shfrytëzuar të gjitha mundësitë e shkencës dhe teknikës, në mënyrë që të marrim sa më shumë prodhim. Po a nuk duhet që të kujdesemi po kaq për fëmijët tanë që s'vlejnë më pak se druri, guri, pema dhe dheu? Përkundër dy mospërparësive të tilla, si tkurrja e mosinteresimit dhe harbimi i përpjekjeve destruktive, fëmijët zotërojnë avantazhin e vetëm të gjërave të mira që do t'u japin prindërit. Sigurisht, po të mos u bëhet një ndërhyrje pozitive, ata fillojnë të marrin erë dhe të prishen në duar të tjerëve. Në të dy situatat ata ndjekin një drejtim tjetër prej tonit, i cili mund të jetë kreyekreje në drejtim të kundërt me ne. Në mënyrë të veçantë në ditët tona, meqë prindërit janë kredhur në punët e kësaj bote me tërë fuqinë e tyre; i kanë braktisur fëmijët plotësisht. Madje është e pamundur të tregohet një shekull tjetër kur fëmijët të jenë lënë kaq pas dore.

Përsëri në një hadith me burim imamí, i Dërguari i Allahut (s.a.s.) jep një ferman me këto fjalë: *"Në Kohën e Fundme, mjerë fëmijët për shkak të baballarëve të tyre!"*³⁸ Sahabet e pyesin të habitur:

- U dënuan për shkak të baballarëve të tyre politeistë dhe humbën?
- Jo, baballarët besimtarë i vranë ata!
- Si ndodhi, o i Dërguari i Allahut?
- Baballarët's'ua mësuan atyre shtyllat e fesë!

Këtë hadith, porosi profetike, mund ta shtjellojmë shkurtimisht kështu:

Shtyllat e fesë u braktisën për këtë botë të vogël. Ata që e patën për detyrë, e nënvleftësuan krejtësisht edukimin fetar duke i përqendruar të gjitha orvatjet vetëm për aspektin material të jetës. Ata e lanë mënjanë jetën ndjesore e shpirtërore për interesa të një bote të vogël.

Ata nuk i dhanë rëndësi mësimit të njohurive fetare duke menduar se këndimi i Kuranit, mësimi dhe njohja e frymës së Tij, mësimi dhe praktikimi i fesë na marrin shumë kohë.

Kuptimi i hadithit të mësipërm paraqet një përputhje të plotë me këtë ajet:

*"Jo, jo, ju e pëlqeni shumë atë që e ka shpërblimin dhe kënaqësinë të çastit, kurse ahiretin (përfundimin e kësaj) e nënvleftësoni!"*³⁹

I Dërguari i Allahut e vazhdon fjalën e tij kështu: *"Unë s'kam të bëj me ta, as ata mos paçin të bëjnë me mua!"*

Me fjalë të tjera, ai do të thotë: *"Unë s'kam të bëj me ata prindër që e lënë pas dore fëmijën, që i mbyllin sytë para humbjes së fëmijës, për më tepër, që nuk dridhen përballë shkatërrimit të një brezi; edhe ata mos paçin të bëjnë me mua!"* Pandeh se të gjithë baballarët që nuk kanë vdekur shpirtërisht, rrëqethen dhe dridhen para këtij paralajmërimi të ashpër, dhe duhet të dridhen! Kur kalifit Omer bin Abdulaziz iu tregua për një përgjegjësi të tillë të rëndësishme e jetësore, i ra të fikët dhe nuk u përmend dot për njëzet e katër orë. Madje nisi t'i rrinë mbi krye e t'i këndojnë Kuran me mendimin se po vdes. Pastaj, kur u përmend, nisi të qante e të thoshte se kishte frikë nga Allahu. Po, ai e ndente mbi supe përgjegjësinë e atyre që kishte nën vete dhe tronditej me frikën se mos po ua shkelte disi të drejtat.

³⁸Hadithet që mendohet se janë transmetuar prej Zejnul Abidinit, ngaqë nuk gjenden në "Kutubu Sitte".

³⁹Kiamet: 20

Po ne? Ne, të pamëshirshmit në trajtën e nënës dhe babait që nënvleftësojmë ndjenjat dhe shpirtin e fëmijëve që i sollëm në këtë jetë në atë follenë familjare të ngritur duke marrë për bazë kënaqësitë personale, sa herë duhet të humbim ndjenjat dhe sa duhet të dridhemi?

Ç'është e vërteta, të gjitha hadithet rreth kësaj teme janë të tilla, që afrojnë ose frikësojnë. Edhe ne, pikërisht nga ky këndvështrim e trajtojmë çështjen. Por, natyrisht, kemi edhe shumë gjëra për të bërë, janë përgjegjësitë që na kanë ngarkuar Islami dhe Kurani për rritjen dhe formimin e fëmijëve tanë. Janë çështjet që i radhitëm më parë në formë parimesh e që mendojmë t'i shtjellojmë më tej, çështje këto shumë të rëndësishme, si edukimi i fëmijëve tanë si njerëz të ndjeshëm, të thellë, të moralshëm e fetarë dhe edukimi edhe i vetes sonë si një baba i vyer e si një nënë e vyer në atë familje.

a) *Ruajtja e drejtësisë mes fëmijëve*

Në krye të këtyre çështjeve vjen parimi i trajtimit të barabartë të fëmijëve, pra, i mosparapëlqimit të dikujt ndaj dikujt tjetër. Edhe gabimi ose e meta më e vogël në këtë çështje mjafton që të na bëjë ne të paaftë për të ndikuar mbi fëmijët tanë. Sa kuptimplote janë orientimet e Profetit tonë (s.a.s.) në këtë çështje.

I ati i Numan ibn Beshirit (r.a.), Hz. Beshiri (atë e bir qenë myslimanë dhe nga sahabët e Profetit që morën pjesë në luftën e Bedrit), shkoi te Profeti dhe i tha:

- O i Dërguari i Allahut, kam edhe fëmijë të tjerë, por Numani është ndryshe nga të tërë. Po të më lejosh, dëshiroj t'ia jap Numanit një pjesë të pasurisë!

Profeti (s.a.s.) e pyeti:

- A do t'u japësh edhe të tjerëve nga kaq?

- Jo, - i tha Beshiri.

Duke ia drejtuar fjalën të gjithë të pranishmëve, i Dërguari i Allahut tha kështu:

- *Kini frikë Allahun dhe trajtojini fëmijët me drejtësi!*

Pastaj, duke iu drejtuar Beshirit, i tha:

- *A dëshiron që të gjithë fëmijët të të respektojnë njëllor?*

- Po, - iu përgjigj Beshiri.

- *Atëherë, mos vepro kështu!*⁴⁰

I Dërguari i Allahut propozon një zgjidhje parimore të çështjes dhe e zgjidh që nga themelet një problem të mundshëm. Sigurisht, brenda një shtëpie, parapëlqimi i njërit fëmijë ndaj të tjerëve së pari nxit te fëmijët e tjerë ndjenjën e zilisë ndaj vëllait apo motrës së zgjedhur, duke i bërë dalëngadalë fëmijët, që janë vëllezër e motra me njëri-tjetrit, armiq të njëri-tjetrit. Mos mendoni se këto çështje përpiqemi t'i shpjegojmë duke u mbështetur në parimet e ngushta të psikologjisë. Ne këtu përqendrohemi mbi universalitetin e të vërtetave që Kurani kërkon të na i bëjë të njohura për shpirtrat, mbi përshtatshmërinë e atyre të vërtetave ndaj natyrës së njeriut, mbi objektivitetin, logjikshmërinë dhe karakterin njerëzor të tyre.

Siç dihet, Jusufi (a.s.) pati parë në ëndërr yjet, hënën dhe diellin të binin në sexhde para tij. Kur ia pati hapur të atit këtë situatë të gëzueshme dhe krenaridhënëse, ai i pati thënë: "*O bir, mos ua trego vëllezërve këtë!*"⁴¹ Ai njeri i madh që e njihte natyrën njerëzore me një thellësi profetike, e pati parashikuar se një çështje e tillë do të zgjonte ndjenjën e zilisë tek të vëllezërit dhe pati menduar se tregimi i një ëndrre të tillë njerëzve që s'e kishin arritur ende pastrimin e vetvetes, do të shkaktonte tek ta ndjenjën e keqe të zilisë. Për fat të keq, gjërat që pati frikë ai, ndodhën, të vëllezërit e hodhën Jusufin në pus për të vdekur aty, duke nxjerrë në shesh faktin se ku mund ta çojë padurimi njeriun qoftë edhe në një familje profetike!

⁴⁰Buhari, *hibe*, 12; Muslimi, *hibat*, 9.

⁴¹Jusuf: 5.

Sigurisht, është krejt e qartë se parapëlqimi në dashuri dhe çështje të tjera i njerit fëmijë ndaj të tjerëve do të nxisë ndjenjën e zilisë të fëmijëve të tjerë, dhe pa u kuptuar fare, si rrjedhojë e trajtimit të diferencuar të prindërve, do të ushqejë tek ta një ndjenjë urrejtjeje të nënvetëdijshme.

Këto konsiderata i kuptojmë më mirë kur i mendojmë së bashku me shkaqet, faktorët dhe burimet e tyre të nënvetëdijshme. Ju keni një shok shumë të sinqertë e aq të afërt saqë s'bëni dot asgjë pa njëritjetrin. Mirëpo, gjithsesi, një herë nuk është treguar dot bujar ndaj jush dhe, në një moment, me egoizmin e tij, ka shfaqur një sjellje që nuk e keni pritur aspak prej tij. Dhe ju, dashje pa dashje, e keni fshehur këtë në një skaj të kujtesës. Pothuajse çdo ngjarje kalon duke lënë një gjurmë në trurin e njeriut për t'u ringjallur me fuqi, pastaj, me anë të një ngjarjeje tjetër. Kështu edhe ju, më vonë, para një ngjarjeje që jua kujton dhe jua ndez ato ndjenja të pakëndshme që flenë në heshtje në nënvetëdijen tuaj, zemëroheni menjëherë dhe i thoni atij: "Fundja unë e pata kuptuar qysh në fillim se i tillë je ti!"

Dhe tani mendoni grumbullimin një mbi një të këtyre ngjarjeve negative dhe ringjalljen me forcë të disave prej tyre. Dhe ç'bëni atëherë ju? Pothuajse të gjitha këto turbullira të ardhura nga një e kaluar e gjatë, ia përplasni atij njeriu në fytyrë dhe pastaj përpiqeni t'i dilni në mbrojtje vetvetes tuaj. Ja pra, kështu do të ndodhë edhe me fëmijën tuaj, mendimet e të cilit, të shtresuara në kujtesë apo nënvetëdijë, do të ringjallen me forcë, dhe një qëndrim çfarëdo i juaj negativ mes fëmijëve do ta zemërojë dhe nxisë atë kundër jush duke dhënë si rezultat që ai të mos ju dëgjojë dhe të mos ju bindet fare!

Në fakt, kjo përbën vetëm një aspekt të çështjes. Nëse do ta trajtonim çështjen duke përfshirë në të gjithë jetën e fëmijës, puna ndërlikohet edhe më shumë. Sidomos po qe se ju ia lini çdo gjë fëmijërisë së tij dhe nuk futni në llogari ndryshimet që mund të pësojnë ndjenjat e tij në të ardhmen, do të vijë pa u kuptuar një ditë që të shembeni nën peshën e gabimeve tuaja. Ju mendoni se fëmija nuk i kupton, ua kalon anash e i harron sjelljet kontradiktore, fjalët, veprimet negative brenda shtëpisë, për të cilat është drejtpërsëdrejti dëshmitar, kurse në fakt të gjitha ato regjistrohen në një skaj të kujtesës së tij, ndoshta për të mos u fshirë më, sikur të regjistroheshin me stilograf brenda një fletoreje. Pastaj vjen koha dhe ato dalin në shesh të tëra menjëherë dhe kjo dalje, ky shpërthim jashtë, disa herë bëhet i tillë që e merr para, duke e zvarritur tërë familjen, madje bashkë me nënën dhe babanë!

Prandaj çdo njeri që kërkon të bëhet nënë e baba, duhet të njohë pedagogjinë dhe psikologjinë në një nivel të caktuar, ose të paktën t'i njohë parimet përkatëse të Kuranit dhe pastaj t'i thotë "Bismil'lah" një jete të re!

Rritja e fëmijëve nuk është një çështje e thjeshtë. Dikur qeshë bërë kureshtar pas bletëve dhe pata ndjekur një kurs për bletërritës. Dhe atëherë e pashë se sa e vështirë qe të merresh me bletë! Po si kjo, duhet mësuar patjetër rruga e rritjes dhe përgatitjes së brezave të mirë për t'i dhënë shoqërisë individë të mirë. Askush s'duhet ta harrojë se sa i rëndësishëm është edukimi i një qenieje me potencial të madh që përjeton sa e sa vajtje-ardhje mes nivelit më të lartë dhe nivelit më të ulët të vlerave të ekzistencës së vet, për ta ngjitur atë në nivelin më të lartë të të qenit njeri!

b) Fëmijët duhen trajtuar me seriozitet

Profeti Muhamed (s.a.s.) i trajtonte fëmijët me shumë seriozitet. Kur ata i vinin pranë, Ai u drejtohej atyre me mirësjellje, sikur të ishin të rritur, pastaj e merrte dikë mbi shpinë, dikë në prehër dhe, duke i trajtuar barazisht, i linte të largoheshin të gjithë të kënaqur.

Disa herë, kur takonte në rrugë fëmijë që luanin, u drejtohej si të mëdhenjve duke i përshëndetur: "Es-selamu alejkum!" Atëherë edhe ata i përgjigjeshin po aq seriozisht: "Ue alejkum selam, o i Dërguari i Allahut!"⁴² Ai u jepte shumë vlerë fëmijëve. Nëse i jepte fjalën një fëmije për t'i dhënë diçka në një ditë dhe orë të caktuar, patjetër do ta çonte në vend fjalën sikur të kishte bërë marrëveshje me një të rritur!

c) Përftimi i ndjenjës së bindjes

⁴²Ebu Davud, *edeb*, 135, 136; Ibni Maxhe, *edeb*, 14; Ahmed bin Hanbel, *el-Musned* 3/235.

Një nga mendimet më të turpshme për qenien njerëzore është edhe ky: “Nuk duhet t’i zësh besë askujt, madje as babait tënd!” Është një mendim filozofik tejet i gabuar. Profeti (s.a.s.) u sugjeronte të tjerëve gjithmonë idenë e bindjes, dhe fëmijët që e njihnin nga afër, nuk dinin gjë tjetër për të veç bindjes. Në sy të çdokujt ai ishte *Emin*, i besueshëm. Gjithsesi, edhe shoqëria e përbërë prej të tillë individësh, do të ishte një shoqëri e besueshme dhe e bindur.

Veçanërisht, Profeti Muhamed (s.a.s.) ia tërhoqte vëmendjen umetit, se “*Allahu nuk e mëshiron atë që nuk tregon mëshirë për fëmijën e vet.*”⁴³ dhe u bënte thirrje besimtarëve që të bëheshin njerëz të ndjeshëm e me zemër të madhe. Ai e porosiste bashkësinë e tij në lidhje me fëmijët: “*Duajini ata! Kur t’u jepni fjalën, ta çoni në vend patjetër! Ata s’duhet të shohin kundërshti mes fjalëve dhe veprimeve tuaja, ata s’duhet të bëhen dëshmitarë të një gjëje të tillë!*”

Përsëri sipas një hadithi me burim imamí, Profeti ynë porositi: “*Nëse dikush prej jush i premtton fëmijës një gjë, ta mbajë premtimin medoemos, sido që të jetë!*” Kjo na e bën krejt të qartë se sa i gabuar është mendimi, “fëmijë është, nuk bëhet gjë edhe sikur ta gënjej!”.

Pa dyshim, çdo gënjeshtër dhe çdo thënie me kundërshti brenda vetes, si një farë e mbjellë në kokën e tij, në mos sot, nesër do të mbijë si një bimë helmuese dhe do t’i paralizojë përpjekjet tuaja edukative. Prindërit duhet të jenë gjithmonë të drejtë e në rrugë të drejtë. Fundja, nuk mund të pritët gjë tjetër pos drejtësisë prej jush që jeni njerëz të rrugës së drejtë!

Në asnjë mënyrë s’duhet t’u lini shteg fëmijëve që të thonë për ju: “gënjeu”, “s’e mbajti fjalën”, “u tregua i pangopur”, etj. Ata duhet t’ju shohin dhe t’ju njohin përherë si vetëmohues, besnikë të fjalës, besimtarë të durueshëm, të ndershëm dhe të virtytshëm!

d) Një edukim hap pas hapi

Fëmija duhet të dijë ato gjëra që janë të domosdoshme për t’i ditur, dhe duhet nuk duhet t’i mësojë ato gjëra që nuk është mirë që ai t’i dijë. Ai duhet të mësohet dhe edukohet në mënyrë të shkallëzuar sipas moshës. Këtë çështje mendojmë që ta trajtojmë më gjerësisht në pjesët e mëtejshme.

Ashtu siç mbështetemi në mendimin dhe porositë e specialistëve përkatës për ta ushqyer fëmijën e porsalindur, ashtu edhe duhet ta mësojmë dhe edukojmë atë sipas porosive të specialistëve të fushës së edukimit.

Nëse një fëmijë ka ardhur në moshën e shkollës së mesme, t’ia thoni kategorikisht, pa asnjë argument, “Zoti ekziston!”, kjo mund të mos vlejë për gjë tjetër veçse që ai ta mohojë Zotin. Ndoshta në atë moshë duhen dhënë njohuri të kombinuara shkencore-filozofike që të ndikojnë anasjelltas në formimin e opinionit të ekzistencës së Zotit. Por po qe se ngriheni për t’i mësuar fëmijës filozofi qysh në vitet e para të shkollës, do t’ia turbulloni mendjen krejtësisht. Atëherë pra, ashtu si një mjek, jemi të detyruar që t’i japim disa gjëra fëmijës duke pasur parasysh nivelin e tij, moshën dhe mjedisin kulturor, etj.

⁴³El-Bezar, *el-Musned*, 12/15.

PJESA E TRETË

Delikatesë në edukim

Delikatesa në edukim

Nëse foleja familjare që do të ngrini ose që keni ngritur, është në një kuadër që do t'i bënte të kënaqur Allahun (xh.xh.) dhe Profetin (s.a.s.), mund të thuhet se premtori të ardhme. E thënë ndryshe, nëse brezat që do të rritni e do të përgatisni, janë të orientuar për t'u bërë umet, bashkësi e Profetit (s.a.s.), mund të konsiderohet se e kanë rrugën të hapur, kurse ju mund të konsideroheni të lumtur. Por në qoftë se brezat e përgatitur nga ju, u janë lënë amanet rrugëve dhe janë në kundërshtim me fenë, madje, armiq të xhamisë, xhematit, ata konsiderohen të pafatë, kurse ju, përgjegjës për fatkeqësinë e tyre. Kjo është, së pari, padrejtësi ndaj fëmijëve, pastaj dhe ndaj vetë shoqërisë. Askush nuk ka të drejtë të bëjë një të keqe të tillë. Neve do të na kërkojnë llogari për brezat e përgatitur si armiq të Islamit, që hanë e pinë prej gjërave të ndaluara, që me sjelljet e tyre jolegjitime, shkelin rregullat e përgjithshme. Përgatitja e brezave të aftë për të menduar në mënyrë besnike ndaj rrënjëve ideore të veta, të thellë, me horizont të gjerë, të mëshirshëm dhe të respektueshëm ndaj njeriut, është një nga detyrat tona kryesore. Kjo detyrë e rëndësishme fillon me ngritjen e vetëdijshme të folesë familjare dhe vazhdon gjatë gjithë jetës e kushtëzuar nga arsyeja, logjika dhe gjykimi.

Nisur nga kjo, familja duhet trajtuar si një institucion i mbështetur në frymën e fesë, që ka si bosht arsyen dhe vetëdijen, të cilit i duhet dhënë vazhdimësi duke marrë për bazë pëlqimin e Allahut (xh.sh). Profeti Muhamed (s.a.s.) tërheq vëmendjen se ka për t'u krenuar me shtimin dhe shumimin e umetit të Tij. Nga ky këndvështrim, një brez që s'e njeh Atë, sado i madh në numër të jetë, jo vetëm nuk do të ketë ndonjë vlerë para Allahut (xh.xh.), por nuk do të përbëjë vlerë as sipas Profetit tonë të Dashur (s.a.s.).

Prandaj ne, nga njëra anë do t'i presim rrënjët e prirjes ndaj së keqes duke u kthyer nga Allahu e duke bërë pendesë, nga ana tjetër, me hapa që do ta fuqizonin prirjen ndaj së mirës me anë të lutjeve, adhurimeve dhe punëve të mira e të dobishme, duke bërë me dashuri çdo gjë të nevojshme, me punë e me fjalë, do të vazhdojmë të presim në mënyrë aktive.

Kurani urdhëron: *"Thuaj: "E keqja dhe e fëlliqura nuk janë njëllot me të mirën dhe të pastrën; edhe sikur e keqja dhe e fëlliqura të kenë epërsi numerike marramendëse e mahnitëse, ky realitet nuk ndryshon. Atëherë, o ju që keni arsye, kini frikë Allahun që të shpëtoni!"⁴⁴*

Po, disa herë mund të ndodhë që epërsia sasiore e së keqes dhe e të këqijve mund t'ju tërheqin vëmendjen e t'ju lënë të mahnitur, por duhet ta dini se, në vështrimin e Allahut, e ndyra me të bukurën kurrë s'kanë qenë të njëvlerëshme. Atëherë, ju gjithmonë duhet t'i jepni rëndësi përgatitjes së një brezi që, me bukuritë e tij të rrezatuara, t'ju kujtojë Xhenetin, ta ndiqni të bukurën dhe të bëheni prind, mësues dhe edukues i saj!

1. Sëmundja e banalitetit

Në një hadith të nivelit *sahih* (autentik), Profeti Muhamed (s.a.s.) thotë kështu: *"Në të ardhmen, ndjekësit e librit dhe kombe të tjera do të sulen mbi ju siç sulen i urituri mbi sofër, dhe do të kërkojnë t'ju marrin kafshatën prej goje!"* Me fjalë të tjera, do të hidhen mbi ju siç hidhet i urituri drejt bukës për t'ju rrëmbyer kuletën prej dore, për t'u ulur mbi gjërat që keni fituar ju.

Sahabët e pyesin: *"A do të ndodhë kjo për shkak se ne do të jemi të paktë në numër, o i Dërguari i Allahut?"* Dhe ai iu përgjigjet: *"Jo, përkundrazi, ju atë ditë do të jeni tejet të shumtë, por Allahu do ta ketë nxjerrë nga zemra e armiqve ndjenjën e ndrojtjes para jush (ju do të dukeni në sy të armiqve të padenjë*

⁴⁴Maide: 100.

për t'u respektuar, nuk do të falni siguri dhe nuk do t'i bëni dot ata ta ndjejnë peshën tuaj të vërtetë); gjithashtu, *Allahu do t'ju fusë në zemër ndjenjën e banalitetit!*"⁴⁵

Sahabët e pyesin: "Ç'është thotë "uehen-banalitet", o i Dërguari i Allahut?" Dhe ai u përgjigjet: "Uehen do të thotë dashuri për këtë botë (kalimtare), vënie e kësaj bote në plan të parë dhe frikësim nga vdekja."⁴⁶

Pa dyshim, nëse një shoqëri e vë këtë botë, duke e trajtuar në anët e saj që kanë lidhje me interesa materiale, egoiste e të ulëta, pra, që kanë lidhje me anët e saj banale, si synim duke u orientuar kah ajo me zemër e shpirt dhe duke e lënë mënjanë pëlqimin e Allahut, pra, po qe se parapëlqen këtë botë dhe gjërat e saj ndaj Allahut, edhe sikur të thotë "La ilahe il'Allah, nuk ka zot tjetër veç Allahut", nuk mund të thuhet se e ka orientuar zemrën dhe shpirtin kah Allahu. Këtu, duke thënë, "Allahu do të fusë në zemrën tuaj banalitetin dhe atëherë ju para armiqve do të bini të mundur", si dhe, në një hadith tjetër, duke folur mbi heqjen e ndrojtjes së armiqve, Profeti Muhamed (s.a.s.) tërheq vëmendjen mbi nënvleftësimin e disa detyrave, si "urdhërimi i të mirës dhe ndalimi i të keqes"⁴⁷, parashtrimi i besimit mbi ringjalljen dhe llogaridhënien.

Atëherë, qëllimi më i madh për ne duhet të jetë përgatitja e një brezi shumë besimtar, tejet të fuqishëm materialisht e moralisht, të vullnetshëm për të çarë malet, parashikues sa për ta hedhur poshtë botën në aspektet e saj banale dhe të shenjtë sa për të mos i dhënë vend në zemër banalitetit, si dhe impresionues përballë armikut.

2. Detyra e gruas

Profeti (s.a.s.) porositi: "Allahu (xh.xh.) për asnjë gjë nuk ka ndëshkuar aq rëndë sa ç'ka ndëshkuar për nënvleftësimin dhe shkeljen e të drejtave të grave dhe fëmijëve, pra, ajo çka e prek më shumë durimin hyjnor është gjendja e grave dhe fëmijëve!" Kur gruaja nuk e kryen detyrën e saj, kur ajo jepet pas fantazive të ndryshme jashtë detyrës së saj, kur fëmijët braktisen, kurse të rinjtë turbullohen nga mendtë, kur epshi kthehet në fitim, duhet të kemi frikë nga humbja e durimit hyjnor.

Padyshim, që një brez që e ka lëshuar veten në mëkate me vullnetin e vet, një brez i shkatërruar, i shtënë pas ndjenjave të ulëta, është i paracaktuar të bjerë nën ndëshkimin hyjnor. Atëherë, detyra e parë që i bie çdo kryetari të ardhshëm familjeje është që të zgjedhë për shok të jetës një femër myslimane, besimtare, të përkorët, besnike, durimtare, të sinqertë e të mirë. Sepse vetëm një mësuese dhe edukatore e tillë, një bashkëshorte me të cilën mund të diskutosh e të ndash çdo gjë në jetë, është baza më e rëndësishme e lumturisë së të dy botëve. Sigurisht, kur njeriut do t'i duhet t'i parashtrijë ndjenjat materiale e shpirtërore, do t'i duhet edhe një bashkëshorte me kokë e zemër që të mund t'i kuptojnë dhe ndjejnë ato, gjë që është tejet e rëndësishme, sepse fëmijët që do të dalin në atë shtëpi, do të rriten nën vëzhgimin e një mësueseje dhe edukatoreje të tillë.

3. Cilësia mbi gjithçka

Kurani, ku rëndësia që i jepet sasisë është e kufizuar, bën këtë sqarim:

"Pa dyshim, Allahu në shumë vende (fusha lufte) dhe në luftën e Hunejnit ju ka ndihmuar juve. Epërsia numerike ju pati bërë t'ju pëlqejë vetja, por nuk pati vlejtur aspak për t'ju shpëtuar nga disfata. Me gjithë gjerësinë e saj, toka ju pati ardhur e ngushtë dhe, më në fund, ju qetë shpërndarë e kthyer mbrapsht."⁴⁸

Luftën e Hunejnit Profeti ynë (s.a.s.) e pati zhvilluar pas ngadhënjimit të Mekës. Në fillim, përballë Heuzinit, myslimanët nuk qenë sjellë siç u takonte. Atë ditë për të cilën bën fjalë Kurani,

⁴⁵Banaliteti në origjinal është "uehen", e cila përmendet si një sëmundje që do t'i kaplojë myslimanët, ku ata do të mashtrohen prej bukurive të përkohshme të kësaj bote, duke mos pasur aspak frikë prej përkohshmërisë së tyre. (shën. red.)

⁴⁶Ebu Davud, *melahim*, 5; Ahmed bin Hanbel, *el-Musned*, 2/359, 5/278.

⁴⁷Në origjinal: emr-i bi'l-ma'ruf nehj-i ani'l-munker.

⁴⁸Teube: 25.

ata të bekuar, duke parë vazhdimin e favorit të Allahut për ta, patën menduar: “Nuk ka ushtri që të mund t’i qëndrojë përballë ushtrisë së Islamit!” Por, kur e patën parë veten para shigjetarëve të Heuzinit, nuk kishin mundësi t’i shpëtonin dot një tronditjeje të përkohshme. Kjo do të thotë se dhe mes njerëzish të bekuar si ta, ka që mendojnë kështu si dhe del në shesh se epërsia numerike nuk është aq me rëndësi.

Sigurisht, e rëndësishme është thellësia, pësia e personalitetit, është të jesh i matur. Ndërkaq, meqë ata qenë të afërtit të Allahut (xh.xh.)⁴⁹, tronditja e përkohshme atje dhe tërheqja është, sipas tyre, gjynah, mëkat, kurse sipas nesh, jo. Ajo çka kërkohet të theksohet këtu, është se, pavarësisht nga koha dhe vendi, epërsia numerike nuk është e rëndësishme. Edhe Kurani këtë na tregon. Duke mbajtur parasysh faktin që kuptimi i këtij ajeti nuk është zvetënuar aspak dhe konkluzioni i tij nuk e ka humbur assesit aktualitetin, duhet të themi se, pavarësisht nga gjeografia ku ndodhen, myslimanët duhet ta lidhin çdo gjë jo pas epërsisë numerike, por pas marrëdhënies me Allahun, pas cilësisë, pas thellësisë shpirtërore.

Edhe sikur të ndodheni në pakicë e të dobët si bashkësi e Muhamedit (s.a.s.), po qe se mund të orientoheni kah Allahu dhe të jetoni gjithmonë me emocionin e tregimit të diçkaje, me ndihmën dhe favorin e Allahut (xh.xh.), patjetër që do të arrini sukses. Në të kundërt, po qe se tërhiqeni në shtëpitë tuaja dhe e harroni marrëdhënien me Të, Allahu na ruajttë, sado shumë që të bëheni e sado epërsi numerike që të keni, nuk do të përbëni kurrfarë vlere!

4. Detyrat ndaj fëmijës

a) Përgatitja e mjedisit të edukimit

Që fëmijët tanë të mund të rriten në mënyrë të përsosur, është kusht që edhe mjedisi ku rriten dhe edukohen të jetë po i tillë. Sigurisht, çdo fëmijë formësohet sipas mjedisit, dhe në njëfarë kuptimi, konsiderohet fëmija i atij mjedisi. Në krye të elementeve të mjedisit në fjalë vjen familja. Pastaj, shkolla. I treti, shokët dhe miqtë. I katërti, rrethi shoqëror i mësimeve dhe i studimit. Në jetën shoqërore mund të përmendim edhe dyqanin e rrobaqepësit, punishten e marangozit, qendrën e pastrimit të rrobave dhe sektorë të tjerë të shërbimeve. Po qe se ju nuk keni bërë dot një vlerësim të mirë të këtij mjedisi dhe nuk i keni zhvilluar instinktet e tij në këtë drejtim, infektimi i tij një ditë me një virus çfarëdo është i pashmangshëm. Sigurisht, po qe se mjedisi është i prishur, edhe fëmija një ditë patjetër do të prishet. Prandaj mjedisin, duke filluar që nga familja e duke vazhduar në çdo etapë të rrugës dhe njësi të jetës, duhet ta bëni të përshtatshëm për rritjen dhe edukimin e përsosur të fëmijës suaj, sepse, pasi të ngajë e keqja, është e pamundur t’i kthesh gjërat nga fillimi dhe ta rregullosh gjendjen.

b) Ushqyerja i fëmijës me gjëra hallall

Edhe ushqimi i fëmijës me gjëra hallall, të fituara me të drejtë e në mënyrë legjitime, duke filluar nga periudha e parë e formimit të tij që në barkun e nënës, ka rëndësi të jashtëzakonshme. Duhet ta dimë në mënyrë të prerë se, në periudhën e zhvillimit të fëmijës, një shkoputje në një ndodhi çfarëdo në të cilën jemi të detyruar të lidhemi pas Allahut (xh.sh.), reflektohet edhe te fëmija si një rrethanë negative qoftë edhe përkohësisht, gjë që është nga dukuritë e shpeshta.

Një sasi haram në damarët tuaj ose një send i dyshimtë që e keni shtënë në dorë në këtë apo atë mënyrë, duke pasur parasysh këtu, qoftë ju, qoftë gruan tuaj, mund të bëhet shkak për rrëshqitjen e përkohshme ose të përrjetshme të asaj fëmije.

c) Mbrojtja nga syri i keq

⁴⁹Në origjinal: mukarrebîn (arab.i, e afërt me dikë a diçka).

Pasi të vijë fëmija në botë, ashtu siç kujdesemi për ushqimin, mirërritjen dhe pamjen e tij, ka shumë rëndësi edhe që ta mbrojmë atë edhe nga syri i keq.

Për shembull, patjetër duhet llogaritur që, nën rrezatimet e syve mëkatarë të dikujt me ndjenja, mendime dhe sjellje të fëlliqura, disa ndjenja të holla të fëmijës mund të atrofizohen.

Të gjitha këto janë pjesë të detyrave që duhet të plotësojmë ndaj fëmijës si shprehje të marrëdhënieve tona me fenë dhe Allahun (xh.xh.) e me fenë. Po t'i realizojmë siç duhet këto detyra, me përpikmëri, mund të kthehemi në një shoqëri engjëjsh.

d) Rregullimi i mjedisit familjar

Në hadithin profetik porositet: Fjala e parë që duhet të thotë fëmija kur fillon të flasë, duhet të jetë *“La ilahe il’lallah, nuk ka zot tjetër veç Allahut!”*⁵⁰

Kur fëmija është ende 2-3 vjeç, fjalët e para që i dalin nga goja vetvetiu janë *“nënë dhe baba”*, kurse fjala që ai duhet ta thotë së pari, me vullnet, duhet të jetë *“Allah”*. Sepse Allahu është Paraekzistent, Pasekzistent dhe i Gjithëqenë⁵¹. Pastaj, pas këtij shtresimi bazë, mbi të do të ngrihen gjëra të tjera, rreth të cilave do të mbështillen, sipas moshës dhe horizontit njohës të Tij, termat atdhe, tokë, flamur, liri, pavarësi, etj. Kur fëmija të jetë në vitet e para të shkollës, do t'i jepen njohuri sipas asaj moshe. Kur të shkojë në të mesmen, ku do të merret me filozofi, shkenca shoqërore, etj, do të mbështetet dhe përforcohet me materialet e atij niveli. Po që se në një shtëpi ka respekt ndaj Allahut dhe bisedohet shpesh për Të, mund të konsiderohet se kemi kapur synimin për ta bërë fëmijën të thotë atë që kërkojmë të thotë. Sigurisht, në qoftë se në një shtëpi bihet në ruku e në sexhde me emrin e Allahut dhe ndjehet një impresionim i thellë kur përmendet emri i Tij, nuk do të jetë e vështirë që fjala e parë që do të thotë fëmija në mënyrë të vullnetshme, të jetë *“Allah”*! Sepse në një shtëpi të tillë çdo gjë mendohet se ecën në orbitën e vet!

e) Sistemimi i dozës së dashurisë

Kur Allahu të na dhurojë një fëmijë, ashtu siç shprehet edhe Kurani, nuk duhet të ndodhë që, duke u lëshuar pas tij me të gjithë zemrën dhe me një dashuri të pakufishme, të kalojmë në ekstrem duke shfaqur, larg qoftë, ndaj fëmijës një dashuri si ndaj Allahut!

Një sjellje e këtillë, në vështrimin e Allahut (xh.xh.), mund të quhet si njëfarë politeizmi. Po, nuk ka dyshim se shtënia drejtpërdrejt pas dashurisë për fëmijën duke e harruar Allahun është një gabim i madh. Veçanërisht, në një aspekt, edhe një dashuri që do t'ju shtynte ju në veprime të tilla të pallogaritura ndaj fëmijës është e dëmshme. Ja pra, kjo duhet të jetë dashuria e ndaluar sipas Allahut (xh.xh.). Nëse dashurinë që duhet të tregoni ndaj Allahut (xh.xh.), e drejtoni ndaj një qenieje tjetër çfarëdo, të vdekshme, kjo mund ta prekë ndonjëherë durimin hyjnor.

Prandaj, matura në dashuri është shumë e rëndësishme sepse:

1. Mbreti i zemrave është Allahu (xh.xh.). Askush nuk duhet ta zërë në zemër vendin e dashurisë së përcaktuar për Të.

2. Duhet ta dimë pa dyshim se fëmija është amaneti i Allahut (xh.xh.) për ne. Dashuria dhe interesimi që ndjejmë ne për fëmijën është një paradhënie dhe stimul për ne me qëllim që të kujdesemi për atë amanet. Po, dashuria juaj për fëmijën është vetëm një dhuratë e Allahut Mëshirues e Shpërblyes që ju të kujdeseni pa të metë për atë amanet që Ai ju ka lënë në dorë.

f) Shembulli i mirë

⁵⁰El-Bejhakui, *Shuabu'l iman*, 6/398; el-Dejlemiu, *el-Musned*, 1/71.

⁵¹Në origjinal respektivisht: Evvel, Ezeli, Ebedi.

Ndjenjat që ushqejmë për fëmijët që po rrisim, mendimet, fjalët, jeta ndjesore, sjelljet tona duhet të kenë gjithmonë për synim nivelin e shembullores. Po deshëm që ata të rriten në mënyrë të përkryer, jemi të detyruar t'i kushtojmë jashtëzakonisht vëmendje kësaj veçorie. Për shembull, po dëshiroam që ata të falin namaz, duhet të falemi në sytë e tyre me kujdesin më të madh, duke treguar me sjelljen tonë kufijtë e edukatës që duhet treguar karshi Allahut (xh.xh.). Duhet të themi gjithmonë të drejtën duke u shmangur nga gënjeshtria. Po deshëm që ata të mos thonë fjalë të papërshtatshme, nuk duhet të përdorim në shtëpi asnjë fjalë të papërshtatshme dhe në kujtesën e tyre nuk duhet të shkruhet asnjë fjalë e tillë. Po menduam që të bëhen të vyer, që të jetojnë të ndershëm, që të jenë të ndjeshëm ndaj nderit të të tjerëve sa ndaj nderit të vet, duhet të bëjmë çmos që shembullin e kësaj ata ta marrin në shtëpi duke u bërë ne heronjtë e parë të kësaj pune.

Po deshëm që fëmijët tanë të këndojnë Kuran, që të bëhen të afërt të të vërtetave kuranore, duhet që në shtëpi të diskutohet Kurani nga mëngjesi në mbrëmje, duhet të tregojmë respekt për pozitën e lartë të Kuranit në mënyrë që të mos i shtyjmë ata drejt kundërshtive.

Prandaj, fjalët, ndjenjat, emocionet dhe sjelljet janë në shtëpi faktorët edukativë më me ndikim dhe duhet të vlerësohen patjetër. Ndryshe, nëse ua lini çështjen vetëm të tjerëve; duke u thënë: "Tregojini diçka këtij", s'keni bërë asgjë.

g) Edukimi i fëmijëve me ndjenjën e vlerësimit dhe dashurisë për Allahun

Siç dihet, në vitet e shkollës tetëvjeçare, më saktë gjer në moshën e pubertetit, fëmija nuk është i detyruar të kryejë detyra fetare, prandaj, nëse kryen ndonjë detyrë të tillë, por me të meta, kurrsesi nuk duhet qortuar.

Ndërkaq, duhet ditur edhe se gjithçka që do t'i themi a tregojmë fëmijës gjatë kësaj periudhe kur ai s'ka përgjegjësi fetare, do t'i mbetet përjetë në mendje e në zemër. Edhe ndjenja e vlerësimit është ndër gjërat që duhet t'i edukohen dhe nguliten atij në këtë periudhë. Kjo ka shumë rëndësi. Fëmija duhet t'i njohë të mirat që i vijnë dhe, para të mirave, duhet ta falënderojë edhe Allahun (xh.xh.), edhe njerëzit. Ndjenja e vlerësimit, e edukuar në këtë periudhë, do të bëjë që në të ardhmen ai të bëhet një njeri mirënjohës dhe falënderues. Madje, me kohë, kjo ndjenjë do të kthehet në një cilësi të pandashme të karakterit të tij.

Në këtë mes, një çështje të veçantë përbën tregimi fëmijës i dhembshurisë, mëshirës dhe bamirësisë së Allahut (xh.xh.) që na ka ushqyer e rritur me të mirat e Tij. Duhet t'i tregojmë fëmijës se si na ka ushqyer Allahu, si është kujdesur për ne, si na ka dhënë dashuri dhe, duke i thënë: "Allahu është shumë i dhembshur, na mbron ne nga të gjitha të këqijat dhe fatkeqësitë", të nxisim te fëmija ndjenjat e besimit, sigurisë dhe dashurisë ndaj Tij. Ne duhet t'ia bëjmë të qartë fëmijës, se edhe kafshët më të vogla ushqehen me mëshirën e Tij.

Kështu, në mendjen e fëmijës, gjithësia do të formësohet si një qenie që shqipton emrat Mëshirues e Bamirës, dhe saora ai do të ndjejë se të gjitha të mirat brenda shtëpisë i ka dërguar dikush dhe zemra e fëmijës do të mbushet plot dashuri e mirënjohje për Krijuesin dhe Dhuruesin e atyre të mirave!

Ndërkaq, sipas moshës, duhet t'ia kujtojmë vazhdimisht fëmijës se:

po nuk ia dha Ai, druri i shegës nuk jep shegë;

po nuk ia dha Ai, nga gjinjtë e kafshëve nuk rrjedh qumësht;

po nuk qe mëshira e Tij, nga qielli s'bie asnjë pikë shi;

po nuk tregoi mëshirë Ai, asnjë fije bari nuk mbin;

po nuk deshi Ai, ne nuk mund të flasim;

po nuk na bëri Ai të dëgjojmë, ne nuk mund të dëgjojmë;

po nuk ndërhyri Ai, goja nuk na njomet dot,

stomaku nuk na tret, veshkat nuk na funksionojnë...

Po, Ai është i zoti i të gjitha këtyre, biri im!

Nuk i kemi bërë ne këto, çdo gjë është prej Tij

dhe nën vëzhgimin e Tij.

Atëherë, biri im, po qe se zemra na mbushet

me dashuri për Allahun (xh.xh.) që i ka bërë këto

dhe që na ka dhënë neve këto të mira,

Ai do të na i shtojë, por po të tregohemi mosmirënjohës,

Ai ose do të na i ndërpresë të mirat,

ose do të na e heqë prej dore mundësinë

për të përfituar prej tyre!⁵²

Të gjitha këto do të përpiqemi t'ia bëjmë të ditura fëmijës edhe me sjelljet, edhe me fjalët, edhe me shikimet, edhe me të gjitha emocionet tona!

h) Tregimi me qëndrim ose komunikimi pa fjalë

Mënyra më me ndikim në procesin e mësimin dhe edukimit është tregimi dhe komunikimi me qëndrim, sjellje e gjeje. Rregullimi i përshtatshëm i jetës në shtëpi është pakrahasimisht më me ndikim në komunikimin e një ideje dhe në edukimin e fëmijës.

Kështu, sikur ta sillte rasti që fëmija t'ju shihte ju në një namaz të pasmesnatës duke u falur me një përkushtim të thellë, kjo do t'i tregonte atij, në një mënyrë prekëse e të pashlyeshme dashurinë tuaj të thellë ndaj Krijuesit. Por po qe se do të përpiqeshit t'ia tregonit ndjenjat tuaja vetëm me fjalë, nuk do të arrinit dot të bëheshit po aq i besueshëm dhe po aq i ndikueshëm mbi të.

Aishen e nderuar (r.a.) e patën pyetur se cili ishte morali i të Dërguarit të Allahut (s.a.s.) dhe ajo u qe përgjigjur: *"A nuk lexoni Kuran ju? Morali i Tij ishte Kurani!"⁵³*

Nga ky hadith ne kuptojmë këtë: i Dërguari i Allahut, profeti Muhamed (s.a.s.), kishte atë mënyrë jetese që përputhej me atë çka kërkonte Kurani.

Kështu, duke na e përcjellë ne Kuranin, na e përcillte të jetuar, të kthyer në jetë nga ai vetë. Në mes kishte një Kuran të jetuar në jetë dhe një jetë të lexueshme në Kuran. Prandaj ato që thoshte Profeti (s.a.s.) me fjalë dhe praktikisht, gjenin reflektim në zemrat dhe ndërgjegjjet e pastra, pranoheshin nga të gjithë dhe të gjithë përpiqeshin t'i vinin në jetë ato.

Prandaj, qëndrimet tona nuk duhet të jenë të ndryshme nga fjalët tona. Ky dallim quhet hipokrizi praktike. Ndryshimi brenda-jashtë e shtyn fëmijën në dyfytirësi, hipokrizi dhe në një mendësi dualiste. Sipas shprehjes së Kuranit, e bën atë të paqëndrueshëm.⁵⁴

Kur ju t'i flisni fëmijës për të mirat dhe dhuntitë e Allahut (xh.xh.), bashkë me ju edhe ai do të mbushet me ndjenjën e mirënjohjes dhe falënderimit dhe do të thotë: *"Mijëra herë falënderuar qoftë Allahu (xh.xh.) që na ka krijuar, na ka bërë njerëz dhe na ka pajisur me dhunti të panumërta, që na ka favorizuar shëndet, na ka dhënë prindër, që na dërgon çdo ditë sofrat të mirash të ndryshme, që ka krijuar ajrin, ujin, dheun, pemët dhe na i ka dhënë neve në përdorim!"*

Sidomos po t'i sugjeroni këto herë pas here e po t'i fusni në një orbitë të vetme bisedat dhe këshillimet që bëni në shtëpi, çdo gjë arrin një bukuri të veçantë.

i) Dhembshuria

⁵²shih Kurani, Sureja Ibrahim: 7.

⁵³Muslim, *salatu'l musafirin*, 139; Ebu Davud, *tatavu*, 26; Nesaiu, *këjamu'l lejl*, 2.

⁵⁴Në origjinal: muzebzeb (arab.); shih Kurani, Nisa: 143.

Në edukim, dhembshuria ka një vend të veçantë. Muhamedi i nderuar (s.a.s.) sillej me aq dhembshuri ndaj atyre që i kishte pranë e që i bënin shërbime të posaçme, saqë e linte në hije dashurinë dhe interesimin prindëror!

Enes bin Maliku (r.a.) rrëfen: *“I shërbeva të Dërguarit të Allahut dhjetë vjet, por nuk më kujtohet që të më ketë thënë “pse s’e bëre” për një gjë që s’e pata bërë dhe, “pse e bëre” për një gjë që e pata bërë. Ai kurrë nuk më qortoi.”*⁵⁵ Po, ai sillej kështu, me dhembshuri edhe ndaj të tjerëve duke i trajtuar më mirë se një prind. Kurse ndaj bijve dhe nipërve ishte jashtëzakonisht i butë e i dhembshur sa s’kishte ku të shkonte.

Nëse fëmija duhet të ketë medoemos frikë prej diçkaje, nuk duhet të kenë frikë nga druri, kërcënimi apo ndëshkimi, por nga humbja e dhembshurisë së prindërve. Nëse thartimi i fytyrës së të atit, përlotja e syve të nënës bëhen për të faktorët më veprues për ta sjellë në rregull, pandeh se kjo gjë mjafton dhe tepron. Ndërkaq, ka shumë rëndësi që fëmija t’ju besojë, të jetë i bindur se i ndjeni dhe bëheni pjesëtar i dhimbjeve apo vuajtjeve të tij. Kështu që, kur ai të qajë, në e bëfshi, edhe ju uluni e përlotuni, të paktën merrni pjesë në dëshpërimin e tij. Ashtu siç përpëlitet qielli⁵⁶ për disa njerëz, ashtu dhe ju, kur fëmija juaj është i prekur, kini mirësinë dhe prekuni si ai. Atëherë ju do të lartësoheni në sytë e tij, fjalët tuaja do të fitojnë vlerë dhe ndikim të madh mbi të, dhe aq shumë do të hyni në zemrën e tij, saqë asnjë forcë s’do të mund t’ju shkulë prej andej.

j) Autoriteti

Është shumë jetësore që në shtëpi të mos mungojë autoriteti. Po qe se në shtëpi nuk ka një autoritet që do të siguronte harmoninë e saj, shtëpia nuk do të shpëtonte dot nga turbullira e drejtimit, dhe fëmijët nga dualizmi i personalitetit.

Allahu (xh.xh.) urdhëron kështu në Kuran: *“Meqë Allahu i ka bërë një pjesë njerëzish të ndryshëm nga pjesa tjetër, dhe meqë burrat shpenzojnë nga malli i tyre, burrat janë kujdestarët dhe mbrojtësit e grave. Prandaj gratë e mira janë të bindura dhe e ruajnë të fshehtën dhe e mbrojnë nderin e tyre. Nëse i druheni kryelartësisë dhe kundërshtimit të tyre, këshillojini dhe, po qe nevoja, ndajeni shtratin me to, ose i rrihni lehtë pa i lënduar. Por nëse ju binden, mos u sillni keq ndaj tyre, sepse Allahu është i Lartë e i Madh!”*⁵⁷

Brenda shtëpisë, nisur nga disa veçori të caktuara, burri është përgjegjës për rregullin dhe harmoninë e përgjithshme. Madje mund të thuhet se ai është përgjegjës në shkallë të parë në shumë çështje. Në të vërtetë, edhe fëmijët kanë nevojë për një njeri të tillë përgjegjës. Fëmija që sheh qartë vetëdijen e përgjegjësisë brenda shtëpisë, sa të ketë jetën, s’ka për ta lëshuar veten në rrëmujë dhe papërgjegjësi. Në të kundërt, prania në shtëpi e dy vetëve të papërgjegjshëm dhe ardhja e urdhrave nga dy vende të ndryshme do ta bëjë rrëmujë mendimin e fëmijës.

Veçanërisht, kur fëmija të ketë frikë njërin nga prindërit, duhet të ketë mundësi të strehohet tek tjetri dhe ky tjetër duhet të jetë prehri i nënës. Kështu, fëmija nuk do të ndjejë vetmi. Në të kundërt, po qe se jeta familjare në shtëpi nuk mbështetet në një unitet të tillë, kundërshtitë dhe përplasjet do të vazhdojnë dhe në familjen ku gruaja është një kokë më vete dhe burri, një kokë më vete, fëmijët do të rriten pa ndjenja dhe të egër.

Ne mendojmë se, për brezat idealë, para së gjithash ka nevojë për një folë familjare ideale. Para së gjithash, familja duhet të lidhet pas Allahut (xh.xh.). Kur prindërit ose njëri prej tyre do ta marrë në dorë këtë çështje si një mëkëmbës i Allahut, pjesëtarët e familjes, si rrjedhojë e besnikërisë ndaj

⁵⁵Buhari, *edeb*, 39; Muslim, *fedail*, 13.

⁵⁶Bota e madhe është e lidhur me botën e vogël dhe mes tyre ka paralelizëm. Ndoshta, kur një besimtar është i prekur, edhe bota mëshirore preket po aq. Edhe pse cilësia e këtij realiteti dhe raporti nuk është fort e qartë dhe e kuptueshme për ne, mendoj se një vlerësim të tillë mund ta bëjmë: Emrat Rahman (Mëshirues) dhe Rahim (Bamirës, Mëshirëbërës) të Allahut (xh.xh.) janë burimi i çdo dhembshurie, delikatëse amëshire. Kur besimtarët preken, edhe mëshira fillon të veprojë në një formë që s’mund ta dimë, dhe, në mund të shprehemi kështu, merr pjesë në ndjenjat apo vuajtjet e tyre.

⁵⁷Nisa: 34.

Allahut, do të jenë aq të denjë, aq të vyer dhe zotërues të çështjeve, sa s'mund të ketë më tej, dhe në atë familje s'do të ketë më asnjë problem.

5. Pajisja me moralin e Allahut

a) Edukata e të folurit

Gjithsesi, në një shtëpi, do të bisedohen punët që kanë të bëjnë me këtë botë, çështjet që lidhen me jetën. Ndërkaq, kur këto gjëra bisedohen në prani të fëmijës, do mbajtur parasysh vazhdimisht prania e Tij. Ndërkaq, po të ketë mundësi, çështjet që nuk e interesojnë atë ose nuk i sjellin dobi atij, sidomos gjërat që do ta shqetësonin atë, të mos bisedohen në sy të tij. Sigurisht, veçoritë që do të zhvillohen në shpirtin e fëmijës në një periudhë të caktuar, duhet të përcaktohen shumë mirë dhe ai s'duhet të bëhet viktimë e gjërave të padurueshme për të. Kudo që të jemi, në shtëpi apo në punë, kur t'i kemi fëmijët pranë, takimet dhe bisedat duhet t'i bëjmë duke pasur parasysh gjithmonë praninë e tyre.

Me sa të kemi mundësi, bisedat në sy të fëmijëve duhet t'i bëjmë mbi çështje të tilla si besimi te Allahu (xh.xh.), te të mirat e dhëna prej Tij dhe feja e Tij. Parimisht, në shtëpi duhet të diskutohet për çështje që kanë lidhje me formimin dhe të ardhmen e fëmijëve në mënyrë që ata të rriten me vetëdijen që kërkojnë prindërit. Po qe se këto porosi pranohen si një recetë, një pjesë e madhe e problemeve që i përkasin të ardhmes së fëmijës marrin zgjidhje që më parë. Ndërkaq, çdo periudhë e jetës së fëmijës do të ketë edhe problemet e veta specifike tek të cilat do të ndalemi kur t'u vijë radha.

b) Masa në bujari dhe në dhembshuri

Një çështje tjetër që duam ta prekim këtu, është edhe zhvillimi i ndjenjës së bujarisë dhe dhembshurisë tek fëmijët, përgatitja e tyre si heronj të dhembshurisë. Edhe në këtë çështje, rruga më e drejtë është shembulli personal. Fjala vjen, kur vjen dikush te dera dhe shtrin dorën dhe burri me gruan dalin me duart plot me gjëra për të dhe, me një sjellje përvujtnie, ia dëgjojnë me kujdes hallet, kjo bëhet për fëmijën mësimi më me efekt për edukimin e tij si njeri i dhembshur e bujar.

Ndjenja e dhembshurisë te fëmijët është edhe e trashëgueshme. Për shembull, disa fëmijë, qysh të vegjël, përlohen shpejt. Kjo është shenjë se ata në të ardhmen do të bëhen njerëz pak a shumë të ndjeshëm, të brishtë, delikatë. Ç'është e vërteta, disa herë fëmijët përlohen për të tërhequr vëmendjen ose për të arritur që t'u plotësohen dëshirat, por përlojtja e ndjerë është diçka tjetër. Qoftë kështu apo ashtu, po qe se mendojmë t'i kemi ose të na bëhen fëmijët të butë, bujarë dhe të dhembshur, duhet ta bëjmë familjen një mjedis të ngrohtë, të butë, plot dashuri dhe dhembshuri mes pjesëtarëve të saj.

Rritja e fëmijës si koprrac, ose siç e quan populli, dorështrënguar, të dhënë pas interesave personale dhe mirëqenies materiale, mund të quhet shkak që, në vartësi të disa kushteve të caktuara, ai të bëhet egoist, interesaxhi, ambicioz, i pangopur dhe kundërshtues. Po qe se një fëmijë i tillë nuk rritet sipas moralit hyjnor, kjo gjendje përbën për të fatkeqësi si për jetën e kësaj bote, ashtu dhe për jetën e pasosur të tij.

Mëshira dhe dhembshuria janë shumë të rëndësishme. Bujaria është shfaqje e një shpirti të tillë. Heronjtë e dhembshurisë janë gjithmonë të humbur materialisht. Por bujari mund të hyjë në Xhenet edhe në qoftë mëkatar apo heretik, kurse mundësia e besimtarit koprrac për të hyrë në Xhenet është e ulët. Prandaj fëmijëve u duhet zhvilluar ndjenja e keqardhjes dhe dhembshurisë, u duhet shtuar ndjenja e dhënies dhe mirëbërësisë me qëllim që të mos bëhen ambiciozë e të jepen pas interesave të kësaj bote, e për rrjedhojë, të harrojnë Allahun dhe njerëzit. Sigurisht, do t'ia mësosh fëmijës të dhënë që të mos bëhet materialist, që në jetën shpirtërore të lidhet sa më fort pas Allahut (xh.xh.). Ndërkaq, le ta kujtojmë edhe një herë se, të dhënë, përse i përket vlerës si

shembull personal i edukatorit, po s'u tregua praktikisht dhe po s'u mbështet edhe me fjalë, nuk ka ndikim. Kur veprojmë, fjalët që i shoqërojnë veprimet bëhen ndikuese si frymëmarrje engjëjsh.

c) Shpërblimi

Fëmija duhet shpërblyer në raport me suksesin që arrin. Ndërkaq, duhet të theksojmë se qoftë në çështjet e jetës besimore-fetare, qoftë në çështjet materiale të kësaj bote, shpërblimi për çdo arritje ose sukses legjitim është domosdoshmëri e moralit hyjnor.

Nga ky këndvështrim, "nënë dhe baba" do të thotë pak edhe mendimtar, erudit dhe edukator. Prindërit do të dinë, do të mendojnë, do të vëzhgojnë, do të kujdesen për fëmijët dhe do të përpëliten mbi kokat e tyre. Sigurisht, po qe se prindërit nuk do t'u japin rëndësi fëmijëve sa ç'u japin makinës, kopshtit ose arës, është e qartë se ata do të mbeten të pazhvilluar në ndjenja e mendime, ose e thënë ndryshe, me ndjenja e mendime të atrofizuara. Edhe në këtë rast, ashtu siç u parashtrua më sipër, kur është fjala për edukimin tek fëmijët të ndjenjave të larta, duhet t'i drejtohem burimit bazë që është morali i Allahut (xh.xh.). Atyre që bëjnë punë të mira, Allahu u jep në jetën tjetër Xhenetin, kurse atyre që bëjnë punë të këqija, pashmangshmërisht ndëshkimin.

Kurani thotë: *"Po qe se falënderoni, edhe unë jua shtoj të mirat; po qe se tregoheni mosmirënjohës, ndëshkimi im është shumë i rëndë!"*⁵⁸

Dhe, të pajisur me moralin e Allahut, do të përpiqemi që sjelljet dhe qëndrimet tona para fëmijës t'i kemi aq të matura, sa edhe Allahu të mos na shtyjë ne në vetmi!

d) Përgatitja e fëmijës për të ardhmen

Një tjetër çështje që na duket me vend ta sqarojmë në fund, është edhe kjo: Trajtimi i fëmijëve sipas moshës, nivelit, dijeve dhe kulturës, duke mbajtur parasysh edhe mjedisin ku rriten e zhvillohen. Njohuritë fetare që duhet t'i japim një fëmije pesëvjeçar, duhet t'i zgjedhim me atë metodë që zgjedhim ushqimin me të cilin duhet ta ushqejmë në atë moshë. Njohuritë që do t'i japim fëmijës kur të bëhet shtatë vjeç, do të jenë tjetër gjë dhe, kur të bëhet dhjetë vjeç, tjetër gjë, e kështu me radhë.

Ndërkaq, është edhe një veçori e rëndësishme, sipas së cilës, çdo gjë që do t'ia sugjerojmë fëmijës, duhet të jetë për një periudhë më tej se e tashmja, sepse, sido që të jetë, ai e sheh, e dëgjon dhe e jeton të tashmen. Nga ky këndvështrim, niveli i edukatës që ne duam që ai të arrijë, duhet t'i përkasë të ardhmes së tij.

Aliu i nderuar (r.a.) porositi: *"Mësojini fëmijët për një kohë më tej se koha juaj sepse ata i përkasin një kohe përtej kohës suaj!"* Po qe se ky parim trajtohet nga këndvështrimi i dijes dhe kulturës së përgjithshme, kuptohet se mjaftimi me dijet dhe kulturën aktuale është mediokritet ose, më troç, do të thotë se, me kohë, tjetri vjen, ju zë e ju kalon, kurse ju mbeteni shumë pas! Trajtimi i këtij parimi nga këndvështrimi i mësimi dhe edukimit e ndihmon edukatorin, i cili duke e kapërcyer të tashmen dhe duke marrë parasysh periudhat e mëvonshme, të caktojë për fëmijën një vijë në përputhje me to. Kur fëmija të jetë gjashtë vjeç, t'i jepet një edukatë që t'i vlejë për në moshën shtatë vjeçare dhe, kur të bëhet shtatë vjeç, të zbatohet për të programi për moshën tetë vjeçare.

Si përmbledhje, mund të thuhet kështu: Mësimi dhe edukimi i zbatuar mbi fëmijën gjer më pesë vjeç duhet të vazhdohet shkallë-shkallë gjer në moshën pesëmbëdhjetë vjeç që është moshë mesatare e pubertetit. Po qe se ngriheni e i jepni të riut njëzetvjeçar edukimin që i përket një pesëmbëdhjetëvjeçari, do të thotë t'ia përmbysni çdo gjë që ka përvetësuar ai deri më tani mbi fenë, besimin dhe moralin.

Po qe se ju ngriheni për t'i dhënë ca gjëra personit që jeni ngarkuar ta mësoni dhe edukoni, pa e kuptuar nivelin e tij shoqëror, mendor e ideor, e largoni atë me ndjenja dhe shpirt nga ju. Nëse sot,

⁵⁸ Ibrahim: 7.

pavarësisht nga një sërë praktikash mësimore e edukative të gabuara, disa të rinj i kanë ndjenjat dhe mendimet ende të shëndosha, kjo është plotësisht një pasqyrim i mirësisë së Zotit për ta, ose ata nuk janë zhvilluar ende mendërisht; janë njëzet e pesë vjeç, por, si të ishin dhjetë a pesëmbëdhjetëvjeçarë, ndodhen shumë pas kohës në të cilën jetojnë. Nëse njëri prej këtyre përballat një ditë me një konsideratë të ndryshme fetare, kombëtare apo shoqërore çfarëdo që e kapërcen nivelin e tij, Zoti e ruajttë, tronditja në vlerat e veta dhe dezertimi i tij bëhen të paevitueshme!

Porosia që jep feja në lidhje me edukimin e shkallëzuar të fëmijëve është kështu: Në qoftë se fëmija e ka të detyruar namazin në moshën pesëmbëdhjetë vjeçare, mësojeni atë qysh kur është dhjetë vjeç. Kjo ka vlerë edhe për mësimin e fëmijës me agjërime disa vjet para se të vijë në moshën e detyrimit për këtë adhurim. Të njëjtën gjë mund të mendojmë edhe për specifika të tjera.

Dua të sqaroj edhe këtë që ne besojmë se dhënia e gjërave që i duhen dhënë fëmijës qysh në moshë të vogël është me ndikim më të madh. Ne mendojmë se nëse duam që fëmija t'i kryejë pa diskutim dhe plotësisht detyrimet fetare në moshën kur bëhet përgjegjës, përgatitja e tij duhet të fillojë qysh në moshë të vogël. Gjer tani ne e kemi parë shumë herë frytin e kësaj metode, jemi bërë dëshmitarë të kësaj shumë herë.

Këtu dua të flas mbi kriteret moshore të disa moshave, që na i ka dhënë imam Xhaferi:

“Gjer në shtatë vjeç është periudha fëminore e fëmijës, kur ai imiton gjërat që sheh dhe luan me lojëra të ndryshme. Ç’të shohë tek ju, e mëson dhe e imiton. Pastaj fillon mosha e marrjes së mësimave. Në fillim vjen periudha e mësimin të Librit të Allahut që kërkon edhe po aq kohë. Pas kësaj vjen periudha e mësimin të hallalleve dhe haramave që ai i kupton dhe përvetëson me arsye, logjikë dhe gjykim që kërkon përsëri po aq kohë.”

Sipas metodës së imam Xhaferit, gjer në moshën njëzet e një vjeç, fëmija ka plotësuar marrjen e të gjithë informacionit shoqëror dhe fetar të nevojshëm. Atëherë, ai, gjer në këtë moshë duhet të përvetësojë në mënyrë të pakundërshtueshme çdo gjë fetare e kombëtare që të mos tronditet nga erërat e ndryshme kundërshtare.

Në një hadith të përcjellë nga Tirmidhiu, Profeti ynë (s.a.s.) porositi kështu:

“Mësojuani namazin fëmijëve qysh në moshën shtatëvjeçare.”⁵⁹

Sepse, gjer në atë moshë, fëmija ka mësuar dhe është edukuar nga ju duke u nisur nga shembulli juaj. Pas kësaj, vjen koha kur ai do të mësojë duke vënë në punë arsyen dhe logjikën e vet, domethënë është gati të marrë mësim. Ndërkaq, disa e shohin këtë moment në moshën tetëvjeçare, kurse disa të tjerë, më e shumta, në moshën dhjetëvjeçare. Në moshën kur fillon mësimi i fëmijës, ai duhet trajtuar seriozisht dhe respektuar për t’iu zhvilluar personaliteti.

Profeti porositi: “Ndjenja e turpër është një nga shtyllat e rëndësishme të besimit!”⁶⁰ Kurse në një hadith tjetër, Ai porositi: “Ai që s’ka turp, s’ka as besim!”⁶¹ Atëherë, qysh në moshë të vogël duhet të përqendrohemi mbi brezat që mendojmë t’i rrisim të edukuar me frymën e të kuptuarit se ç’është turpi, në mënyrë që, kur të vijë në moshën e pjekurisë, të pajisen me moralin e Kuranit.

⁵⁹Tirmidhi, *salat*, 182; Ebu Davud, *salat*, 26; Darimiu, *salat*, 141.

⁶⁰Muslim, *iman*, 57, 58; Buhari, *iman*, 3.

⁶¹shih Ali el-Muttaki, *Kenzu’l-Ummal*, 3/119.

PJESA E KATËRT

Edukimi fetar i fëmijës

Edukimi fetar i fëmijës

Ashtu siç e parashtruam edhe më parë, martesë është një çështje shumë serioze në Islam dhe duhet trajtuar po me të njëjtin seriozitet. Në themel, ngaqë nëna dhe babai janë, në të njëjtën kohë, edhe mësuese dhe mësues, martesë duhet menduar kur kandidatët për bashkëshortë të vijnë në moshën që do të mund ta kryejnë edhe këtë mision.

Imam Xhaferi pati kërkuar një herë nga nxënësit e vet që ta shtynin martesën për më vonë. Edhe Ebu Hanifja e pati penguar për një kohë të caktuar nxënësin e vet, imam Ebu Jusufin nga martesë, duke i thënë: *“Para së gjithash duhet të plotësosh periudhën e mësimit dhe edukimit, andaj, gjersa të të vijë koha e martesës, duhet t’i kesh marrë patjetër dijet e nevojshme. Në të kundërt, jeta shkollore të mbetet përgjysmë. Veçanërisht, duhet të kesh një punë për t’ia siguruar me rrugë hallall jetën familjes. Kur t’i kesh plotësuar të gjitha këto, vija e jetës do të të bëhet edhe më e qartë!”* Ja, kështu e këshillonte Ebu Hanifja nxënësin e tij të vetëm, atë që në periudhën e kalifatit të abasive që ngjitur gjer në pozitën e shejhulislamit!

Nga këta dy persona, njëri është një burrë tejet i mençur, babai i teorisë së të drejtës juridike; Ebu Hanifja, imami i shkollës sonë juridike-fetare. Kurse tjetri, një imam i veçantë, i ardhur nga familja e Profetit (s.a.s.). Ajo çka duhet të kuptojmë ne nga këto dy raste, është se institucioni i martesës është një institucion mjaft serioz. Nisur nga kjo, duhet parë nëse ata që kanë për t’u martuar, kanë ardhur apo jo në nivelin e një mësuesi, e një edukuesi për të rritur fëmijë të shëndetshëm? Ose, a duket ta kenë moshën dhe mendjen për ta ndarë jetën me një bashkëshort apo bashkëshorte? A i kanë pajisjet e duhura për t’i përgatitur fëmijët sipas botëkuptimit tonë?

Në qoftë se kandidatët mund t’u përgjigjen pozitivisht këtyre pyetjeve tona dhe po të kenë edhe besim në vetvete, mund t’ia hyjnë kësaj pune të qetë. Por po që se kandidatët, të paaftë për të drejtuar edhe veten e vet, nuk mundën të gjejnë katër-pesë pika të përbashkëta për t’u marrë vesh dhe bashkëjetuar me të tjerët dhe nxjerrin çdo ditë ngatërresa të reja, nuk mund të thuhet se janë pjekur sa për t’u martuar dhe për të rritur fëmijë!

Sa bukur e thotë imami i Allvarit:

Sikur ti si ujërat të gurgullosh,

sikur si Ejubi të vajtosh

Aq sa mushkëria prej vendi të të dalë

A nuk do të shqetësohet Ai për ty?

Sikur ti në portën e Allahut,

dhe shpirtin ta flijosh,

e veç sipas urdhrave të Tij të veprosh

A nuk ta shpërblen Ai?

Po, nëse ne do të gurgullojmë përherë nga brenda si ujërat, nëse ne do të përpëlitemi sa andej këndeje duke thënë: *“A ka vende të tjera për të shkuar?”*, dhe duke ndjerë nga një ndjesi të re në çdo ndalesë, do ta kemi më të lehtë dhe më të shpejtë udhëtimin tonë drejt Allahut (xh.xh.).

Besimi ynë te Zoti pikërisht rreth kësaj qendre rrotullohet. Kemi një besim dhe bindje të fuqishme se Ai nuk ka për të na nxjerrë gënjeshtarë në fjalët tona.

Kjo ishte arsyeja përse u ndalëm veçanërisht në këto pika. Çështja kryesore që duhet përmendur është që rrugët e edukimit të brezave të rinj duhet të ushqehen me shpirtin e popullit. Nëse ju kujtohet, më sipër u përmend se si shtëpia jonë mund të kthehet në një faltore apo në një shkollë për t’u edukuar. Janë pikërisht prindërit, të cilët duhet t’i përjetojnë vetë cilësitë e dhembshurisë, mëshirës apo sjelljet e tjera njerëzore, që duan t’i shohin mandej të pasqyruara dhe te fëmijët e tyre.

1. Përgatitja e fëmijëve të shumanshëm

Nëse duam që fëmijët t'i kemi të guximshëm, me zemër, duhet të mos i frikësojmë me vampirë, diva, xhinde dhe peri. Ata duhet t'i rrisim e t'i përgatisim të fuqishëm, me një qëndresë të brendshme që të mund t'u kundërvihet të gjitha negativiteteve të mundshme!

Nëse duam që fëmijët të na bëhen besimtarë, duhet që, në të gjitha gjendjet tona, nga të gjitha sjelljet dhe veprimet, gjer te ndjeshmëria në çështje të caktuara, nga buzëqeshjet gjer te mënyra si biem e ngrihemi, nga devocioni i thellë në adhurimet e gjer te dhembshuria e thellë ndaj të tjerëve, ta tregojmë hapur se i besojmë Allahut, në mënyrë që ndjesitë e fëmijëve tanë të mbushen me këto gjëra. Po, ne duhet të jemi ashtu siç duan të na shohin ata, duke u shmangur nga sjelljet që do të na e rrëzonin vlerën që mund të kemi në sytë e tyre!

Duhet të përpiqemi gjithmonë që në sytë e tyre të jemi të mëdhenj e të çmuar në mënyrë që fjalët që themi, të gjejnë reflektim në zemrat e tyre e që të mos tregojnë reaksion jo pozitiv ndaj kërkesave tona. Nga ky këndvështrim, mund të thuhet se etërit e shpenguar mund të bëhen, shumë shumë, shokë për fëmijët e tyre, por kurrsesi mësues, edukatorë, pra dhe nuk mund t'i edukojnë ata siç dëshirojnë!

Shtëpitë tona duhet të kenë gjithmonë pamjen e një shkolle, një faltoreje, një vendi edukimi, në mënyrë që, duke ua ngopur atyre zemrën e shpirtin, të mos lejojmë që të bëhen robër e skllëvër të dëshirave të ulëta.

2. T'i ambientejmë fëmijët me xhaminë qysh kur janë të vegjël

Në periudhën e Profetit Muhamed (s.a.s.), fëmijët, sado të vegjël të ishin, mund të hynin në xhami në çdo kohë. Por sa e hidhur është që, në ditët tona, dërgimin e fëmijëve në xhami e shohim krejtësisht në kundërshtim me etikën e xhamisë! Gjithashtu, sa e hidhur është që në çdo xhami mund të gjinden ca pleq të prapë që u duken fëmijëve si gogolë, që i trembin e i bëjnë të largohen nga xhamia. Për fat të keq, disa herë, njerëz të moshuar me njohuri fetare dhe botëkuptim tepër të ngushtë pandehin, se duke thartuar fytyrën apo ngrysur vetullat para fëmijëve, e mbrojnë dinjitetin e xhamisë! Kurse me këtë qëndrim ata i trembin fëmijët nga xhamia dhe i kundërvihen synetit të Profetit (s.a.s.)! Përsa i përket rregullimit të radhëve të faljes në xhami, Profeti këshillon që para të vendosen burrat, pas tyre fëmijët dhe, duke u mbështetur mbi një konsideratë njerëzore, këshillon që, pas fëmijëve, të vendosen gratë.⁶²

Ja, pra, kur veprohet kështu, fëmijët do ta shohin e ndjejnë kënaqësinë e njerëzve në namaz dhe do t'u shtohet interesimi për ta jetuar besimin dhe fenë. Prandaj nuk duhet t'i përzëmë, t'u dukemi të ashpër apo jo t'i trembim ata, por në qoftë me vend, t'u japim dhurata dhe t'i afrojmë më tepër ndaj namazit. Duhet t'ua bëjmë të dashur fëmijëve xhaminë, oborrin dhe lulishten e saj, dhe ta mbajmë shenjtërinë e faltores të gjallë në ndjenjat e tyre. Profeti e mbante në sup të nipin e Tij, Umamen ndërsa drejtonte faljen në xhami; e ulte poshtë kur përkulej dhe e merrte sërish kur ngrihej!⁶³ Fakti që këtë e bënte i Dërguari i Madh (s.a.s.) që ishte njeriu që ndiqej prej të gjithëve, dhe udhëzuesi i përgjithshëm, ka rëndësi të madhe që të merret si model .

Nuk ka ndodhur kurrë që Profeti (s.a.s.) të thotë ndonjë fjalë të ashpër apo të mbajë ndonjë qëndrim që do të konsiderohej shkak për t'i nxjerrë fëmijët nga xhamia. Prandaj xhaminë duhet ta bëjmë një kënd të bukur të lagjes, dhe shtëpinë, një faltore, në mënyrë që, sa herë t'i hapë sytë fëmija, të ndodhet përballë me shenja që ia kujtojnë Allahun (xh.xh.), për rrjedhojë, ta ndjejë jetën brenda një atmosfere hyjnore dhe, me vullnet e ndërgjegje të lirë, ta përcaktojë vetë rrugën e të ecë në të! Po qe se e trajtojmë çështjen vetëm në lidhje me namazin, kur fëmija të hyjë në moshën për të falur namaz, po qe se i ati e kap për dore, e ul në një skaj të sexhades pranë s'ëmës dhe arrin ta lidhë me zemër dhe ndjenja pas "altarit" të tij të përjetshëm në përmasat e atmosferës që e rrethon, ka arritur një sukses shumë të rëndësishëm, sepse namazi është një gjë shumë e rëndësishme për t'iu drejtuar Allahut!

3. Mënjanimi i mëdyshjeve që në fillim

⁶²Ahmed bin Hanbel, *el-Musned*, 5/344; et-Taberani, *el-Muxhemul-kebir*, 3/291.

⁶³Buhari, *salat*, 106; Muslim, *mesaxhid*, 41.

Fëmija mund të ketë disa mëdyshje mbi namazin dhe çështjet fetare që e tejkalojnë atë. Veçanërisht fëmijët e mbyllur në vetvete ka shumë mundësi që të mos ua hapin këto lloj pikëpyetjesh fetare prindërve. Ka shumë rëndësi që, duke gjetur pretekste dhe mjete të ndryshme, të arrihet që fëmija të zbërthehet, ta derdhë zemrën e të hapet. Po qe se me rritjen e fëmijës, rritet edhe pikëpyetja brenda tij, me kohë, çdo dyshim, çdo lëkundje, çdo çështje fetare e pa shpjeguar, çfarëdo çështje besimore me kuptim dhe urtësi të pakuptueshme kthehet në një gjarpër, në një akrep që ia kafshon zemrën.

Disa herë këto pikëpyetje në botën e tij të brendshme rriten, si një plagë, me aq shpejtësi, sa që e shtrijnë për tokë atë të mjerë, pa e kuptuar dot në kohë atë që ka ndodhur! Ai vjen çdo ditë në xhami, i kryen rregullisht të gjitha gjërat bashkë me ju duke dhënë përshtypjen sikur gjithçka është në rregull, kurse, në të vërtetë, ai u është nënshtruar lëkundjeve e dyshimeve dhe tretet çdo ditë brenda qerthullit të tyre. Po qe se kur e dërgojmë fëmijën në një universitet për t'ia krijuar të ardhmen, nuk ia mjekojmë në kohë problemet e mundshme, bëhet e pashmangshme, që si rrjedhojë e pikëpyetjeve me karakter fetar, të na dalë një ditë para me një sërë ndjenjash, mendimesh e sjelljesh që s'do t'ia kishim përngjasuar dot kurrë! Prandaj fëmija kurrë nuk duhet të lihet pa u ushqyer mendërisht e shpirtërisht, gjë që duhet bërë sipas moshës dhe veçorive individuale të tij. Në të kaluarën, njerëzit tanë ua dorëzonin fëmijët edukatorëve ose edukatoreve dhe ata, duke hyrë në botën shpirtërore të tyre, përpiqeshin, që me aq sa ua lejonte anatomia e shpirtit të tyre, t'u gjenin zgjidhje mëdyshjeve që ua gërryenin mendjet. Në të vërtetë, janë prindërit ata që duhet ta bëjnë këtë lloj edukimi. Po qe se nuk e bëjnë dot, duhet të gjejnë edukatorë dhe edukatore me kulturë për ta bërë këtë edukim, dhe nuk duhet t'i lënë kurrsesi shteg humbjes së fëmijës. Një besim i shëndoshë, një konsideratë adhurimi e përvetësuar thellësisht dhe një moral i përkryer, të shndërruara këto në një aspekt të natyrës sonë mund të realizohen vetëm me një ndjeshmëri të këtyre përmasave!

4. Të falemi dhe të lutemi në një mjedis ku të mund të na shohë edhe fëmija

Brenda shtëpisë duhet të ketë edhe vend, edhe kohë të veçuar për falje e lutje. Po të ketë mundësi, namazet e pesë kohëve të falen në shtëpi, ose ndryshe, të merret fëmija për dore e të çohet në xhami. Kjo e dyta, më shumë në periudhat kur nëna nuk mund të falë namaz. Nuk i duhet lënë shteg mundësisë që fëmija, duke parë nënën që s'falet, të mësohet, dashje pa dashje, me idenë se mund të bëhet edhe pa namaz ose pa lutje. Në librat e të drejtës islame (fikh) kjo çështje trajtohet edhe kështu: Kur femra, nëna, kalon një periudhë kur nuk mund të falë namaz, ajo mund të marrë abdest, të ulet në sexhade, të hapë duart për lutje dhe t'i lutet Zotit.⁶⁴ Kështu, edhe ajo nuk do të shkëputet plotësisht nga adhurimi, edhe fëmija nuk do të vërë re një ndryshim të theksuar në adhurimet e saj. Megjithëkëtë, si në këto periudha të veçanta, ashtu edhe zakonisht, vajtja në xhami ruan vlerat e veta të veçanta. Kështu, do të vijë një ditë, që me t'u kënduar ezani, fëmija, krejt si një orë e kurdisur, do t'ju paralajmërojë: "Baba, erdhi koha e namazit!" Dhe, ndërsa dikur e paralajmëronit ju atë, tani do të jetë ai që do t'ju bëjë zë juve, teksa jeni të zënë me punë, apo kur të mos e keni dëgjuar ezanin!

Përveç kësaj, ju duhet të keni një orë të caktuar të ditës për t'iu lutur në mënyrë të posaçme, "personalisht", Allahut. Ajo do të jetë "ora juaj". Atëherë ju do t'i shfaqni Zotit tuaj ndjenjat tuaja, do t'ia qani hallet, duke treguar praktikisht se Krijuesi i Lartë është gjatë gjithë kohës një derë e hapur ku mund të drejtoheni, ku mund të mbështeteni. Është e dobishme që lutjet e kësaj ore krejt personale t'i bëni me zë të lartë. Ja, kështu i patën dëgjuar dhe mësuar sahabët lutjet që Profeti ynë (s.a.s.) i bënte me zë të lartë, që i njohim dhe i përdorim edhe ne edhe sot e kësaj dite. Shumë lutje të tilla i ka përcjellë Aishja e nderuar (r.a.). Ka edhe lutje të përcjella nga Aliu i nderuar, Hasani e Hyseni (radijallahu anhuma).

Edhe ju mund t'ua bëni të njohura lutjet mjedisit tuaj duke synuar që edhe ata t'i mësojnë ato. Po qe se dëshironi që fëmija juaj të bëhet i ndjeshëm, që të dridhet kur të dëgjojë se përmendet emri i Allahut, duhet që fillimisht të jeni vetë një njeri i atillë!

Po, ka shumë rëndësi që prindërit ta përcaktojnë mirë detyrën e tyre në familje. Ka shumë rëndësi që fëmija t'ju shohë se si, në një orë të caktuar, ju qëndroni para Zotit dhe ia hapni zemrën Atij, se si rënkoni para Tij, se si i luteni Atij me zë të lartë! Fëmijës suaj nuk do t'i shlyhet kurrë nga kujtesa pamja juaj, teksa

⁶⁴Ibni Abidin, *hashije*, 1/290.

përpiqeni për të nesërmen e pasosur, që është një nga çështjet tuaja më të mëdha, tek e mendoni atë dhe qani me shpresë për të!

Në fakt, ne jemi të detyruar të falemi e lutemi para Zotit sikur të ishim duke e parë Atë. Sipas një hadithi të dobët, Profeti ynë i Dashur ka thënë: *“Unë kam me Allahun një çast, kur as engjëjt e mëdhenj, as dhe tjetërkush mund të më afrohet!”*⁶⁵ Po, ne duhet të kemi me Zotin tonë një çast, një orë të tillë të ndritshme që fëmija të mos i harrojë kurrë ato tablo që do të shohë, dhe kur t’i vijë koha, t’i bëjë material për adhurimin e vet. Veç kësaj, kur të ndodhet, në të ardhmen, ballë për ballë me rreziqe për t’u thyer, këto tablo t’i shkojnë në ndihmë e ta kapin për dore për të mos e lënë sakaq të rrëzohet.

Nuk duhet ta marrim me shumë rezerva këtë çështje sepse edhe Kurani na parashtron një lëkundje psikologjike të tillë në suren “Jusuf”. Ç’është e vërteta, ne as nuk e mendojmë se Jusufi (alejhis’selam) mund të jetë lëkundur para një femre, por Kurani thotë: *“Po sikur të mos e kishte parë provën e Zotit?”*⁶⁶

Sado e diskutueshme të jetë vërtetësia e komentuesve të Kuranit të cilët thonë se me “provë” këtu është fjala për faktin që Jusufit të nderuar iu paraqit i ati, Jakubi (alejhis’selam), i cili ia vuri gishtin në buzë duke i thirrur: “Jusuf!” Dhe, kështu, i paralajmëruar prej të atit, Jusufi (a.s.) u tërhoq dhe tha: *“Unë e kam frikë Allahun!”*^{67&68}

Ja, kështu edhe ju, me shembullin tuaj, do të zini vend në nënvetëdijen e fëmijës, i cili, para çdo të keqeje, do t’ju shohë juve nga dritarja e hapur në përfytyrimin e tij tek ia tërhiqni vëmendjen duke i thënë: *“Ç’po bën ashtu, biri im?”* Dhe, kështu, ju do të jeni në jetën e tij për herë një udhëzues dhe një dorë ndihme e zgjatur për tek ai për ta kapur, për t’u mbrojtur nga rreziqet!

5. Respekti për Kuranin

Mësimi i Kuranit prej fëmijëve tuaj është i një rëndësie të veçantë. Por, të paktën po kaq e rëndësishme është, që duke e kënduar Kuranin, të zgjoni ndjenjën se Ai nuk është tjetër, pos Fjalës së Allahut! Njëra prej gjërave që vëmë re në kohën tonë, është, për fat të keq, këndimi i Kuranit pa e ndjerë atë, pa zbritur ai poshtë grykës. Ju mund të bëheni shembull shumë i mirë për fëmijët tuaj në leximin e Kuranit. Duke parë këndimin tuaj shumë të ndjerë, ata do të kuptojnë shumë gjëra. Unë kam mendimin se këndimi i Kuranit pa ndjenja, pa shpirt, i ka bërë njerëzit tanë të pandjeshëm!

Në një hadith, Profeti (s.a.s.) thotë: *“Njeriu që e këndon më bukur Kuranin, është ai që e këndon seriozisht dhe me hidhërim!”*⁶⁹ Kurse në një hadith tjetër, thotë: *“Ky Kuran ka zbritur në hidhërim!”*⁷⁰

Nëse Kurani e merr dhe e trajton njeriun, një qenie me shumë probleme, gjë për të cilën s’ka dyshim, edhe ne jemi të detyruar t’i japim zë këtij hidhërimi me qëndrimin dhe interpretimin tonë. Vetëm se njëri prej kushteve të rëndësishëm për të ardhur në këtë nivel është njohja e kuptimit, e domethënies së Kuranit. Ne e respektojmë Kuranin si Fjalë të Allahut (xh.xh.), por përpjekja qoftë edhe e pakët për ta kuptuar dhe njohur përmbajtjen e tij si Fjalë e Allahut, është një shprehje e veçantë e respektit ndaj Tij. Në mënyrë të veçantë, me këtë përpjekjen tuaj, fëmija do t’i ndjejë më thellë në zemër e në mendje kuptimet e Kuranit, do të mbushet me to dhe, sipas nivelit të vet, do ta plotësojë urinë shpirtërore për to.

Ai që mjaftohet vetëm me kuptimet e Kuranit, konsiderohet i mangët në kuptimin dhe ndjenjën fetare. Kurse ata që nuk dinë edhe kaq, janë krejtësisht në humbje. Është e dobishme ta kujtojmë edhe një herë se, për të marrë ato që Kurani u ka premtuar njerëzve, duhen mësuar kuptimet e shenjta brenda fjalëve të Kuranit dhe u duhen mësuar edhe fëmijëve pastaj!

Në kritikën e hadithit që cituam më sipër, Hafiz Munaviu përcjell një ngjarje të tillë:

“Një fëmijë i vogël e kishte plotësuar mësimin përmendësh të Kuranit, pra, përgatitjen për t’u bërë hafiz. Fëmija e mbaron së kënduari Kuranin për gjithë natën, pa vënë gjumë në sy, fal namazin e

⁶⁵Axhluni, *keshfu l-hafa*, 2/173-174.

⁶⁶Jusuf: 24.

⁶⁷Jusuf: 23.

⁶⁸Alijulkariu, *el-Esrarul-merfua*, fq. 299; el-Axhluniu, *keshful hafa*, 2/226.

⁶⁹Et-Taberani, *el-Muxhemul kebir*, 11/7; Ebu Nuajm, *hiljetul eulija*, 4/19.

⁷⁰Ibni Maxhe, *ikame*, 176; Ebu Jala, *el-Musned*, 2/50.

mëngjesit dhe del para mësuesit, por me fytyrë të zverdhur. Mësuesi i tij është një mjeshtër që mund t'i bëhet prijës material-shpirtëror fëmijës. Ai i pyet fëmijët e tjerë se pse e ka fytyrën të zverdhur djali. Dhe ata i përgjigjen: "O mësues, ky e këndon Kuranin nga kreu në fund për gjithë natën pa fjetur fare, dhe në mëngjes vjen në mësim!" Mësuesi që nuk dëshiron që nxënësi i tij ta këndoje Kuranin kështu, e merr pranë dhe i thotë: "Biri im, Kurani duhet kënduar siç është zbritur! Duke filluar që sot, do ta këndosh Kuranin sikur të më kishe para mua, sikur po më përgjigjeshe mua në mësim!"

Fëmija shkon, këndon edhe atë natë dhe, kur del para mësuesit të nesërmen, i thotë: "Mësues, mbrëmë munda të këndoje vetëm gjysmën e Kuranit!" "Shumë mirë, - i thotë mësuesi, - kurse sonte këndo Kuran sikur të ndodheshe para të Dërguarit të Allahut (s.a.s.)!" Fëmija shkon dhe këndon Kuran atë natë me mendimin se ndodhet para njeriut që iu zbrit Kurani dhe, të nesërmen, kur del para mësuesit, i thotë: "Mësues, unë mbrëmë munda të lexoj vetëm çerekun e Kuranit!" Duke parë përparimin e nxënësit, mësuesi dëshiron ta përsosë atë më tej dhe i thotë që kësaj radhe ta këndoje Kuranin si të ishte duke e dëgjuar kur engjëlli Xhebrail po ia përcillte Profetit. Nxënësi shkon dhe, të nesërmen i thotë mësuesit: "Uallahi, mësues, mbrëmë munda të këndoje vetëm një sure!" Më në fund, mësuesi e porositi: "O bir, tani këndoje sikur të qëndroje para Allahut (xh.sh.) të fshehur pas mijëra perdesh, por që të dëgjon ty dhe t'i përsërit fjalët që ti i këndon!" Të nesërmen fëmija del para mësuesit duke qarë dhe i thotë: "O mësues, thashë *elhamdulillahil'lahi rabbi'l-alemin*, erdha gjer në *maliki jeumiddin*, por nuk arrita të them dot *ijjake na'budu!* Sepse kuptimi i kësaj është *vetëm Ty të adhurojmë*, kurse unë adhuroj aq shumë gjëra dhe u përulëm aq shumë gjërave, sa që kur e mendoja Atë para vetes, nuk arrija ta thosha dot atë fjalë!"

Hafiz Munaviu shënon se fëmija nuk kishte jetuar veçse edhe dy-tri ditë pas kësaj ndodhie. Dhe mësuesi, ai mjeshtër i madh i fjalës që e kishte ngritur fëmijën në këtë nivel, tek qëndron mbi kokë të varrit të nxënësit, dëgjon dhe sheh me vëmendje mbi të, nxënësi i flet me një zë që të mund ta dëgjojë mjeshtër dhe i thotë: "Mësues, arrita gjer në një shkallë me rëndësi që i thonë *tajjim* dhe nuk m'u kërkua llogari!"

Këndimi i Kuranit me respektin e posaçëm që duhet shprehur për Të, duke e menduar kuptimin dhe duke u përqendruar mbi fjalët e tij, duke shprehur konsideratën e lartë për to si fjalë të Zotit, madje edhe duke e vënë mbi ballë, të gjitha këto kanë shumë rëndësi për ta bërë atë tërheqës për zemrat, sepse i tërheqin edhe kënduesin, edhe dëgjuesin në atmosferën e Kuranit duke ua hapur atyre kat më kat dyert e botës qiellore!

Me citimin e rrëfimit të mësipërm nuk duam t'ju themi se, po të mos mendoni kështu, më mirë mos këndonit Kuran, mirëpo mendoj se edhe përqendrimi mbi përmbajtjen e Kuranit, mbi ndryshimet që na shkakton ai në shpirt, janë gjëra të domosdoshme që ju të zgjidheni si bashkëbisedues të Tij. Nuk mund të mendohet se Kurani që nuk na shkakton transformime në shpirt mund të bëhet ndikues në jetën tonë individuale e shoqërore. Ne duhet të ndryshojmë me anë të Kuranit, të orientohemi në horizontin e Tij, të ndjejmë me thellësitë ndjesore të Tij që edhe Ai të na e shpalosë para syve të fshehtë të Tij!

Po rikthehem te citimi. Nxënësi nuk kishte vdekur, ai kishte arritur te Zoti i tij! Zemra i kishte ndaluar me emocionin që mund të zgjojë Kurani në zemrat e pastra dhe ai kishte ecur drejt Zotit të tij. Ai do të rronte përjetësisht! Atë natë ai s'e kishte kapërcyer dot *ijjake na'budu*-në, "*vetëm ty të adhurojmë*", megjithëse kishte ndenjur tërë natën duke e përsëritur... Të njëjtën situatë shpirtërore e ka përjetuar edhe dikush tjetër në Qabe. Kur e kishte mbështetur kokën në murin e Qabes, kishte thënë me vete: "O Zot!" Dhe vetëm kaq! Sikur t'i ishte lidhur gjuha, s'kishte mundur të thotë asgjë më tej. Sepse e kishte pyetur veten: "A ke të drejtë ti ta thuash këtë? Pse tregohesh ende me dy fytyra?" Por këto përjetime as mund të rrëfehen saktë, as mund t'u përcillen të tjerëve. Ato janë ndjenja të një pasioni disaçastësh!..

Dhe tani, po që se mund ta ruajmë këtë vijë në shtëpitë tona dhe ta tregojmë në praktikë se ia kemi dhënë zemrën Kuranit dhe se bëjmë pjesë në rrethin e Profetit (s.a.s.), mjedisi ynë do të rigjallërohet si blerimi në pranverë dhe shoqëria jonë do të rilindë përsëpari asisoj që ta kenë zili edhe engjëjt!

a) Të mos shkaktojme neveri

Në historinë tonë të afërme, brezat e rritur tek ne dhe në vendet e tjera islame nuk kanë mundur t'i kapin sa duhet mesazhet lehtësi dhe s'ihariqdhënëse të fesë, madje kanë mbetur larg tyre. Kur çështja

shqyrtohet me zemër të pastër dhe gjykim të shëndoshë, shihet se shkak i kësaj është mungesa e vetëdijes dhe përpjekjes në kuptimin e gjërave!

Në këtë periudhë, besimtarët, megjithëse kanë thënë “i besuam Allahut”, nuk kanë qenë të vetëdijshëm për kuptimin e kësaj fjale, nuk kanë mundur ta bëjnë lidhjen mes botës së jashtme dhe botës së tyre të brendshme, si dhe faktet fetare nuk kanë mundur t’i kuptojnë në mënyrë thellësisht të ndërgjegjshme. Sa e hidhur është që edhe kur në shkolla që futur mësimi i fesë, disa mësues të moralit e të fesë, në kundërshtim me këtë mundësi, qenë mjaftuar vetëm duke ua mësuar nxënësve Kuranin përmendësh dhe duke zbatuar mbi nxënësit pa simpati ndaj fesë metoda mësimore të gabuara, patën bërë që të shembej tek ta edhe ai pak respekt që u kishte ngelur për fenë! Duke vepruar kështu, gjithësesi ata nuk patën pasur si qëllim t’i ftohni fëmijët prej fesë; megjithëkëtë, njëri prej disa gabimeve tona të mëdha të vërtetuara tek ne dhe të ardhura gjer ato ditë qysh prej shumë shekujsh të shkuar, po përsëritej edhe një herë tjetër!

Unë personalisht, edhe në këtë çast madje, nuk mund të them se ne i kemi vlerësuar mjaftueshëm mundësitë që Zoti na ka falur . Po që se mjaftohemi t’i kërkojmë fëmijës të mësojë përmendësh ca gjëra, sikur besimi dhe feja të përbëheshin vetëm prej disa formalitetesh, fëmija mund të ndjejë neveri ndaj fesë, mund të mos dëshirojë t’i futet asnjë orvatjeje për të mësuar prej saj. Çështja është jo vetëm përputhja e programit dhe e metodave të mësimi me moshën, por më tepër, edukimi i dashurisë së fëmijës për besimin dhe fenë, edukimi i aftësisë së tij për të menduar mbi to dhe për t’i përvetësuar vetë me dashuri. Në të kundërt, po t’ia rëndojmë fëmijës kokën me gjëra përmendësh, do ta bëjmë që të nisë të ndjejë neveri për fenë, për rrjedhojë, në vend që t’i shërbejmë fesë, i sjellim asaj dëme !

Besimtarët duhet të tregohen syçelë në këtë drejtim dhe duhet të bëjnë çmos për t’ua bërë të dashur fenë fëmijëve. Në vend të mbushjes së kokës së fëmijës me gjëra sasiore, duhen edukuar ndjenjat e tij me anë të kuptimeve të larta. Ata duhet ta duan aq shumë Kuranin, sa që mësimin e Tij ta kthejnë në një qëllim parësor të jetës!

b) Kryerja e rregullt e adhurimeve të detyrueshme, madje më tepër

“Urdhëroje familjen tënde për namaz, edhe ti vazhdoje atë me durim. Ne s’duam gjë prej teje, jemi Ne që të japim ty. Përfundimi i mirë arrihet vetëm me takva (devocion)!”⁷¹

Pavarësisht nga kushtet, prindërit nuk duhet t’i lënë kurrsesi mangët detyrat e tyre fetare dhe fëmija nuk duhet të vërejë asnjë mungesë në çështjet e adhurimit. Profeti (s.a.s.) kurrë nuk e pati lënë pa kryer namazin e pasmesnatës (tehexhudin), gjithashtu ai kishte virte, dhikre dhe lutje të posaçme që i këndonte kur ngrihej natën, dhe kur nuk i bënte në kohë, i plotësonte (kaza) në një kohë tjetër më vonë, megjithëse përsëritja (kaza) e tyre nuk i kërkohej. Kështu parashtrohej sheshit se një adhurim i filluar brenda dhe jashtë shtëpisë nuk mund të lihej në asnjë mënyrë në mes!

Sahabët, shokët e Profetit (s.a.s.) e patën kuptuar shumë mirë se një adhurim i filluar duhej vazhduar. Një ndër figurat më të shquara të asaj kohe, Abdullah ibn Amr ibn Asi dëshironte të agjëronte çdo ditë dhe të falte namaz gjatë gjithë natës, gjer në mëngjes. Ai e pati vazhduar këtë ritëm edhe pasi e pati martuar i ati , madje nuk pati shkuar te e shoja për ditë të tëra. Pastaj, kur çështja i që parashtrohej Profetit, ai e pati thirrur ibni Asin dhe i pati kërkuar t’i pakësonte adhurimet e tjera veç farzeve (detyrimeve) ndërsa ky këmbëngulte se mund të bënte edhe më shumë. Më në fund, Profeti e pati bindur të agjëronte një ditë po e një ditë jo, kurse një të tretën e natës të flinte e pjesën tjetër të merrej me adhurim. Ndërkaq, Buhariu dhe Muslimi thonë⁷² se, kur që plakur, ibnul Asi i pati thënë kështu një sahabi: “Eh, sikur t’i kisha pranuar këshillat e të Dërguarit të Allahut, sepse tani në pleqëri e paskam shumë të vështirë të vazhdoj në atë mënyrë. Prapëseprapë, nuk dua t’i pakësoj adhurimet e bëra nafile (suplementare). Dua që i Dërguari i Allahut të më gjejë siç më pati lënë!”⁷³

Abdullah b. Amri është një shembull i mirë; njeriu nuk duhet t’i lërë adhurimet që i ka bërë tashmë shprehë. Fundja, edhe Profeti, në një hadith *sahih* (autentik), ka thënë kështu: “Më i vyeri i adhurimeve është

⁷¹ Taha: 132.

⁷²Buhariu, *savm*, 55; *fedailu'l-Kuran*, 34; Muslim, *sijam*, 182.

⁷³Ahmed bin Hanbel, *el-Musned*, 2/158; Ebu Nuajm, *hilje*, 1/285-286.

*adhurimi i vazhduar, qoftë edhe i pakët!*⁷⁴ Po qe se s'kemi fuqi, për të mos u ulur në sy të fëmijës, duhet të mjaftohemi me aq sa mund të bëjmë, përpos atyre që i kemi detyrim. Në qoftë se mund të bëjmë vetëm farzet dhe sunetet, duhet t'i bëjmë pa të meta. Nëse e kemi nisur namazin tehexhud, duhet ta vazhdojmë patjetër. Nëse vaxhibi i Vitrit duhet falur para syve të fëmijës, ashtu duhet bërë, por nëse do të ishte më me ndikim, duhet ngritur nga gjumi dhe do falur natën.

Çështjet që u përpoqëm t'i sqarojmë gjer këtu, janë për ata që mendojnë si ne. Nëse dëshirojmë që fëmijët tanë të na bëhen të ndjeshëm, fetarë, të vetëdijshëm, të mençur dhe ta mësojnë si duhet Islam; për mendimin tonë kjo është rruga e drejtë. Çdo gjë arrihet nëpër rrugën e saj dhe vetëm duke ecur në rrugën e saj arrihet rezultat në lidhje me të. E thënë ndryshe, nëse duam që fëmijën ta kemi në rrugë të drejtë dhe kjo të kthehet për të në mënyrë jetese, edhe ne duhet të jemi në rrugë të drejtë dhe këtë ta kemi mënyrë jetese. Mendimet dhe sjelljet duhet t'i kemi gjithmonë po ato, në mënyrë që edhe fëmija, duke na parë ne, të jetë konsekuent në sjelljet dhe mendimet e tij. Këtu bëhet fjalë për rregullimin e jetës sonë në këtë botë, për fitimin e jetës tjetër dhe të lumturisë në të, si për vete, ashtu dhe për fëmijët tanë! Në fakt, këto duken si një lloj diete dhe porosie mjeku, vetëm se nuk duhet të bëhen kurrsesi të mërzitshme. Këto duhet të bëhen diçka e zakonshme, si marrja e ilaçeve të duhura në kohë të caktuara pa i harruar ose ngatërruar kurrë! Kështu, ju do të bëni një jetë të ekuilibruar, do të silleni në mënyrë të ekuilibruar dhe këtë ekuilibër do ta bëni sundues edhe në shtëpi!

c) Ndjenja e nderimit për simbolet e shenjta

Sipas nesh, ekzistojnë disa koncepte të shenjta, pas të cilave ka shumë kuptime gjithashtu të shenjta. Koncepti *Allah* (xh.xh.) është për ne shumë i shenjtë, dhe për më tepër një shtyllë e besimit. Ai që nuk i beson Allahut (xh.xh.), nuk ka as jetë besimore, fetare islame. Kurrsesi nuk duhet të harrojmë se kemi përgjegjësi që këtë koncept të shenjtë, në raport të drejtë me lartësinë sublime dhe madhësinë e Tij, ta shtresojmë në mendjen e fëmijëve qysh në një moshë fillestare që pranohet ajo 7-9 vjeç; ta bëjmë që t'i zërë vend në ndjenja dhe ta preokupojë të gjithë botën e imagjinatës së tij. Ta bësh fëmijën që të jetojë vazhdimisht me imagjinatën për Profetin tonë të Dashur, duhet që në shtëpi të bisedohet vazhdimisht për Të. Po qe se në shtëpi bisedohet vetëm për artistët e kinemasë e të televizionit dhe në horizontin e vështrimit të fëmijës ndodhen në çdo kohë kinemaja dhe televizioni, edhe në imagjinatën e tij do të sundojnë ca artistë, andaj kur të pyetet fëmija për personalitetet që njeh, do të përmendë shumë emra artistësh, këngëtarësh, muzikantësh, por nuk do të jetë në gjendje të kujtojë qoftë edhe katër emra sahabësh tejet të njohur. Kujtesa dhe nënvetëdija e fëmijës do të mbushen në tërë kapacitetin e tyre me gjëra të kota jo vetëm të padobishme, por edhe të dëmshme, shkaktare për perversitetin e imagjinatës së fëmijës!

Çdo gjë që njihet në fe si e shenjtë, duhet gjithashtu të shprehet si e shenjtë në mendimet dhe sjelljet tona. Për shembull, Qabeja është një mjedis i shenjtë. Edhe ju, kur të flisni për Qaben në prani të fëmijës, duhet të tregoheni jashtëzakonisht respektues karshi saj. Po ashtu kur të përshkruani Faltoren Profetike dhe mënyrën se si duhet ecur dhe sjellë kur vizitohen ato vende. Nga përshkrimet tuaja plot ndjenja dhe respekt të thellë, edhe zemra e fëmijës do të mbushet me dashuri e respekt për ato simbole të shenjta!

Kjo vlen edhe për Kuranin. Në Kuran thuhet: "*Kush tregon respekt për shenjtën e Allahut, e ka, këtë, pa dyshim, nga përkushtimi i zemrës!*"⁷⁵ Përkushtimi i zemrës ose, i quajtur ndryshe, *takvaja*, *devocioni*, mund të realizohet vetëm me njohjen e Allahut (xh.xh.), me drejtimin plot respekt ndaj Allahut të Madh, me bindjen ndaj Tij dhe me konceptimin e plotë të së Vërtetës Hyjnore!

Shkurt, nëse i besojmë Allahut dhe e duam Atë, dhe në zemër kemi ndjenjë devocioni dhe nderimi e respekti për simbolet e Tij, këto duhet t'i derdhim në zemrën e fëmijës, duhet t'i tregojmë atij për madhësinë e Allahut dhe duhet ta bëjmë Atë të dashur për fëmijën. Në një hadith të përcjellë nga Taberani prej Ebu Umames, Profeti ka thënë: "*Bëjuani Allahun të dashur robbëve të Allahut që edhe Allahu t'ju dojë juve!*"⁷⁶ Allahu (xh.xh.) duhet vetëm duke e njohur, sepse njeriu do atë që njeh ndërsa bëhet armik

⁷⁴Buhari, *rikak*, 18; Muslim, *salatul Musafirin*, 216-218; *salatul-Munafikin*, 78.

⁷⁵Haxh: 32.

⁷⁶Et-Taberani, *el-Mu'xhemu'l-kebir*, 8/90,91; Ibn Asakir, *Tarihu Dimashk*, 24/72.

i atij që nuk e njeh. Ateistët apo mosbesimtarët tregohen armiq të Allahut sepse nuk e njohin Atë, por po ta njihnin, do ta donin!

Allahu dekretonte kështu në Kuran: *“Unë i krijova njerëzit dhe xhindet vetëm për të më adhuruar Mua!”*⁷⁷ Ibni Abbasi dhe Muxhahidi (r. a.) e komentojnë shprehjen *lija’budun* (për të më adhuruar Mua) të këtij ajeti në formën *lija’rifun* (të më njohin Mua).⁷⁸ Kjo do të thotë se, po ta njohin Allahun, njerëzit edhe e adhurojnë Atë, kurse, po të mos e njohin, tregohen mosmirënjohës. Atëherë, në fillim ne do t’ia bëjmë të njohur fëmijës, pastaj fëmija do ta njohë dhe kuptojë dhe do të mbushet plot ndjenja për Allahun për të treguar respektin dhe dashurinë e duhur për Të! Ndërkaq, çdo nivel duhet të ketë stilin dhe mënyrën e vet të njohjes, pra, njohja e Allahut duhet bërë sipas moshës dhe aftësisë për të kuptuar të fëmijës.

Në një hadith, i Dërguari i Allahut (s.a.s.) thotë kështu:

*“Duajeni Allahun për të mirat dhe dhuntitë e Tij për ju. Edhe mua duamëni për hir të Allahut sepse jam i dërguari i Tij, kurse familjen time duajeni ngaqë më doni mua!”*⁷⁹

Të duash dikë apo diçka, dhe t’i bësh edhe të tjerët ta duan atë dikë apo diçka, nuk duhet të jetë e vështirë kur njihet mënyra për ta dashur, si dhe për t’i bërë të tjerët që ta duan. Dhe, mënyra më e mirë, është njohja dhe kontakti i vazhdueshëm. Prandaj, në këndin kryesor të çdo shtëpie tonën duhet të jenë Kurani, pastaj librat mbi jetën dhe veprimtarinë e Profetit (s.a.s.) dhe pastaj librat mbi jetën dhe veprimtarinë e sahabëve në mënyrë që zemrat e fëmijëve tanë të ushqehen me to e ata të bëhen të dashur për fëmijët tanë.

Këtu dua t’jua tërheq vëmendjen mbi një pikë. Edhe nëse e kërkon arsyeja dhe logjika që të përdoren argumente të ndryshme kundër lëkundjeve e dyshimeve të lëshuara mbi besimin tonë me forma filozofike dhe rrugë racionale, lëshimi pas logjikës abstrakte e ngecja në të mund, disa herë, t’ia shuajnë njeriut jetën ndjesore e ta shtyjnë në pesimizëm. Pasi ta kryejë detyrën e tij ndaj mendimit dhe arsyes, dhe pasi t’i plotësojë të gjitha funksionet lidhur me këto, njeriu do dhe duhet të nisë të hulumtojë shembujt mbi shfaqjen e mendimeve dhe ndjenjave përkatëse në jetën praktike. Për rrjedhojë, edhe nëse ju, duke u kapur, me gjuhën e fizikës, kimisë, astronomisë, etj., pas mijëra argumenteve objektive e subjektive mbi ekzistencën dhe njësinë e Allahut (xh.xh.) të ngjiteni lart përmes një shkalle të ndriçuar që ju zgjatet nga lart, po të mos jepni dot shembuj praktikë nga jeta dhe po të mos jua kuptojë fëmija, idetë dhe mendimet fetare që do t’ia përcillni atij, do të rroken në mendjen e tij si të ishin teori filozofike.

Nëse gjykimet e vlerave fetare dhe virtytet kombëtare për të cilat u flisni fëmijëve, nuk mundeni t’i konkretizoni në periudha të ndryshme të historisë, ato mund të duken si utopi të paarrtshme. Pra, ju jeni të detyruar t’ua tregoni atyre me shembuj se këto vlera janë jetuar dikur dhe mund të jetohen edhe njëherë!

Ezani është simboli më i rëndësishëm i ndjenjave të larta myslimane dhe pretekst për t’u përqendruar para namazit. Në të njëjtën kohë, ezani është shprehje e vlerës së madhe të namazit si adhurim ndaj Allahut, është ftesa e Tij për ne! Po qe se ju i përgatisni fëmijët të mbushur me ndjenja të tilla, edhe ata do të emocionohen kur të dëgjojnë ezanin, do t’u mbushen sytë, do t’u shpërthejnë ndjenjat si ujë e lumit që shpërthen nga shtrati dhe do të fillojnë të dridhen me dashuri të thellë për atë ftesë!

Si përfundim, mund të themi këtë: në shtëpitë tona, adhurimet duhet të kryhen pa mangësi, lëkundjet dhe dyshimet e futura në kokat e fëmijëve duhet të sqarohen dhe mënjanohen pa u bërë vonë për këtë dhe duhet të ketë orë të caktuara kur të gjitha zemrat t’i drejtohen vetëm Allahut, kur në përfytyrimet të ekzistojë vetëm i Dërguari i Allahut (s.a.s.)!

Nderimi dhe respekti i thellë për shenjat dhe simbolet e shenjta do të thotë vlerësimi i lartë me fjalë dhe veprime i gjërave dhe vlerave të pranuar si të larta nga feja. E Vërteta e Lartë, *Allahu Ekber*, e shprehur ashtu siç duhet vetëm me anë të ezanit, do të pasqyrohet me një ndjenjë të thellë në sytë e fëmijës suaj dhe ju do t’i buzëqeshni atij për atë meritim fatmirë!

⁷⁷ Dharijat: 56.

⁷⁸El-Begau, *Mealumul tenzil*, 4/235; el-Kurtubiu, *el-Xhami li ahkamil Kuran*, 17/55; el-Alusi, *Ruhul meani*, 15/50.

⁷⁹Tirmidhiu, *menakib*, 31; et-Taberani, *el-Muxhemul kebir*, 3/46, 10/281.

PJESA E PESTË

Si duhet treguar?

Si duhet treguar

Tema kryesore mbi të cilën u përqendruam në pjesën e mëparshme, ishin çështjet lidhur me gjendjen besimore e adhurimore të fëmijës sipas niveleve të tij të moshës dhe ne arritëm në përfundimin se marrja e rezultateve pozitive në këto çështje varej përgjithësisht nga sjelljet, qëndrimet dhe shembulli personal i prindërve dhe edukatorëve të tjerë veç tyre.

Nëse fjalët na bëhen interpretë të botës së brendshme dhe sjelljeve tona, gjërat që ndjejmë, mendojmë dhe vendosim t'ia përcjellim bashkëbiseduesit, gjejnë lehtësisht reflektim tek ai. Në të kundërt, në qoftë se sjelljet nuk na i mbështesin fjalët dhe në zemër nuk kemi besimin dhe bindjen e duhur, është krejt e qartë se s'do të mund të ndikojmë edhe aq shumë.

Prandaj, po qe se ndodheni në krye të një institucioni arsimor dhe edukimi të madh apo të vogël ose të ndonjë enti administrativ, duhet ta dini pa diskutim se ju jeni aty zembereku edhe i rregullit, edhe i harmonisë. Nëse te ju ndodh ndonjë thyerje, edhe tërë ekipin që drejtoni do të shfaqen menjëherë rrëshqitje. Në kundërshtim me këtë, për sa kohë që ju të jeni i vendosur, edhe në ekipin apo sistemin tuaj do të ketë vendosmëri ose, në pastë lëkundje, do të jenë të vogla e të papërfillshme.

1. Shembulli personal

Ndjeshmëria dhe korrektesa në sjelljet tona kanë një rëndësi të jashtëzakonshme rëndësi për ndikueshmërinë e fjalëve tona dhe arritjen e gjërave që duam të arrijmë. Për shembull, nëse jemi duke falur namaz, një respekt, një edukatë, një etikë që reflektojnë me sa është mundësia qenien tonë para Allahut, kijami, rukuja dhe sexhdja jonë po në atë kuadër, të gjitha këto janë, në lidhje me çështjen, më me ndikim se leximi i një libri! Kjo duhet të jetë edhe përgjigjja më bindëse për pyetjen e fëmijëve, “*Si tregohet respekti para Allahut?*” Në të kundërt, po qe se e falni namazin siç shprehet hadithi profetik, “*Si pula që çukit ushqim në tokë*⁸⁰, edhe edukata e namazit e atij që ju merr juve për shembull, do të jetë i tillë! Dhe duhet ditur pa diskutim se një namaz i tillë jo vetëm nuk ka për ta larguar dot njeriun nga të këqijat, por as do të zgjojë respekt ndaj Allahut tek njerëzit e tjerë që ndodhen nën edukimin e tij, e as ka për të lënë ndonjë gjurmë pozitive në shpirtrat e tyre!

Po, është shumë e rëndësishme që namazi të falet me sinqeritet. Imazhi i një njeriu që ka thyer belin dhe ka përkulur qafën me një respekt dhe përkushtim të thellë para Allahut (xh.xh.), do të shkaktojë ndikim të madh mbi ata vëzhgues të pafajshëm.

Aq sa është e rëndësishme të bëhesh shembull në gjërat pozitive, aq është e rëndësishme edhe të sillesh pa lëkundje para situatave negative. Gjithmonë ekziston mundësia që fëmijët të kapen nga ndonjë virus dyshimi apo lëkundjeje, në shkollë apo në ndonjë nga mjediset e jashtme. Dhe këto duhen eliminuar pa humbur kohë. Nuk duhet qëndruar indiferent ndaj librit që ka marrë fëmija në dorë dhe po e lexon, qoftë ai edhe një roman. Po qe se në librin që po lexon ka ndonjë aspekt që prek besimin dhe bindjet tuaja dhe ju nuk bëni ndërhyrjen e duhur, brenda fëmijës mund të nisë të marrë formë një dyshim apo lëkundje pa e kuptuar ju një gjë të tillë. Prandaj, nuk duhet të mjaftoheni vetëm me kujdesin mbi gjendjen e fëmijës në shtëpi; në të njëjtën kohë, duhet të kontrolloni edhe atmosferën e përgjithshme që ka të bëjë me formësimin e strukturës së tij ndjesore e mendore. Përcaktimi dhe zgjedhja që më parë e librave që do të lexohen është një punë jetësore për ata që dëshirojnë të rrisin e të përgatisin njerëz të qëllimit. Pas një periudhe të caktuar, përpjekja për t'i kuptuar simpatitë dhe antipatitë e fëmijës, kureshtja për t'i ditur ç'gjëra dëgjon e ç'gjërave ua vë veshin ai, njohja e shokëve të tij, madje përcaktimi i tyre dhe sjellja si një mjek i kujdesshëm ndaj tij në të gjitha aspektet, janë çështje që nuk të lejojnë nënvleftësim.

a) Nxënësi, mësuesi dhe prindërit

⁸⁰Ahmed bin Hanbel, *el-Musned*, 2/311.

Dallimi eventual kulturor mes nënës dhe babait, mes djalit dhe vajzës, ose edhe mes prindërve dhe fëmijëve, i quajtur, ndryshe, mes brezave, si njëri prej problemeve të ditëve tona, si dhe përfundimet negative që mund të japë ky dallim, mund të sheshohen dhe zgjidhen me masa edukative si dhe gjer në periudhën e pubertetit. Po u lanë për më vonë, ndikueshmëria e masave edukative mund të bëhet e pavlerë. Bie fjala, po qe se fëmijët e dikujt që s'ka marrë arsim, studiojnë në universitet, ka mundësi që ta shohin veten gjithmonë mbi prindërit, dhe të mos denjojnë ta dëgjojnë fjalën apo këshillën e tyre, gjë që mund të sjellë si pasojë që ata të manipulohen nga elemente të ndryshme me moral të dyshimtë, ose nga forca politike anarkiste apo antikombëtare dhe të bien ose viktimë e një morali të ulët, ose viktimë e kulturës së rrugës.

Për ata të rinj që bien viktimë e gjithfarë forcave duke i imituar dhe ndjekur ato me një besnikëri të verbër, Kurani shprehet kështu:

“Ata thonë: “Zoti ynë, ne shkuam pas kryetarëve dhe të mëdhenjve tanë dhe ata na nxorën nga rruga!”⁸¹

Prandaj, qëndrimi pozitiv i atyre që drejtojnë arsimin dhe edukimin, do të sjellë lumturi edhe për ata vetë, edhe për brezat që kanë marrë përsipër t'i mësojnë dhe edukojnë; e kundërta, qëndrimet e gabuara të atyre që e nënvleftësojnë përgjegjësinë e vet, do të sjellë jo vetëm shkatërrimin e të ardhmes së vet në këtë jetë e në jetën tjetër, por edhe shkatërrimin e të ardhmes së fëmijëve dhe të rinjve, arsimimin dhe edukimin e të cilëve e kanë nënvleftësuar!

b) Klithma e atyre që ranë në perversitet

Nëse i jepni mundësi fëmijës të merret me gjëra që s'i sjellin asnjë dobi për jetën e tij materiale-shpirtërore, me të do të ndodhë ashtu siç e përshkruan Kurani:

“Allahu do t'u thotë: “Hidhuni dhe ju në zjarr, atje ku ndodhen njerëzit dhe xhindet, paraardhësit tuaj!” Dhe kushdo që do të hyjë atje, do t'i mallkojë shokët e vet. Pastaj, kur të mbliidhen bashkë, ndjekësit do të thonë për njerëzit që u shkuan pas: “Zoti ynë, ja, këta na nxorën ne nga rruga! Ndëshkoji ata me një zjarr më të fortë!” Dhe Allahu do të thotë: “Për çdo njeri ka edhe një herë më shumë ndëshkim, por ju nuk e dini!”⁸²

Gjithsesi, sipas shprehjes së Kuranit, fëmijët që ju dikur i morët në prehër e i rritët, që pandehni se i rritët e i edukuat, kanë për t'u lëshuar me një gojë mallkime njerëzve që i ndoqën, që ua dëgjuan fjalën e për shkak të të cilëve ndoqën rrugë të gabuara apo ranë në perversitet. Njeriu që i beson sadopak ringjalljes dhe jetës tjetër, duhet të dridhet nga një mallkim i tillë i bërë në grup, më një gojë dhe duhet të mbështetet te Allahu (xh.sh.). Rruga për të shpëtuar nga një fatkeqësi e tillë është të bëhemi shembull i mirë për ta, që nga sjelljet dhe mënyra e jetesës e gjer te dashuria për Allahun dhe të Dërguarin e Tij (s.a.s.)!

Në një shtëpi ku ndjehet dashuri dhe respekt për Allahun (xh.xh.) dhe të Dërguarin e Tij (s.a.s.), fëmija do të lidhet pas Allahut dhe do t'ia japë zemrën Atij me aq sa të mësojë, të shohë e të ndjejë për Të. Faktin se sa bisedohet në një shtëpi për Allahun (xh.xh.) dhe Profetin (s.a.s.) mund ta masim nëpërmjet emocioneve të fëmijës, mund ta ndjejmë me thellësinë e ndjenjave të tij. Natyrisht, edhe faktin se a kryhen në atë shtëpi gjëra të papëlqyeshme apo të ndaluara nga feja, se a zbatohen gjërat e urdhëruara nga feja. Fëmija është si ekрани i hapur i folesë familjare, si altoparlanti i zërave të ndryshëm të atij mjedisi. Nga ky ekran dhe altoparlant mund të vëzhgojmë edhe skajet më intime të shtëpisë si dhe të dëgjojmë edhe pëshpëritjet më të fshehta në të!

c) Rruga për në Xhenet dhe Xhehenem

Xhehenemi është i rrethuar nga të gjitha anët me dëshira njerëzore dhe gjëra që i pëlqejnë trupit dhe egos, kurse Xheneti, me gjëra të papëlqyeshme.⁸³ Kush nuk e kapërcen dot rëndesën e adhurimit dhe bindjes, në një aspekt, rëndesën e gjërave të papëlqyeshme për egon, kush nuk u bëhet dot pengesë dëshirave dhe tekave, përgjunjet çdo ditë para një loje të re dhe nuk shpëton dot nga një mallkim i ri, nuk

⁸¹ Ahzab: 67.

⁸² Araf: 38.

⁸³Buhariu, rikak, 28; Muslim, Xhenet, 1.

do të hyjë në Xhenet, ndërsa nuk do të ndodhet larg nga Xhehenemi. Ja pra, dy drejtimet e rrugës dhe synimit që kemi para dhe të synimit përfundimtar ku do të arrijmë më në fund! Nga njëra anë, ne do të heqim dorë prej të gjitha gjërave që na thotë feja “mos i bëni” dhe do të përpiqemi që edhe të tjerët të heqin dorë, nga ana tjetër, do t’i bëjmë pikë për pikë dhe me vetëdije të plotë gjërat për të cilat na thotë feja “bëjini!” dhe do të përpiqemi që edhe të tjerët t’i bëjnë, në mënyrë që të mos zvarritemi pas gjërave që i pëlqejnë egos dhe të mos pengohemi në gjërat që s’i pëlqejnë atij, e kështu, me mirësinë e Zotit, të mund të mbetemi në këmbë!

Ne jemi të mbjellat dhe të korrat e paraardhësve tanë; edhe brezat që do të vijnë, do të jenë fryti i përpjekjeve tona. Në vend që të ankohe mi për kohën, për ditët që kanë ardhur, të shohim mirë se ku i kemi mangësitë; duke u përpjekur për të kuptuar rezultatet e pritshme të nënvleftësimeve dhe mangësive tona, të përpiqemi për t’u ringjallur shpirtërisht përsa i përket ndjenjës së detyrës dhe përgjegjësisë.

2. Kuptimi i leximit

Një prej gjërave më të rëndësishme që duhet t’i japim fëmijës është edhe arsimiti. Si dhe, krahas këtij, dëshira dhe edukata për të lexuar dhe mësuar. Fëmija duhet të mësojë të shkruajë e të lexojë me një qëllim dhe synim të caktuar, dhe duke u shkëputur nga mediokriteti, të ngjitet drejt vlerave. Pra, aq sa ç’ka rëndësi mësimi i shkrimit dhe leximit, ose më saktë, sa ç’ka rëndësi leximi e studimi, ka rëndësi qëllimi për të cilin bëhet. Poeti kombëtar turk Junus Emre thotë:

Dituri do të thotë të dish,

Do të thotë veten të kuptosh;

E nëse ti veten s’e kupton,

Ç’të vlen kaq shumë të lexosh?..

Meqë i hymë kësaj çështjeje, le të përpiqemi së bashku t’u japim përgjigje këtyre pyetjeve: Ç’është dija? Ç’është dituria? Cili është synimi i diturisë? Pse lexohet libri? Ç’është ajo gjë që kërkohet të arrihet pas gjithë leximit e studimit?

Ndërkaq, është e dobishme që, para se t’u përgjigjemi këtyre pyetjeve, ta kujtojmë këtë veçanti:

Nëse një njeri thellohet në matematikë pa menduar aspak për t’i vënë në jetë njohuritë ose për ta zhvilluar atë më tej me teori apo hipoteza të reja, do të thotë se s’ka vënë ndonjë qëllim apo synim, ose e thënë ndryshe, vepron pa ndonjë qëllim apo synim. Kjo vlen edhe për atë që thellohet në studimin e shkencave mjekësore, apo në ndonjë fushë tjetër të ngjashme. Ndërkaq, edhe mbetja e njohurive të marra në kujtesë bëhet e diskutueshme. Në fakt, siç shprehet edhe poeti, synimi thelbësor i marrjes së diturive është vetënjohja. Kështu, është krejt e qartë se një dije, një shkencë ku ne nuk e gjejmë dot veten, as neve nuk do të na sjellë dobi, as të tjerëve!

a) Leximi dhe shkrimi

Është një e vërtetë e konfirmuar se, Kurani zë radhën e parë në shkrim dhe lexim. Ndërkaq, le ta theksojmë këtu se ne nuk e miratojmë ngarkesën e kotë të kujtesës së mbyllur ndaj mësimi të qëllimeve hyjnore. Fëmija duhet kapur për dore, i duhet zgjuar kureshtja për Kuranin, i duhet futur Kurani në shpirt, në mënyrë që edhe ai, në të ardhmen, të përpiqet për të mësuar se ç’kërkon Allahu (xh.sh.) prej Tij. Për fat të keq, në ditët tona, ne kapemi pas iluzionit se, po ta bëjmë fëmijën të thotë “Bismil’lah”, kemi zgjidhur gjithçka. Në fakt, “besmele-ja” është shumë e rëndësishme dhe mund të zgjidhë shumë çështje, por ç’e do se përtej saj është mësimi i “qëllimit hyjnor”, qoftë edhe në mënyrë të përmbledhur, që për mendimin tim modest, është pikërisht gjëja që duhet mësuar!

Historia e Islamit është e mbushur plot me shembuj të mësimi sipërfaqësor të Kuranit, gjë që ka çuar në armiqësi e konflikte të rënda mes vetë myslimanëve. Këtë gjë e pati parashikuar edhe Profeti i cili, në një hadith të përcjellë nga Hudhejfe bin el-Jeman (r.a.), thotë kështu:

“Nga gjërat që kam frikë për ju është edhe kjo: dikush këndon aq shumë Kuran, sa ajo cilësia syverbuese e Tij i pasqyrohet në të gjitha qëndrimet dhe sjelljet. Atëherë, Islami bëhet për të si një rrobë. Dhe ai e mban sipër atë gjerë në një afat që e di Allahu, pastaj, Allahu na ruajtë, e zhvosh dhe e hedh tutje në një qoshe. Pastaj hidhet me shpatë mbi të vëllanë duke e akuzuar atë për herezi!”

Pas kësaj shprehjeje të Profetit, Hudhejfeja i nderuar (r.a.) e pyet:

“O i Dërguari i Allahut, kush është më afër herezisë, i akuzuari për shirk⁸⁴, apo akuzuesi?”

“Akuzuesi!” – ka thënë Profeti.⁸⁵

Edhe sot ka shumë e shumë persona me tituj që notojnë në injorancë, sepse nuk e njohin Allahun (xh.xh.), nuk e njohin Profetin Muhamed (s.a.s.). Çfarëdo emri dhe titulli të kenë ata që nuk janë në gjendje të mendojnë përballë mijëra provave dhe argumenteve që gjenden në gjithësi, që nuk janë në gjendje ta përdorin fuqinë e analizës dhe të sintezës, që jetojnë si të shurdhër e të verbër përballë qenieve dhe dukurive, janë në një injorancë të thellë! Ne i themi dije dhe dituri vetëm asaj që e ndriçon botën mendore e ndjesore të njeriut; tjetrës i themi vetëm hamallëk kujtese!

Mesazhi i parë i Kuranit është shfaqur në formën *“lexo me emrin e Zotit tënd!”*⁸⁶ Fjala e parë që i ka drejtuar Allahu (xh.xh.) Profetit tonë të Dashur (s.a.s.), ka qenë *“lexo!”*. Allahu këtu nuk thotë *“lexoje Kuranin!”* dhe as *“lexojeni librin që ju është dhënë!”*, por e shtjellon vetë kuptimin e këtushëm të fjalës *“lexo”*:

*“Lexo me emrin e Zotit tënd që ka krijuar!”*⁸⁷

Me këtë, Kurani vë nën vëzhgim dukurinë e krijimit. Ai e ka fjalën edhe për *“leximin”* e argumenteve të krijimit.

Më poshtë, Kurani thotë:

*“Lexo me emrin e Zotit tënd bujar që e mësoi njeriun të shkruante me kalem!”*⁸⁸

Siç shihet, këtu, elementet lexim dhe shkrim përmenden njëri pas tjetrit. Patjetër, njeriu do të lexojë dhe shkruajë edhe për argumentet e krijimit, edhe për ndërtimin e vet të brendshëm, edhe për ta kuptuar më mirë thelbin e Kuranit.

b) Dituria të çon te frika ndaj Allahut

Në një ajet tjetër të Kuranit thuhet: *“Nga Allahu, vetëm njerëzit e ditur frikësohen!”*⁸⁹ Ashtu është! Vetëm dijetarët tregojnë respektin e duhur para Allahut, sepse ndjenja e respektit para kuadrit hyjnor varet nga dija, nga njohja e tij. Është e qartë se ata që s’e njohin Allahun (xh.xh.) dhe nuk janë kompetentë të kuadrit hyjnor, janë të mangët në nderim dhe respekt.

Duke u nisur nga kjo pikë, njëri prej hapave që do të hedhim për t’i përgatitur fëmijët të plotësuar nga ana e jashtme dhe e brendshme, është pa dyshim, t’i bëjmë ata që të kenë një besim të shëndoshë. Argumentet që njihni ju mbi Qenien e Domosdoshme, janë të varura nga niveli juaj kulturor, gjë që vlen edhe për ata. Kështu, nëse disa argumente janë të mjaftueshme për ju për të mënjanuar dyshimet tuaja personale, mund të jenë të pamjaftueshme për fëmijët tuaj për shkak të ndryshimeve moshore dhe kulturore mes jush. Atëherë themi se duhen përdorur rehabilitime më të specializuara.

Një specifikë tjetër është hyrja ndër zemra e jetës së bekuar të Profetit (s.a.s.), dashuria ndaj Tij dhe sundimi i Tij ndër zemra. Le ta kujtojmë se kjo specifikë është trajtuar gjerësisht në librin *“Dritë e pashuar”*.

c) Heqja e mëdyshjeve

⁸⁴ Besimi në më shumë se një zot, shih: politeizmi.

⁸⁵ Ibn Hiban, *es-Sahih*, 1/282; Ibn Kethir, *Tefsirul Kuran*, 2/266, (Transmetuar prej Ebu Jalës)

⁸⁶ Alak: 1.

⁸⁷ Po aty.

⁸⁸ Po aty: 3-4.

⁸⁹ Fatr: 28.

Sot hasim në shumë pyetje të tilla si, *“Mirë që gjithësinë e krijoi Zoti, po Zotin kush e krijoi?”* Shumica e këtyre pyetjeve tregon se fëmijëve nuk u është dhënë një ide e saktë për Allahun (xh.xh.), Zotin e gjithësisë. Edhe pas pyetjes se pse Profeti është martuar me shumë gra njëkohësisht qëndron motivi themelor i mungesës së njohurive të sakta mbi Profetin Muhamed (s.a.s.).

Po kështu, ndokush mund të thotë: *“Profeti ka qenë një njeri shumë i zgjuar. Edhe ndryshimet dhe transformimet që kreu Ai, qenë vepër e zgjuarsisë së Tij!”* Kuptohet se ai që bën vlerësime të tilla, ka boshllëqe të mëdha në edukimin fetar, si dhe nuk ka fare njohuri mbi përmbajtjen e profetësisë.

Ndërkaq, nëse madhësisë së plagëve të tilla, i shtohet edhe një ndërhyrje e gabuar, gjendja ndërlikohet akoma më shumë. Prandaj, pikësëpari na duhet ta dimë shumë mirë se jemi të detyruar ta përshtatim nivelin e besimit në Allahun (xh.xh.) me strukturën ideore dhe shpirtërore të fëmijës. Për shembull, në lidhje me krijimin, mund t’ia heqim mëdyshjet fëmijës duke i bërë një arsyetim të tillë: *“Edhe një gjilpërë s’mund të bëhet vetvetiu, askush nuk e shkon, madje, nëpër mend një gjë të tillë. Ajo prodhohet nga mjeshtri me ndihmën e veglave apo makinerive të ndryshme. Atëherë, edhe gjithësinë është dikush që e ka krijuar dhe ai është Allahu, Zoti!”* Duke e ndihmuar fëmijën me një recetë të tillë, ju do ta rrafshoni lëkundjen që ka hedhur filiza në mendjen e tij, teksa nuk ka gjetur ende mundësi për t’u zhvilluar më tej.

Sipas burimeve fetare, zoroastrianët ose adhuruesit e zjarrit i patën drejtuar shumë pyetje imam Adhamit. Ata i patën thënë atij se nuk e besonin Allahun. Kufeja, ku ndodhej imam Adhami, banohej nga shumë adhurues syresh.

Imam Adhami ua tregoi atyre gjërat me një mënyrë shumë të thjeshtë. Ai u tha: *“Ta zëmë se ju vini re se në det të hapur është një anije që po vjen drejt bregut. Megjithëse deti ka shumë dallgë, anija lëviz drejt, pa e humbur aspak orientimin, as dallgët nuk ia ndryshojnë dot drejtimin asaj. A do të kishit dyshim ju që anija nuk është pa njeri, që ajo nuk lëviz nga ta çojnë dallgët, por e drejtuar nga një dorë mjeshtërore?”* - *“Jo!”* - iu përgjigjën ata pa kurrfarë lëkundjeje. *“Atëherë, - vazhdoi imami, - si mund të mendoni se gjithë këta yje, tërë kjo gjithësi, kjo tokë lëvizin pa e prishur rregullin vetvetiu, pa i drejtuar dikush?”* Dhe adhuruesit e zjarrit thanë: *“La ilahe il’allah, Muhammedun resulullah, Nuk ka zot tjetër veç Allahut, Muhamedi është i Dërguari i Allahut!”*

Ky quhet bashkëbisedim sipas nivelit të bashkëbiseduesit. Dikujt mund t’i duket i thjeshtë, vulgar, kurse dikujt tjetër i mjaftueshëm. Pavarësisht nga përmasat e logjiksh-mërisë së këtij stili, ai mund të jetë i mjaftueshëm për njerëz të një niveli të caktuar. Në moshat më të avancuara, mund të theksohet qëndrueshmëria e të njëjtave parime duke u përqendruar mbi çështje me përmasa ideore më të thella. Mund të jepen si shembull gjithësia, njeriu dhe struktura e jashtme dhe e brendshme e njeriut. Truri i njeriut, syri, mekanizmi i brendshëm, qelizat, sistemi qelizor, anatomia dhe fiziologjia e tij janë krijuar me një jashtëzakonshmëri marramendëse. Megjithatë unë pandeh se nëse secila prej këtyre çështjeve diskutohet në kuadrin e parimeve shkencore, në përputhje me moshën, pjekurinë dhe nivelin kulturor të fëmijës apo të cilitdo bashkëbisedues, , atëherë puna e kryer do të jetë e mjaftueshme.

Po kështu, për një bashkëbisedues tjetër mund të trajtohen çështje të tjera, si, p.sh., ajri, uji, drita, vitaminat e ndryshme, proteinat, karbohidratet ose qeniet mikroskopike. Në këtë rast ndoshta do të ndryshojë vetëm forma e dhënies së mësimi, kurse struktura e tij themelore do të mbetet po ajo.

3. Tregimi për Profetin dhe kohën e Tij

Edhe për Profetin (s.a.s.) duhet folur e treguar me të njëjtën vëmendje e kujdes. Unë personalisht, faktin që disa njerëz nuk e duan Profetin tonë të Dashur, e lidh me faktin që atyre mund të mos u jetë folur për Të në fëmijëri. Njerëzit që e patën parë dhe njohur nga afër atë, e patën dashur, i patën dhënë Atij gjithçka, madje edhe zemrën. Është e pamundur të tregosh një njeri tjetër në historinë e njerëzimit që të ketë pasur aq shumë ndjekës e të jetë respektuar e nderuar aq shumë prej tyre! Por nuk është e drejtë të prisni që fëmija juaj ta dojë atë pa i folur ju për Të më parë. Ishte një kohë e lumtur kur një grup njerëzish patën fatin e lumtur ta shihnin dhe njihnin Profetin me sytë e vet. Një grup tjetër pati nderin të shihej e të takohej me ata që e patën parë, e kështu me radhë. Kjo konsideratë mund të lidhet me thënien e Profetit: *“Koha më e mbarë është koha ime, pastaj koha e atyre që do të vijnë fill pas meje!”*⁹⁰

⁹⁰Buhariu, shehadat, 9; fedailu as’hab 1; rikak, 7; ejman, 27; Muslimi, fedailu sahabe, 210-215.

Ai Personalitet, i Cili, edhe në periudhën e beduinëve, në ato kohë të errëta kur njerëzit i groposnin të gjallë fëmijët e vet pa ndjerë kurrfarë hidhërimi, kur pinin pothuajse të gjithë, kur në njëfarë mase sundonte morali i kolektivitetit, e reformoi me një hop jetën shoqërore. Si akti i Tij, edhe bashkësia e Tij janë të pashoqe, të papërsëritshme. Fakti që ai u fut pothuaj në qelizat trunore të njerëzve të kohës së Vet, që ngriti fron aq lehtë në zemrat e tyre, që i kuroi një e nga një sëmundjet materiale dhe shpirtërore të tyre duke i bërë njerëz të përsosur, është një transformim i tillë i mrekullueshëm që është e pamundur t'ia tregosh të ngjashmin në histori!⁹¹

Në kohën e tyre, edhe në Romë, edhe në Greqinë e Lashtë janë bërë transformime, por pa çdoformë premtimi në lidhje me vlerat njerëzore. Madje transformimet në ato vende e ata popuj kanë sjellë kriza dhe kthim pas, ku disa herë asgjë tjetër veç gjakut e lotëve!

Ndryshim tërësor quhet ai që sjell ndryshime thelbësore në tërë jetën dhe individualitetin e individit dhe shoqërisë, duke prodhuar cilësi të reja dhe duke e ngjitur njeriun në nivele të larta të vlerës së tij si i tillë. Ja, këtë ka bërë profeti Muhamed (s.a.s.) në kuadrin profetik me atë botëkuptimin e Tij aq të gjerë shoqëror! Nuk e di se sa e njohim ne transformimin e kryer prej Tij dhe sa gjëra prej Tij u tregojmë fëmijëve tanë, teksa Profeti ynë është modeli më i përkryer për ne në çdo drejtim!

Ashtu siç shprehet edhe arkitekti i mendimit të shekullit tonë: Nëse marrim njëqind filozofë dhe nisemi për në Arabi, megjithëse mundësitë e sotme janë më të gjera, nuk do të mund ta bëjmë dot as për njëqind vjet atë që Ai e ka realizuar brenda një viti. Duke marrë shembullin më të thjeshtë, ai shprehet: *“Një ves të dobët siç është duhani, mund ta heqë qafe prej një populli të vogël vetëm një gjykues i madh, me një përpjekje të stërmadhe.”*⁹² Nëse doni mund ta thjeshtojmë pakëz shembullin. Le të themi që rreth një personi që pi duhan do të mblidhen dhjetë të tjerë, e t'ia tregojnë njëzëri se rrezikohet prej kancerit, prapëseprapë nuk do ta bëjnë dot që të heqë dorë prej pirjes së tij. Mirëpo Ai Personalitet i lartë, me një lëvizje të vogël, ia arriti që t'ua bënte të urryera edhe veset më të këqija që u ishin futur në gjak deri më tani, duke ua zëvendësuar mandej me vlera njerëzore.

Në lidhje me asgjësimin e veseve të këqija me një hop, ndjeshmëria e treguar ndaj ndalimit të pijeve alkoolike përbën një shembull me rëndësi. Mendoni një shoqëri të alkoolizuar që i merren mendtë kur nuk pi alkool. Atyre njerëzve u thuhet: *“Pija është e ndaluar!”* Dhe ata që e kanë sjellë gotën e pijes gjer në buzë, pa u lëkundur aspak, e largojnë nga buzët dhe e hedhin përtokë!

S'e di se si do t'ia arrinin edukatorët tanë ta shpjegonin këtë!

Ja kjo është detyra që të përket ty, të rrëfesh mrekullitë e Tij, e t'i zgjosh zemrat e të tjerëve karshi këtyre cilësive, duke ua zgjuar ndërgjegjjet nga topitja e përgjithshme. Nëse ia arrini kësaj, atëherë ata që keni përreth do të mendojnë veç për Të, do të flasin veç për Të, dhe veç për Të do të dëgjojnë. Ne këtë le ta quajmë “mbështetje e drejtpërdrejtë e Profetit Muhamed (s.a.s)” mbi ne. Allahu (xh.xh.) na mbështetë përherë me Atë Personalitet. Nëse ne ua rrëfejme fëmijëve veprat e jetës së Profetit Fisnik (s.a.s.) sikur të ishim duke rrëfyer si përpara një ekran të gjitha ndodhitë e njerëzimit nga njeriu i parë deri te ai më i mbrami. E kjo ka për të qenë rifreskuesi kryesor e vetëdijeve të tyre. Në hadithet e Tij të shtrenjta, Profeti ynë (s.a.s.) na radhit një e nga një, aq shumë lajme të padyshimta për të ardhmen, aq shumë sihariqe së bashku me shkaqet dhe përfundimet e tyre, ngjarjet nga fushatat mongole në pushtimin e Sirisë,⁹³ nga rritja e vlerave të lumit Eufrat⁹⁴ në naftën e Talikanit,⁹⁵ nga një sërë intrigash të Kohës së Fundit në shtimin e imoralitetit⁹⁶ dhe aq shumë ngjarje e fakte të tjera, saqë është e pamundur t'i shohësh të vërtetohen të gjitha këto dhe të mos i besosh atij!

Tani, po t'ia tregojmë këto me radhë fëmijës, ai do të ndjejë nderim para madhësisë së Profetit, kështu që, ata që do të duan t'ia shlyejnë atë fëmijës nga mendja, nuk kanë për t'ia arritur dot qëllimit. Ta dimë për vete dhe t'ua bëjmë të ditur edhe të tjerëve se Profeti Muhamed (s.a.s.) që s'kishte marrë mësim

⁹¹shih: Bediuzzaman Said Nursi, *Fjalët*, Fjala e nëntëmbëdhjetë.

⁹² Bediuzaman Said Nursi, *Fjalët*, Fjala e nëntëmbëdhjetë.

⁹³Ebu Davud, *melahim*, 9-10; Ahmed bin Hanbel, *el-Musned*, 5/40, 44.

⁹⁴Buhariu, *fiten*, 24; Muslim, *fiten*, 30-32.

⁹⁵Ali el-Mut' taki, *Kenzu'l ummal*, 14/250 (e transmetuar nga libri “*Kitabul Fiten*” i Ebu Ganm el-Kufiut.).

⁹⁶Muslimi, *fiten*, 59, Ebu Davud, *melahim*, 14.

prej askujt veçse prej Allahut, njihte të shkuarën dhe të ardhmen,⁹⁷ është për ne një borxh besnikërie ndaj tij!

Ka gjëra të tilla të thëna prej tij mbi mjekësinë, që ka qenë e pamundur të njiheshin në atë kohë me nivelin shkencave përkatëse të asaj kohe të. Kjo do të thotë se Allahu (xh.xh.) ia mësonte çdo gjë Atij dhe Ai fliste për ato që ia kishte mësuar Allahu, sepse Ai ishte i Dërguari i Allahut!

Të ngrihesh për të shkruar diçka serioze mbi ndryshimet rrënjësore që erdhën me Profetin Muhamed (s.a.s.) në jetën individuale dhe shoqërore të njeriut, s'i nxënë as vëllime të tëra librash nëse shkruhen. Ne këtu prekëm vetëm disa çështje në kalim e sipër sa për të dhënë një ide.

4. T'i njohësh të tjerët me Kuranin duke folur sa më shumë për Të

T'ua bësh të dashur e të pranueshëm brezave të rinj Kuranin, me të gjitha aspektet e Tij ka shumë rëndësi për zgjimin tek ta të vetëdijes fetare dhe për mbajtjen gjallë të saj. Të thuash vetëm kaq, që *"Kurani është një libër i shenjtë"*, është e pamjaftueshme si për Kuranin, ashtu edhe për fëmijën. Edhe nëse një trajtim i tillë mund të duket si i mjaftueshëm për një moshë dhe nivel të caktuar fëmënor, për më tej është padiskutueshëm i pamjaftueshëm, madje, bëhet i dëmshëm sepse, duke u kthyer në një paragjykim, bëhet pengesë për sugjerime pozitive e të thelluara mbi të. Nisur nga kjo, brezave të rinj u duhet treguar në mënyrë sa më bindëse se Kurani, të Cilit askush nuk ka mundur t'i lëvizë as edhe një presje që nga dita kur ka zbritur e gjer më sot, me tezat e Tij të hapura mbi kufijtë e fundit ku mund të arrijnë shkenca dhe teknologjia, është mesazhi i fundmë i Allahut (xh.sh.)!

Në të vërtetë, është me vend të thuhet se Kurani përmban të dhënat më të reja mbi të gjitha botët në tërë gjerësinë e tyre të krijimit dhe ekzistencës, se të dhënat e Kuranit nuk bien në kundërshtim me të dhënat shkencore, se përkundrazi, me informacionet e tij sintetike në formën e rregullave të përgjithshme, Kurani u jep kahje shkencave. Edhe ajeti i mposhtëm është dëshmitari qiellor i kësaj të vërtete:

"Tek Ai ndodhen shumë e shumë thesare të panjohura si dhe çelësat e botës së padukshme. Askush s'i njuh ato veç Tij. Ai njuh gjithçka që ndodhet në tokë e në det. Asnjë gjethe s'biedot pa dijeninë e Tij, s'ka thërrime në errësirat e thellësive tokësore për të cilën të mos ketë dijeni Ai! Nuk ka gjë të njomë e të thatë që të mos ndodhet në Librin e Qartë!"⁹⁸

5. Të flasësh për ringjalljen

Si një hap i mëtejshëm, vjen të folurit për ringjalljen. Fëmija dhe i riu duhet ta dinë se pas kësaj jete ka një jetë tjetër, e cila nis me ringjalljen. Dituria, urtësia dhe qëllimi kanë treguar se këtë gjithësi e ka ngritur Allahu dhe se është Allahu që e vë në lëvizje dhe e drejton. Është gjithashtu Ai që e tregon dhe e përcakton kohën. Në Kuran thuhet: *"Silluni mbi tokë dhe shihni se si e ka filluar Allahu krijimin!"⁹⁹*

Kuptimi i kësaj është ky: le të shëtisim ne mbi tokë dhe t'i shqyrtojmë argumentet dhe provat e krijimit, ta kalojmë çdo gjë para sysh fletë për fletë e etapë për etapë, të vëzhgojmë se si filloi krijimi mbi tokë, se si u krijua kjo gjithësi ndërsa nuk ekzistonte, se si u shfaq njeriu mbi tokë, se si janë krijuar gjallesat e tjera në familje e lloje, se si përsosmëria e krijimit mori fund me njeriun!

Allahu që e ka krijuar gjithësinë nga hiçi, do ta krijojë edhe ringjalljen, edhe jetën tjetër. Ai që e ka krijuar këtë sistem, a s'mund ta krijojë edhe sistemin që ne e quajmë *Ahiret*, *bota tjetër*? Ai që e ka krijuar tokën me këtë madhështi, a nuk e ka mundësinë të krijojë edhe një "tokë" tjetër? A nuk mund t'i thotë kësaj, *Botë*, kurse tjetrës, *Ahiret*? Ai që ju ka sjellë dhe ju ka vendosur ju këtu nga një botë tjetër, a nuk mund t'ju çojë dhe vendosë në një tjetër botë?

Kurani na e tërheq vëmendjen kësodore:

⁹⁷shih: Kadi Ijadh, Shifa, 1/354.

⁹⁸ En'am: 59.

⁹⁹ Ankebut: 20.

“Është Allahu që i krijoi qiejt dhe tokën dhe çdo gjë që ka mes tyre në gjashtë ditë (periudha) dhe pastaj u vendos në Arsh. Ju s’keni as mik e as ndihmës tjetër veç Tij. A s’po mendoni, a s’po merrni mësim?..”¹⁰⁰

“Allahu është ai që çdo gjë e krijoi të saktë e të bukur dhe, pastaj e krijoi njeriun prej argjile!”¹⁰¹

Në një vend tjetër, atyre që e kundërshtojnë ringjalljen, Kurani u drejtohet kështu:

“Thuaju: “Ata do t’i ringjallë Ai që i ka krijuar për herë të parë, sepse Ai e njeh çdo lloj krijimi!”¹⁰²

Si dhe:

“Shih kah veprat e mëshirës së Allahut se si ringjall pas vdekjes! Pa dyshim, ai do t’i ringjallë të vdekurit, sepse Ai ka mundësi për çdo gjë!”¹⁰³

Si përfundim, pasi t’ia kemi dhënë fëmijës këto njohuri, i kemi treguar edhe se cila është rruga e drejtë, *sirati mustakim*, dhe e kemi përgatitur të thotë: *“Allahu ynë, na fut në rrugë të drejtë!..”¹⁰⁴* Dhe, në saje të një lutjeje të tillë, në dashtë Zoti, përpjekjet tona edukuese nuk do kanë për të na shkuar dëm!

¹⁰⁰ Sexhde: 4.

¹⁰¹ Po aty: 7.

¹⁰² Jasin: 79.

¹⁰³ Rum: 50.

¹⁰⁴ Fatiha: 5.

PJESA E GJASHTË

Dimensionet e edukimit

Dimensionet e edukimit

Në kreun e mëparshëm prekëm çështje të tilla si edukimi i fëmijës sipas moshës dhe nivelit, dhe çështje të tjera të rëndësishme mbi të cilat duhet të përqendrohen prindërit, mësuesit dhe edukatorët.

Edhe një herë le ta kujtojmë se ata që nuk sillen të ndjeshëm në çështjet e edukimit, dhe që nuk e ushqejnë fëmijën me arsim dhe edukatë në mënyrë të kënaqshme në përputhje me moshën, aftësitë, gjerësinë e mendimit, nivelin e tij dhe veçoritë e mjedisit ku ai jeton, të mos habiten nëse në periudhat e mëtejshme përballen me një "ujk të uritur"!

1. Vepra e mirë duhet paraqitur bashkë me njerëzit e mirë

Tregimi i një veprimi të mirë të njerëzimit e mirë, më shumë se prindërve, u intereson mësuesve dhe edukatorëve. Si duhet të veprojmë për ta treguar veprën e mirë bashkë me njerëzit e mirë?

Fëmijët, të rinjtë duhet ta mësojnë dhe dinë se çfarë quhet një punë e mirë, vetëm se, që mësimi të mos mbetet vetëm në teori, duhet bërë i qartë dhe konkretizuar me shembullin e njerëzve të mirë, të shquar për aktet dhe figurën e tyre të mirë.

Në radhë të parë, fëmija ose i riu duhet të kenë një model për ta ndjekur, duke filluar që nga adhurimet e gjer te sjelljet, qëndrimet dhe veprimet e përditshme e të zakonshme në mënyrë që të mos lëkundën në vendosmërinë e tyre dhe, ashtu siç theksohet në hadithin profetik, të druhen nga mjedisi e të fshihen:

"Ashtu siç ndodh sot që hipokritët kanë turp për ato që bëjnë dhe duan t'i fshehin prej nesh, do të vijë një ditë që do të fshihen edhe besimtarët!"¹⁰⁵

Ne duhet t'u tregojmë fëmijëve qysh të vegjël se si duhet ta kapërcejnë këtë sëmundje të posaçme për disa periudha të caktuara, në mënyrë që ta parandalojmë këtë dukuri tek ta në të ardhmen. Në mënyrë të veçantë, duhet t'ua bëjmë të qartë atyre se besimi dhe feja janë nder, virtyt dhe dinjitet, si dhe t'i përgatisim ata shpirtërisht që të mbahen me zemër pas urdhrave të Allahut!

Kështu, fëmija duhet të ketë besim të patundur për mendimet, ndjenjat dhe rrugën ku ecën, në mënyrë që të mos bjerë më vonë në kompleksin e inferioritetit e të shtypet nën presionin e rrymave mohuese. Për më tepër, ai duhet t'i vlerësojë faljen e namazit, agjërimin, etj., si vlera, virtyte dhe shenja madhështie dhe, kur të jetë e nevojshme, pa ngurruar fare, t'i drejtohet Allahut duke treguar sheshit se ai përkulet vetëm para Allahut!

Kurani na mëson që, të paktën dyzet herë në ditë, t'i drejtohem Allahut duke u lutur:

"Zoti ynë, vetëm Ty të adhurojmë dhe ndihmën vetëm prej Teje e kërkojmë! Tregona rrugën e drejtë!.."¹⁰⁶

Dhe, pastaj, duke na e përcaktuar se cila është rruga e drejtë, edhe na orienton, edhe na ndihmon që të pozicionohemi pa lëkundje kundër rrugës së shtrembër të mohimit, herezisë dhe perversitetit:

"Në rrugën e atyre që i ke shpërblyer me favore e të mira dhe jo në rrugën e atyre të cilët tërhoqën ndëshkimin Tënd dhe të atyre që u shmangën dhe e humbën veten!"¹⁰⁷

2. Përfitimi nga shkencat e natyrës për edukimin fetar

Ndërsa fëmijët marrin mësim mbi shkencat e natyrës si fizika, kimia, astronomia, fizika e atomit, etj., duhet që, paralelisht me nivelin e tyre kulturor, t'u flitet edhe për *besimin e vërtetë islam*. Në kundërshtim me materialistët që e marrin për bazë materien duke e varur çdo gjë prej saj, besimtari duhet ta bëjë vlerësimin e materies në kuadrin e besimit, njohurive dhe besimit në Allahun (xh.sh.), Ahiretin (ringjalljen dhe jetën tjetër) dhe Kuranin. Besimtarët duhet të dinë të nxjerrin trëndafila në baltovinën e materies ku

¹⁰⁵Et-Taberani, *Musnedu Shamijin*, 1/148.

¹⁰⁶Fatiha: 5-6.

¹⁰⁷Po aty: 7.

janë mbytur materialistët historikë, si dhe t'i shohin dhe vlerësojnë të gjitha gjërat dhe dukuritë si prova dhe dëshmitarë të ekzistencës së Allahut (xh.xh.)!

Sigurisht, po qe se fëmija, krahas mësimëve mbi shkencat e natyrës që merr nga arsimiti i ulët e gjer në universitet, nuk merr edhe po aq edukim fetar në familje e mjedise apo institucione përkatëse, thyerja dhe rrëshqitja e tij janë të padiskutueshme e të paracaktuara. Nëse niveli arsimor e kulturor që merr ai në shkollë e në mjediset e saj, nuk ndiqet nga afër e nuk ndërhyhet në kohë ndaj mendimeve të mbrapshta të mundshme, gjërat e mësuara mund të kthehen në mjete që çojnë në mohim, ndërkaq që shkencat janë argumentet më të hapura të ekzistencës dhe unitetit të Allahut!

Sigurisht, po qe se përkundër marrjes së mësimëve mbi filozofinë dhe zvarritjes nëpër një sërë dyshimesh dhe lëkundjesh, fëmija nuk mbështetet me anë të vlerësimeve të drejta e pozitive të arsyes, logjikës dhe shkencave, mund të hyjë më vonë në një krizë ideore serioze. Prandaj ai detyrimisht duhet mbështetur, me aq sa ç'e ka nivelin e njohurive racionale, po me argumente racionale, logjike e faktike. Përkundër dedikimit nga materialistët të rregullsisë në natyrë, natyrës dhe demagogjisë të zhvilluar prej tyre në këtë drejtim me anë të një sërë teorish filozofike, edhe ne, duke folur për çështje të tilla si fakti që ligjet që vërehen në çdo gjë me anë të gjuhës së harmonisë së krijimit, janë të paracaktuar dhe sundues, duhet t'ia ngulisim atij në mendje se të gjitha këto janë nën administrimin e Allahut (xh.xh.). Vetëm në këtë mënyrë mund t'i parandalojmë ne dyshimet dhe lëkundjet që teoritë e ndryshme mund të mbjellin tek fëmija.

Sigurisht, ne duhet ta pajisim mendjen e fëmijës me njohuri të drejta e të sakta përkundër njohurive të shtrembra të ngarkuara në kokën e tij me anë të korigjimeve dhe shtrembërimeve të paimagjinuara, në mënyrë që fëmija të mos përfundojë në ndonjë hutim. Për nga përmbajtja, çdo gjë varet nga dituria, kurse injoranca është armiku më i madh edhe i besimtarit, edhe i fesë. Atëherë themi se përkundër përpjekjeve të injorantëve për ta turbulluar brezin e të rinjve me mashtrime të paimagjinuara, besimtarët janë të detyruar të rrisin e përgatisin njerëz besnikë ndaj kombit, atdheut, prejardhjes, të hapur ndaj fesë, diturisë e shkencës si dhe që t'u dalin për zot historisë dhe gjeografisë së vet!

3. Përgatitja e një mjedisi të mirë

Dhe tani dëshirojmë të mendojmë mbi çështjen e përgatitjes së një mjedisi sa më të mirë për fëmijën. Në botën moderne u jepet shumë rëndësi arsimit parashkollor si dhe komplekseve sociale si parqe, palestra, salla leximi, etj. të ngritura pranë shkollave ose në vende të përshtatshme. Për fëmijën është shumë e rëndësishme që jeta e tij materiale dhe fizike të kalojë në një mjedis të shëndetshëm, të rregullt dhe të qetë, që të mos e preokupojë familjen, që të rritet dhe përgatitet i pajisur dhe i hapur ndaj mjedisit. Të gjitha këto janë menduar e shoshitur dhe janë bërë duke parashikuar çdo lloj dobie dhe dëmi. Por ç'e do se ka nevojë si ky, edhe për një mjedis ku ta zhvillojë jetën e tij shpirtërore, ta ndjejë veten njeri të pavarur, dhe madje, të krijojë lidhje me Zotin e vet. Kur flasim për mjedisin e fëmijës, duhet menduar edhe kjo. Këtu e më poshtë do të përpiqemi t'i parashtrijmë gjërat që duhen bërë lidhur pikërisht me këtë çështje.

a) Zgjedhja e shokut

Ka shumë rëndësi që nxënësi të zgjedhë, mes shokëve, ata që respektojnë besimin dhe fenë. Në këtë mes, prindërit s'duhet të rrinë mospërfillës, por ta ndjekin nga afër zgjedhjen që ka bërë apo do të bëjë fëmija i tyre. Ndërkaq, ndjekja e prindërve nuk duhet të jetë në formën e presionit të ushtruar mbi fëmijën, por në formën e udhëzimit.

Siç thotë Saadiu te "Gjylistani", shoku i keq është më i keq se gjarpri. Kurse shoku i mirë është më i mirë se engjëjt. Sa të jeni bashkë me shokun e mirë, ndodhëni vazhdimisht në horizonte engjëllore!

Profeti na porositi: "Njeriu rri me atë që do!"¹⁰⁸ Prandaj është shumë e rëndësishme që prindërit t'i ndihmojnë fëmijët për të gjetur shokun/shoqen e duhur. Kurrë nuk duhet nënvleftësuar mjedisi shoqëror kur bëhet fjalë

¹⁰⁸Buhari, *edeb*, 96; Muslim, *birr*, 165.

për formësimin e ndjenjave dhe mendimeve të fëmijës. Po qe se fëmija ka hyrë në një mjedis të prishur, ai duhet shkëputur menjëherë prej aty dhe duhet futur në një mjedis tjetër. Kurse kur ky mjedis i prishur është vetë mjedisi i lagjes apo shkollës së fëmijës, ai duhet izoluar ose transferuar në një mjedis tjetër ku menjëherë i duhet gjetur shoqëria e duhur, fetare, e ndershme dhe e virtytshme.

b) Ta bëjmë fëmijën të thithë një atmosferë fetare të sinqertë dhe ta mbajmë larg nga dyfytësia

Përveç marrjes me vete ose dërgimit në xhami, fëmijën duhet ta merrni me vete ose ta dërgoni edhe në ceremonitë fetare, mevludet, etj. Kështu, e afroni dhe e mësoni atë me jetën dhe atmosferën fetare. Ndërkaq, në përputhje me natyrën e tij të pastër, fëmija duhet ta dëshirojë këtë gjë, të kënaqet dhe ngopet me këtë atmosferë në mënyrë që të mos kërkojë të shkojë tjetërkund. Edhe muzika që duhet të dëgjojë ai, duhet ta fusë në një atmosferë fetare, t'ia kujtojë besimin, fenë, gjërat e shenjta dhe të përgatisë tek ai zhvillimin e ndjenjës së afërsisë ndaj Allahut.

Vetëm se nuk duhet të harrojmë që mjedisi ku do ta çoni fëmijën, duhet të jetë i sinqertë. Nëse personat që këndojnë mevlud apo himne fetare, nuk ndjejnë vetë emocione, jo vetëm që dallohen nga fëmijët duke e humbur forcën bindëse mbi ta, por edhe ndikojnë për keq mbi fëmijët duke u sugjeruar atyre anasjelltas dyfytësinë në këtë punë.

Po të shihet me kujdes, çështja nuk është vetëm te pjesëmarrja e fëmijëve nëpër ceremoni fetare për të dëgjuar mevlude e himne fetare, por te largimi i tyre nga ceremoni dhe mjedise ku shfaqet formaliteti dhe dyfytësia.

Kjo është një domosdoshmëri e botëkuptimit tonë fetar, pasi shumë prej tyre mund t'i shohim edhe në jetën e sahabëve. Kjo ishte sjellja e natyrshme e Profetit tonë Fisnik (s.a.s.); e si mund të mendohet që të ishte ndryshe për sahabët e nderuar? Nëse ne e pranojmë këtë parim, atëherë quhemi se kemi pranuar një prej çështjeve më të qenësishme të besimit tonë.

c) Zgjedhja e personave dhe mjediseve për të krijuar lidhje

Në të vërtetë, fëmija i rritur mirë dhe nën kujdes e prindërve, është i mbrojtur në një masë të madhe nga ndikimet negative të mjedisit të jashtëm. Megjithatë, ndjekja nga afër ka shumë rëndësi. Edhe kur të shkojë për të blerë lapsa e fletore, fëmija duhet orientuar në mjedise ku të mos bjerë nën ndikime negative. Ai nuk duhet të hyjë në ato vende ku janë ekspozuar dhe shiten libra të rrezikshëm.

Edhe kur të shkojë për të qepur një rrobë, fëmija duhet të gjejë botën e vet te rrobaqepësi. Edhe te berberi fëmija duhet të shohë njeriun që e fillon punën me emrin e Zotit!

Ndërkaq, të gjitha këto nuk duhen kuptuar si kërkesë për ta shkëputur fëmijën nga njerëzit. Këtu është fjala për të treguar ndjeshmërinë dhe vëmendjen e duhur për këto çështje që lidhen me formimin dhe të ardhmen e fëmijës.

Këtu dëshiroj të ndalem edhe mbi një çështje tjetër. Vajtja në gëzimet apo hidhërimet e të tjerëve është një detyrë fetare. Profeti Muhamed (s.a.s.) na porositi: "Kur t'ju ftojnë në një dasmë apo fejesë, përgjigjiuni ftësës!"¹⁰⁹ Është e qartë se kjo porosi e Profetit nuk mund të kundërshtohet. Por edhe të mos shkosh në një dasmë ku ka gjëra të këqija dhe kryhen mëkate, është një parim fetar dhe një detyrë fetare. Po qe se bëhet fjalë për situata ku fëmija prishet me ato që sheh dhe dëgjon mendime që ia turbullojnë mendimet, sigurisht që askush s' duhet të shkojë.

d) Zgjedhja e programeve televizive që do të shohë fëmija juaj

Besimtari që ka televizion në shtëpi, duhet t'i zgjedhë me kujdes programet që do të ndjekin fëmijët. Nuk themi se ka faj ose bën mëkat televizioni. Gjithashtu, fjalët tona nuk duhen kuptuar si kundërvënie ndaj televizionit. Vetëm se edukimi e kërkon domosdoshmërisht zgjedhjen e programeve televizive. Është fakt që disa emisione e tronditin mendimin moral-etik dhe besimor të rinisë dhe e nxijnë botën e tyre shpirtërore. Prandaj, nëse në shtëpinë tuaj shihet ende një kanal

¹⁰⁹Muslim, *nikah*, 98, 101; Ibni Maxhe, *nikah*, 25.

televiziv, megjithëse ai i ka shpallur luftë moralit tuaj, prishja e moralit të familjes suaj, duke filluar që me fëmijët, bëhet e pashmangshme.

Këto fjalë të mia kurrsesi nuk duhet të krijojnë opinionin se ne jemi kundër shkencës, zhvillimit, përparimit, teknikës. Ne përkrahim përdorimin e teknikës në shërbim të lumturisë dhe qetësisë së njerëzimit. Ne duhet të përfitojmë patjetër nga dhuntitë që na ka falur Allahu, si mendimi, arsyeja, kultura, arti, shëndetësia, mjekësia, etj. Zgjedhja e kanaleve televizive ose, më saktë, mospranimi për të ndjekur çdo lloj kanali nuk është shenjë prapambetjeje, ashtu siç nuk është shenjë përparimi ndjekja e kanaleve dhe programeve me përmbajtje shkatërruese për brezat e rinj.

e) Rritja e fëmijëve me edukatë kuranore

Është përsëri detyrë e prindërve, mësuesve dhe edukatorëve që të mos u lënë hapësirë zemrës, kokës, veshit, syrit dhe ndjenjave të tjera të fëmijës që të mësohen me mëkatin, i cili përshtatet pothuaj në çdo mjedis, që të sigurojnë rritjen dhe zhvillimin e tij në një mjedis krejt të pastër, që të përpiqen për t'u siguruar fëmijëve edhe jashtë atë atmosferë fetare me të cilën janë mësuar në familje, që të përpiqen për të siguruar përputhshmërinë e mjedisit të jashtëm me atë familjar.

Në të vërtetë, në një kohë kur të gjitha forcat përdoren si elemente shtypjeje dhe kur e Vërteta merret nëpër këmbë, mbrojtja e orientimit dhe e dinjitetit të të qenit njeri kanë rëndësi të madhe. Mendoj se, për këtë arsye, edukimi i brezit me edukatën kuranore dhe pajisja e tij me moralin kuranor për ta sjellë atë si përkrahës të gjithëhershëm të së Vërtetës, përgatitja e tij në atë nivel që të mos lëkundet as para forcave më të papërballueshme, është parimi më i rëndësishëm i ekzistencës sonë kombëtare. Në përgjithësi, shoqëria ideale si në botën e ndjenjave e të ndërgjegjes, ashtu dhe në botën e realiteteve, është realizuar vetëm në saje të Kuranit!

Morali i Profetit tonë (s.a.s.) ka qenë Kurani, karakteri dhe temperament i tij, Kurani. Edhe ata që e ndiqnin atë, Kuran dëgjonin, Kuranit i jepnin zë dhe me të jetonin e përparonin. Ata që duken se janë të lidhur me Kuranin, por nuk shfaqin dot një përsosmëri të tillë, janë shpirtira sipërfaqësore dhe mendime sipërfaqësore, që nuk e kanë përvetësuar dot frymën e Tij!

Ta kuptosh Kuranin dhe të ripërtërihesh me të, varet nga thellimi në thelbin e Tij. Ata që merren vetëm me fjalët dhe shprehjet e tij, Allahu e di, edhe nëse fitojnë shpërblim, mirësi, nuk mund të bëhen një shoqëri e hapur ndaj mirësisë. Çështja jonë thelbësore përsa i përket lidhjeve dhe marrëdhënieve me Kuranin, është të orientohemi kah ai me zemrën, vetëdijen, vullnetin, njohjen dhe ndjenjat tona për ta ndjerë atë me të gjitha përmasat e qenies sonë.

4. Ta vazhdosh edukimin me po të njëjtën ndjeshmëri

Ta bësh një të vërtetë, një mendim, të zërë vend, është tjetër gjë, dhe t'i japësh vazhdimësi, tjetër gjë. Po, është shumë e rëndësishme ta ndërtosh diçka, por më e rëndësishme se kjo, është t'i japësh qëndrueshmëri asaj dhe ta zhvillosh edhe më tej.

a) Jo pasardhës i keq!

Në Kuran ka ajete që na flasin për disa profetë me radhë:

"Kujtoje në Libër edhe Merjemin! Kujtoje në Libër edhe Ibrahimin! Kujtoje në Libër edhe Musanë! Kujtoje në Libër edhe Ismailin! Kujtoje në Libër edhe Idrisin!..."¹¹⁰

Pasi tregon për veçoritë e këtyre njerëzve të zgjedhur dhe epokat që hapën ata, Kurani vazhdon kështu:

"Më në fund, pas tyre erdhi një brez i tillë që e prishën namazin dhe shkuan pas dëshirave. Ja, prandaj do të vuajnë në të ardhmen ndëshkimin e perversëve dhe mëkatarëve!"¹¹¹

¹¹⁰Merjem: 16, 41, 51, 54, 56.

¹¹¹Po aty: 59.

Në bazë të çështjes mund të jetë Nuhu i nderuar (a.s.), Ademi, Musai, Mesihu (a.s.), por edhe Hz. Muhamedi (s.a.s.). Po qe se ata që kanë ardhur pas tyre, kanë qenë pasardhës të këqij të tyre, domethënë, e kundërta e tyre, që e kanë prishur namazin (vini re, jo e kanë lënë, por e kanë prishur), që janë dhënë pas dëshirave trupore e materiale, që kanë jetuar sipas dëshirave, iluzioneve dhe pasioneve të tyre, e kanë pasur të pamundur të përfitojnë nga njerëzit e mëdhenj që kanë pasur në krye të rrugës së tyre!

Edhe ne ndodhemi po në atë pikë ku ndodheshin ata para nesh që humbën: një Islam pa namaz meqë namazi na vjen i rëndë, pa agjërime meqë agjërimi është i vështirë, dhe një botëkuptim fetar që nuk njih kufi në plotësimin e dëshirave trupore!

Kurse besimtari është, me të gjithë qenien dhe në të gjitha situatat, përfaqësuesi edhe i besimit, edhe i sigurisë, edhe i nënshtrimit ndaj Zotit! Sigurisht, ai, ashtu siç i beson Allahut, edhe përthyeret më dysh para Tij, edhe dridhet para ndalimeve të Tij!

b) Rëndësia e faljes së namazit

Në një deklaratë të tij të bekuar, Profeti (s.a.s.) thotë:

*“Ai që e fal namazin, që drejtohet nga kiblja jonë dhe ha nga ajo që therim ne, është prej nesh!”*¹¹² Dhe, tani, ju lutem ejani dhe mendojeni pak të kundërtën e kësaj!

Të kujt do t'i quani ju ata njerëz që s'vënë ballin në sexhde, që e kanë ndërgjegjen të ndryshkur, që nuk kanë respekt për të tjerët, që shkaktojnë anarki, që veprojnë si armiq të rregullit, etj.? Quajini të kujt të doni, por ata s'kanë vend brenda rrethit të shenjtë të Profetit Muhamed (s.a.s.)!

Po, namazi është shumë i rëndësishëm. Edhe ne duhet të jemi syçelë në këtë drejtim. Atë që s'fal namaz, Profeti e pati treguar si njeri të mbetur në mes të rrugës. Pa le kur bëhet fjalë për besimin! Duke shkuar në një fushatë, dikush i pati propozuar ndihmë Profetit tonë. Dhe Profeti e pati pyetur: *“A beson ti?”* Njeriu i pati thënë se nuk besonte. Atëherë Profeti i qe kthyer: *“Nuk ka ç'më duhet ndihma jote!”*¹¹³

Sepse besimi është një anije që të çon përherë në bregun e shpëtimit, ndërsa namazi është pjesa e saj më e rëndësishme. Siç shprehet edhe M. Lutfi Efendiu: *“Namazi është shtylla e fesë, drit'e saj, është namazi ai që e vë në lëvizje anijen e fesë, prijës mbi adhurime është ai...”*

Kurse në një hadith tjetër, Profeti (s.a.s.) thotë:

*“Namazi që u duket më i rëndë hipokritëve (dyfytirëve), është namazi i agimit dhe jacisë!”*¹¹⁴

Po ne, a mundemi t'i falim me përkushtimin e duhur këto dy namaze? Sa për mua, qëndrimi i vërtetë kundërvënës ndaj ndjenjës së hipokrizisë (hezitimit) është përkushtimi i plotë në namaz!

¹¹²Buhariu, *salat*, 28; Tirmidhiu, *iman*, 2; Nesai, *iman*, 9.

¹¹³Muslim, *xhihad*, 150; Tirmidhiu, *sijer*, 10.

¹¹⁴Buhari, *ezan*, 34; *meuakit*, 20; Muslim, *mesaxhid*, 252.

PJESA E SHTATË

*Krahasimi mes edukatës kuranore
dhe asaj jo-kuranore*

Krahasimi mes edukatës kuranore dhe asaj jo-kuranore

Brezi ynë ka sot dy alternativa: ose të bëhet i pashpirt, i ashpër dhe mizor me anë të ideve filozofike të gabuara, me anë të rrymave të këqija dhe ekstreme si dhe me anë të parimeve filozofike, ose i çmuar, me horizont dhe i mëshirshëm me anë të parimeve të larta hyjnore e të Kuranit.

Në këtë pjesë, duke e ndarë edukimin dhe edukatën në edukim dhe edukatë jo-kuranore, në njërën anë, dhe edukim dhe edukatë kuranore, në anën tjetër, do të bëjmë përshkrimin e cilësive të tyre, saora edhe krahasimin mes tyre.

1. Edukata dhe edukimi jo-kuranor

a) I faraonizon njerëzit

Siç është shfaqur gjer më sot, edukata jo-kuranore i ka bërë njerëzit, brenda poshtërsisë së tyre, nga një faraon potencial më vete. Faraonizmi ka dy forma. Njëra formë është faraonizmi i fuqishëm, i cili, duke qenë i tillë, është ekspansiv, dhunues, mizor dhe egoist. Kurse forma e dytë, faraonizmi i dobët, i mjerë, i pafuqishëm, i cili, duke qenë i tillë, është i ulët e banal sa t'u puthë këmbët të tjerëve.

Këtu nuk është fjala për faraonët e Egjiptit, por për figurën e përgjithësuar faraonike si simbol i gjithçkaje të keqe e të ulët.

Psikologjinë perverse të njerëzve të faraonizuar, duke marrë për model faraonin e profetit Musa (a.s.), Kurani e përshkruan kështu:

"I mblodhi menjëherë njerëzit e tij dhe u bërtiti: "Unë jam Zoti juaj më i lartë!"¹¹⁵

Ky është faraoni i fuqishëm, mendjemadh, egoist dhe mizor. Të tillë kanë qenë dhe janë edhe të gjithë njerëzit e faraonizuar kur e ndjejnë veten të fuqishëm.

Por ai na shfaqet edhe në një gjendje tjetër, kur ka rënë në mjerim, kur i rrezikohet jeta, kur i ka humbur e gjithë fuqia, për çka dhe është gati t'i bjerë kujtdo ndër këmbë. Ja si e përshkruan Kurani atë:

"Ne i kaluam të bijtë e Izraelit nëpër det. Kurse faraoni me ushtrinë e tij i ndoqi ata për t'i kapur dhe ndëshkuar. Por, kur e pa se po mbytej, tha: "Edhe unë besova se s'ka zot tjetër veç Zotit që besojnë të bijtë e Izraelit! Edhe unë jam mysliman!"¹¹⁶

Kuptohet menjëherë se faraoni nuk është i sinqertë në thënien e tij. Për të shpëtuar kokën, ai është gati të mohojë gjithçka që ka thënë më parë. Ai e ka humbur çdo lloj krenarie, brutaliteti a egoizmi. Ky është çasti i poshtërimit të tij. Ja, ky është një faraonizëm tipik, është forma e faraonizmit të mjerë!

Ndërkaq, në jetë hasen raste jotipike e kalimtare si të cilësive faraonike, ashtu dhe cilësive të mira si të Musait (a.s.) i cili përbën, në këtë rast, të kundërtën e faraonit. Disa herë, te një besimtar mund të ketë ose të shfaqen cilësi faraonike, kurse te një mohues, cilësi prej Musai. Allahu (xh.xh.) sheh esencën e njeriut, atë që është e përhershme dhe e qëndrueshme te njeriu. Me këtë esencë njeriu shfaqet dhe vlerësohet edhe prej njerëzve të tjerë. Në lidhje me këtë, Profeti thotë:

"Allahu nuk sheh as trupin, as paraqitjen tuaj, Ai vështron zemrat dhe aktet tuaja!"¹¹⁷

b) I bën njerëzit kryeneçë dhe të ashpër

Njeriu i formuar me një edukatë jo-kuranore është inatçi, kryeneç dhe krenar. Për atë kanë rëndësi dinjiteti personal dhe krenaria, për të cilat ai është gati të marrë nëpër këmbë pa u lëkundur sa e sa të drejta, sa e sa vlera! Mirëpo ndjenja e këmbënguljes që nuk duhet ngatërruar me kryeneçësinë egoiste, i është dhënë njeriut për t'u bërë i vendosur në të drejtën dhe çështjen e tij.

¹¹⁵ Naziat: 23-24.

¹¹⁶ Junus: 90.

¹¹⁷ Muslim, *birr*, 32-33; Ibni Maxhe, *zuhd*, 9.

c) Bazohet mbi interes

Synimi i edukatës jo-kuranore është interesi. Thelbi i të gjithë luftës që bën njeriu, është interesi. Njerëz të tillë të pyesin: “Cili është fitimi prej kësaj pune?”

Në edukatën jo-kuranore bëhet fjalë vetëm për të mbushur barkun e për të kënaqur dëshirat. Lumturia e njerëzimit në optikën e kësaj edukate është veç plotësimi dhe kënaqja e kërkesave dhe dëshirave materiale-trupore.

Disa vende si Amerika, Gjermania, Anglia, Franca, Suedia, Zvicra, Norvegjia, Holanda mund të mendojnë se e kanë rregulluar ekonominë dhe i kanë siguruar lumturinë shoqërisë së tyre. Sipas tyre, ata kanë realizuar botën ideale të përshkruar nga shkrimtarët utopistë. Kjo quhet filozofia e ngushëllimit që i vlen vetëm individit që i ka plotësuar kërkesat dhe dëshirat personale dhe s’mendon për të tjerët. Në të vërtetë, shoqëria e tyre tronditet çdo ditë nga vetëvrasjet dhe sëmundjet e ndryshme shoqërore.

d) Jeta e njerëzve të formuar me edukatën jashtëkuranore mbështetet në luftën, dialektikën dhe demagogjinë

Meqë interesi karakterizohet nga përjashtimi, pra që nuk është ngopës për gjithçka dhe për të gjithë, rezultati imediat i tij është përfytyrja, lufta mes gjithë elementëve që e synojnë atë. Çdo shoqëri që ka për synim interesin, meqë nuk i plotëson dot kurrë ato që kërkon, i futet një rrugë të pafund lufte e përlëshjeje. Të gjitha sistemet e bazuara mbi interesa, nga kapitalizmi në komunizëm, nga socializmi në fashizëm, të gjitha *izmat* bazohen mbi luftën e interesave.

Biologët materialistë mes të cilëve spikat Darvini me teorinë e tij të seleksionit natyror, nëpërmjet luftës së ashpër për ekzistencë, e shohin luftën biologjike si thelbin e jetës, dhe kur kjo luftë shtrihet edhe në shoqërinë njerëzore, asgjësimi i njëri-tjetrit shihet si diçka legjitime.

e) Lidhjet ndërkombëtare janë racizmi dhe shovinizmi

Lidhja më e rëndësishme mes individëve dhe kombeve, e pranuar nga edukata jo-kuranore, është racizmi banal, internacionalizmi dhe shovinizmi. Në fakt, racizmi, shovinizmi dhe rryma të ngjashme me këto janë planifikuar sipas parimit për t’i përvetësuar dhe asimiluar të tjerët dhe ashtu kanë vepruar. Për shembull, në synim të komunizmit është mundja dhe asimilimi i të gjitha sistemeve të tjera. Historia e afërt tregon se fashizmi dhe nazizmi patën planifikuar sundimin në të gjithë botën. Këtë e vërtetuan edhe shkaqet e shpërthimit të dy luftërave botërore dhe përfundimet e tyre.

f) Si parim mban forcën

Pikëmbështetja në sistemet sociale dhe filozofike jo-kuranore është forca. E drejta është me atë që ka forcën në dorë ose i forti ka gjithmonë të drejtë. Ky është haptazi një moral faraonik. Veprimi i forcës që nuk respekton vlerat njerëzore, është dhunë, përdhunim. Një njeri që e trajton çështjen sipas parimit të forcës, që e lidh çdo gjë me forcën, e ka shumë të vështirë ta ruajë veten nga përdorimi i dhunës. Njerëzimi përjetoi shembujt e kësaj në masë veçanërisht në shekullin XX. Në këtë shekull s’bëhej fjalë më për ekspansionin dhe dhunën e individëve. Edhe popujt nisën të vepronin me instinktin e asgjësimit të njëri-tjetrit.

2. Edukata kuranore

a) Nxënësi i Kuranit është një rob i Zotit

Nxënësi i Kuranit është vetëm një njeri, një krijesë, një rob i Zotit. Ai nuk është mizor, dhunues, i ashpër, i egër apo egoist. Kurani e thekson në çdo rast se njerëzit janë rob të Allahut dhe se kjo është një nder për ta. Edhe njëri prej attributeve kryesore të Profetit tonë të Dashur (s.a.s.) është të qenët rob i Allahut. Në Fjalën e Dëshmisë ai përmendet si Robi dhe i Dërguari i Allahut. Ndërkaq, atributi si rob i Allahut është i përhershëm. Ai që i tillë para se të bëhej profet dhe vazhdoi të mbetej i tillë edhe pasi e kreu detyrën e

profetësisë. Çdo gjë është kalimtare dhe mbaron. Vetëm një gjë nuk mbaron: të qenët rob ndaj Allahut që është i pafillim e i pambarim!

Allahu i fton njerëzit: *“O njerëz! Bëjuni rob vetëm Allahut (adhurojeni vetëm Allahun)...”* Dhe besimtarët, dyzet herë në ditë i thonë Atij: *“Vetëm Ty të adhurojmë (vetëm Ty të bëhemi rob)!”*

Një besimtar i mirë është një rob i shtrenjtë që nuk ndjen nevojën që t'i përulet as një krijese tjetër. Ai është vetëm rob i Allahut, dhe i askujt tjetër. Edhe në çaste kur kur duket si i mjeruar është një mbret më vete. As nuk i përulet assesi asnjë faraoni, që për të marrë shembuj ideal i mjaftojnë shembujt e pafundmë nga jeta e profetëve. Ata e kanë njohur Allahun (xh.sh.) si Të Adhuroarin Absolut dhe si Qëllimin e Vetëm kënaqësinë e Tij.

Nëse do të udhëtonit me imagjinatë deri në kohën e profetësisë do të shihni Amar bin Jasirin që i vendoset sipër hekuri i nxehur flakë, do të shihni Musab bin Umejrin që e shtrojnë përdhe duke e goditur me drurë të trashë. Do të shihni Sad bin Ebi Uakasin tek përpëlitet nga etja dhe uria e padurueshme.

Janë disa gjëra që mund të duket se disa gjëra të tjera. Të hapësh shoqata, të grumbullosh njerëz, të organizosh kongrese, të bësh punë të ndërvarura prej pagesave ose interesash të tjerë materialë... këto janë gjëra tejet të lehta për t'u realizuar. E vështirë, por e rëndësishme është ta ngresh sipër pishtarin e së drejtës dhe të vërtetës pa i hyrë kurrfarë dëshire materiale apo shpirtërore. Andaj, synimi kryesor, që na bie si detyrë është të përgatisim breza faqebardhë që nuk kërkojnë asgjë kundrejt arritjes së drejtësisë në vend të vet, pa i njohur vetes asnjëlloj përfitimi pos vetëdijes se janë robër të Allahut (xh.xh.).

b) Nxënësi i Kuranit është i thjeshtë, dhe i varfër para Allahut

Nxënësi i Kuranit është i thjeshtë, modest. Në pamje të jashtme ai mund të duket si i ngratë, si i përgjumur, por s'është ashtu. Ai është i butë dhe i urtë, por i vyer dhe i vendosur saqë të mos i përulet dhe nënshtrohet askujt tjetër veç Zotit të vet. Ai zotëron një dinamizëm të brendshëm. Në u duktë i varfër dhe i dobët nga jashtë, këto cilësi janë krahë për të për t'u ngjitur te Zoti. Sa më shumë ta ndjejë ai varfërinë dhe dobësinë në ndërgjegjen e vet, aq më shumë i rritet bindja ndaj Zotit.

Profeti thotë: *“O Zot, gjersa të mbyllim sytë, mos na lër vetëm për vetëm me veten tonë!”*¹¹⁸ Ja, pra kjo thellësi e brendshme e dobësisë për të është si krahë prej drite me të cilat vrapon pas Zotit duke kërkuar vetëm pëlqimin e Tij!

c) Synimi i vetëm i nxënësit të Kuranit është kënaqësia e Allahut

Synimi i nxënësit të Kuranit është vetëm e vetëm kënaqësia e Allahut. Ai e mban vështrimin vazhdimisht te pëlqimi hyjnor duke pritur ftesën e prejandëjshme: *“O ti shpirt i kënaqur e i qetësuar, kthehu te Zoti yt i kënaqur prej teje dhe ti i kënaqur prej Tij!”*¹¹⁹

Jusufi i nderuar (a.s.) lutej: *“Zoti im, ma dhe pjesën time nga pasuria dhe më mësove t'i shpjegoj ëndrrat. O ti, krijuesi i qiejve e i tokës! Ti je Zoti im në këtë botë e në jetën tjetër! Bëmë të vdes si mysliman dhe më bashko me njerëzit e mirë!”*¹²⁰

Me këto fjalë e shprehte ai idealin e vet.

Kjo do të thotë se është një meritë që qëndron gjithmonë mbi tërë mirëqenien dhe lumturinë e kësaj bote, që e kënaq plotësisht zemrën, e cila nuk është tjetër pos kënaqësisë dhe pëlqimit të Zotit!

Në Kuran thuhet: *“Unë u urdhërova që ta adhuroj vetëm Allahun duke ia kushtuar gjithçka vetëm Atij!”*¹²¹

*“Thuaj: “Unë i bëhem rob vetëm Allahut duke ia kushtuar adhurimin tim vetëm Atij!”*¹²²

*“Kurse ata qenë urdhëruar që të largohen nga politeizmi (shirku) dhe ta adhurojnë vetëm Allahun që është një i vetëm, ta falin namazin dhe ta japin zekatin!”*¹²³

¹¹⁸Ebu Davud, *edeb*, 101; Ahmed bin Hanbel, *musned*, 5/42.

¹¹⁹Fexhr: 27.

¹²⁰Jusuf: 101.

¹²¹Zumer: 11.

¹²²Po aty: 14.

Me këto fjalë besimtari është gjithmonë i orientuar për të kërkuar pëlqimin hyjnor.

d) Parimi i jetës për të është ndihma reciproke

Kurani thotë: *“Ndihamoni njëri-tjetrin për të mirë dhe duke u ruajtur (nga ndalimet e Allahut), jo për të keqe, për mëkat dhe armiqësi. Dhe kini frikë Allahun sepse ndëshkimi i Allahut është i ashpër!”*¹²⁴

Besimtarët duhet ta ndihmojnë njëri-tjetrin për t'i zbatuar urdhërimet dhe ndalimet e fesë dhe, duke u mbështetur te njëri-tjetri, duhet të përpiqen ta jetojnë fenë. Nuk duhet të harrojmë se aspekti shoqëror i islamit ka më shumë peshë. Aspekti shoqëror i islamit synon ta ngrejë njeriun në këmbë, ta mbajë në këmbë dhe t'i japë vazhdimësi. Kurani thotë: *“Ndihamojeni njëri-tjetrin në mirësi dhe devocion!..”*¹²⁵

Jeta nuk përbëhet prej luftës dhe armiqësisë, por prej ndihmës së dyanshme dhe mbështetjes te njëri-tjetri. Molekulat ndihmojnë bimësinë, bimësia kafshët, kurse kafshët, si konserva proteinash, na vijnë në ndihmë neve. Atomet dhe molekulat e ajrit, dheut, ujit e vazhdojnë ekzistencën e tyre të lidhura mes tyre sipas idesë së plotësimit të njëra-tjetrës.

Besimtari e sheh gjithësinë si një harmoni ndihme reciproke dhe thotë: *“Nga kreu në fund, gjithësia s'është gjë tjetër veçse një ndihmë reciproke mes pjesëve përbërëse të saj!”* Atëherë, edhe njeriu duhet t'i përshtatet harmonisë së përgjithshme të gjithësisë duke vrapuar për ndihmë, me qëllim për të mos e prishur këtë simfoni, këtë melodi të përgjithshme!

e) Lidhja jonë është lidhje vëllazërie

Kurani e përcakton si vëllazëri lidhjen mes besimtarëve myslimanë.

Kjo lloj lidhjeje duhet ngritur mes të gjithë myslimanëve dhe sipas kësaj lidhjeje duhet theksuar edhe një herë ndjenja e vëllazërisë. *“Besimtarët janë vëllazër”* – thekson Kurani.¹²⁶ Besimtari duhet ta shohë si vëlla këdo që beson, kurse gjithësinë, si një vend vëllazërie.

f) Ideja e të drejtës është parim më vete

Edukata kuranore pranon si pikëmbështetje ekuivalencën e drejtë-forcë. Është i fortë ai që ka të drejtë. Forca buron nga e drejta dhe jo e drejta nga forca. Islami thotë: *“Kush ka të drejtë, është i fortë!”* Myslimani, edhe në qoftë i dobët sot, jeton me besimin dhe bindjen se nëmos sot, nesër, me ndihmën dhe mirësinë e Allahut, e drejta do të fitojë!

Kështu, në historinë e Islamit ka ndodhur që një kalif i fuqishëm si Omeri i nderuar të dalë para gjyqit për t'u gjykuar në bazë të ankesës së një njeriu të thjeshtë, sepse, në vështrimin e myslimanit, respekti ndaj së drejtës së dikujt, kushdoqoftë ai, është respekt ndaj Zotit!

Besimtari që nuk ka hyrë në ndikimin e sistemeve filozofike jo-kuranore, vepron siç parashikohet në Kuran, duke jetuar me të drejtë dhe duke këshilluar për drejtësi:

*“Pasha kohën! Pa dyshim, njeriu është në humbje, veç atyre që besojnë, bëjnë punë të mira dhe këshillojnë njëri-tjetrin për drejtësi dhe durim!”*¹²⁷ Materia ekziston në saje të qenies së të Drejtës. Drejtësia është një nga emrat më të mëdhenj ndër emrat hyjnorë.

Besimtari e sheh forcën vetëm te e drejta. Kush ka të drejtë, është i fortë. E drejta është e lartë dhe asgjë nuk mund ta pengojë atë!

¹²³ Bejjine: 5.

¹²⁴ Maide: 2.

¹²⁵ Po aty.

¹²⁶ Huxhurat: 10.

¹²⁷ Asr: 1-3.

PJESA E TETË

Pasthënie nga Kriteret ose Dritat e Rrugës

Pasthënie me fragmente të zgjedhura nga “Kriteret ose Dritat e Rrugës”

Këtu, në vend të pasthënies, me fragmente të zgjedhura nga libri ynë, *Kriteret ose Dritat e Rrugës*, po bëjmë një ilustrim të mendimeve që parashtriam në këtë libër mbi edukimin familjar.

Fëmija

Ç’vlerë të ketë fara për vazhdimësinë e llojit dhe brezit të një peme, po atë vlerë ka edhe fëmija për vazhdimësinë e llojit dhe brezit të njeriut. Kombet që i lënë pas dore fëmijët, janë të destinuar të shemben, kurse kombet që i braktisin ata në duar të huaja e nën ndikimin e kulturave të huaja, janë të destinuar të humbasin origjinën!..

* * *

Brezi që e përbën pjesën më aktive e më produktive të një kombi në çdo tridhjetë-dyzet vjet, janë fëmijët e sotshëm. Ata që i shohin fëmijët si të vegjël e të pavlerë, duhet ta kuptojnë dhe të rrëqethen se me sa mendjelehtësi e morën një element të rëndësishëm në jetën e një kombi!

* * *

Përgjegjësit e të keqes që duket në brezat e sotëm, paaftësinë e vëzhguar në një pjesë administratorësh dhe shqetësimeve të hequra si komb, janë elementet sunduese të tridhjetë viteve më parë. Edhe fatkeqësitë apo vlerat e një çerek shekulli më vonë do t’u përkasin atyre që e kanë në dorë arsimimin dhe edukimin e brezave të sotëm.

* * *

Çdo komb që kërkon ta marrë nën garanci të ardhmen e vet, duhet t’i shpenzojë një pjesë mundësish sa energjitë dhe koha që ka për të shpenzuar majtas e djathtas, për përgatitjen e fëmijëve, njerëzve të mëdhenj të së nesërme.

* * *

Mjerranët, ngatërrestarët, sarhoshët, anarkistët, të droguarit, morfinomanët, të cilët konsiderohen sot si fytyra e zezë e shoqërisë, janë fëmijët, edukimin e të cilëve e lamë pas dore dhe... S’e di, a jemi vënë të mendojmë ndonjëherë se ç’lloj njerëzish do të na i mbushin rrugët nesër si pasojë e mospërfilljes sonë të sotme?

Martesa dhe foleja familjare

Martesa nuk është për kënaqësi e dëfrim. Martesa bëhet për të ndërtuar familjen, për të siguruar vazhdimësinë dhe pavdekësinë e kombit, për t’i shpëtuar mendimet dhe ndjenjat e individit nga hallakatja, për t’i marrë nën kontroll dëshirat trupore. Ndërkaq, ashtu si edhe në shumë çështje të tjera të krijimit, dëshirat dhe kënaqësitë fizike janë një përparësi dhe element nxitës...

* * *

Personat që do të martohen, nuk duhet të vendosin sipas veshjes e mbathjes së njëri-tjetrit, madje as sipas pasurisë dhe bukurisë; në këtë çështje tepër serioze, duhet të vendosin sipas bukurisë shpirtërore, kuptimit të moralit dhe nderit, virtytit dhe lartësisë së karakterit...

* * *

Për ata që, duke u martuar, nuk kanë bërë dot analizën e nevojshme ose nuk kanë gjetur rastin për ta bërë, kur të vijë puna në prag të ndarjes, nuk kanë për t’u vlejtur as dhe kriteret më të mençura. Sigurisht, çështja nuk është të shpëtohet foleja familjare nga zjarri me sa më pak dëme; e rëndësishme është të mos futen në familje elementet me rrezik zjarri!..

* * *

Nuk duhet t'u japim vajzë njerëzve që s'i njohim dhe nuk duhet të kërkojmë vajza që nuk i njohim. Marrëveshja e bërë bazuar mbi të panjohura të tilla, ose finalizohet me një rezultat si ndarja që Allahu s'e pëlqen, ose bëhet shkak torturash për palët, për gjithë jetën!..

* * *

Ka fole familjare të bekuara, të ngritura mbi logjikën dhe gjykimin duke u mbështetur qysh në hapat e para te Zoti, që funksionojnë gjatë gjithë jetës si një shkollë dhe, me nxënësit që përgatisin, sigurojnë vazhdimësinë dhe pavdekësinë e kombit që i përkasin!

* * *

Martesat e bëra për martesë, pa u menduar e peshuar dhe bashkëjetesat e këtij lloji janë finalizuar me bashkëshortë që qajnë e zvarriten nëpër rrugë, me jetimë të braktisur në jetimore e me kriminelë që i plagosin familjet në zemër...

* * *

Nëse interesi dhe dobia e martesës për individin është një, interesat dhe dobitë e saj për kombin janë të shumta. Nisur nga kjo, si martesa e prishur, ashtu dhe ndenjja pa u martuar fare janë një kolerë që i turpëron djemtë, i zhyt vajzat në mjerim dhe kombit i shkakton hemorragji...

* * *

Foleja familjare e themeluar qysh në krye mbi parime të shëndosha e ku sundon lumturia materiale-shpirtërore, është guri themelor më i shëndoshë i ekzistencës si komb dhe një shkollë e bekuar ku përgatiten individë të virtytshëm e të vlefshëm. Kombet që i bëjnë shtëpitë të begatshme sa dhe shkollat dhe shkollat, të ngrohta sa dhe foletë familjare, quhet se kanë realizuar reformën më të madhe dhe kanë vënë nën garanci qetësinë dhe lumturinë e brezave të ardhshëm...

* * *

Kombi formohet prej shtëpive. Kështu, po qe se shtëpitë janë mirë, edhe kombi është mirë; po qe se shtëpitë janë keq, edhe kombi është keq! Sikur ata që kërkojnë paqen e kombit, të përpiqeshin së pari për paqen e familjeve!..

* * *

Shtëpisë i thuhet "shtëpi" sipas njerëzve që jetojnë atje. Pjesëtarët e një shtëpie quhen të lumtur me aq sa ndajnë mes tyre vlera njerëzore. Po, mund të themi se njeriu rron si njeri në saje të shtëpisë; edhe shtëpia bëhet shtëpi kur ka brenda njerëz!..

* * *

Familja është një komb i vogël, kurse kombi, një familje e madhe. Një person që ka mundur të arrijë me sukses ta qeverisë një familje të madhe a të vogël si dhe t'i ngrrejë pjesëtarët e saj në nivele të larta njerëzore, mund të bëhet i suksesshëm me pak përpjekje edhe në organizime më të mëdha...

* * *

Çrregullimi dhe shpërbërja në një shtëpi tregon çorientimin dhe shkatërrimin shpirtëror të pjesëtarëve të asaj shtëpie; fëlliqësia, parregullsia dhe çrregullimi i shtëpive, dyqaneve dhe rrugëve të një vendbanimi, gjithashtu, është tregues i nivelit kulturor dhe të interesimit e kuadrit të pushtetit për punën...

Prindërit

Prindërit janë të parat qenie që njeriu duhet t'i respektojë. Kush e lë mangët respektin për ta, quhet se ka kundërshtuar Zotin. Kush i trajton keq ata, herët a vonë ka për t'iu nënshtruar vetë trajtimit të keq...

* * *

Nga dita kur njeriu fillon të ekzistojë si një qenie ende e vogël, zhvillohet vazhdimisht si një barrë në supet e prindërve. Lidhur me këtë, është krejt e pamundur të përcaktohet e vlerësohet thellësia e dhembshurisë qoftë e nënës, qoftë e babait ndaj fëmijës, kufiri i shqetësimeve që heqin ata. Nisur nga kjo, respekti për ta është jo vetëm një detyrim njerëzor, por edhe një detyrë që duhet kryer.

* * *

Ata që, duke e ditur vlerën e prindërve, i konsiderojnë ata si pretekst për të fituar mëshirën e Zotit, janë ndër më fatlumët si në këtë botë, ashtu edhe përtej. Kurse ata që duke ua përbuzur qenien, tregojnë bezdi ndaj jetës së tyre, janë ca fatkëqinj të paracaktuar për t'u hequr zvarrë, në këtë botë e përtej...

* * *

Njeriu quhet se e respekton Zotin po aq sa i respekton edhe prindërit. Kush s'ka respekt për ta, s'ka respekt as për Zotin. Sa çudi që, në ditët tona, tregohen krejt të parespektueshëm ndaj prindërve jo vetëm ata që s'kanë respekt për Zotin, por edhe ata që pretendojnë (me fjalë) se e duan Atë!

* * *

Fëmija duhet të jetë jashtëzakonisht i respektueshëm e i bindur ndaj prindërve; edhe prindërit, duke i dhënë jetës shpirtërore të fëmijës po aq rëndësi sa edhe trupit dhe shëndetit të tij, duhet t'ia dorëzojnë atë sa më parë edukimit të të urtëve më të aftë. Ç'injorantë janë prindërit që e harrojnë shpirtin e fëmijës e ç'i pafat fëmija që shkon viktimë e një miopie të tillë!

* * *

Biri që i mohon të drejtat e prindërve e që ngre krye kundër tyre, është një lugat me fytyrë njeriu, kurse prindërit që s'bëjnë përpjekje për ta garantuar jetën shpirtërore të fëmijës së vet, janë ca mizorë të pamëshirshëm. Pa le ata prindër që, edhe pasi fëmija ta ketë gjetur vetë rrugën e vet e të ketë hapur krahët për fluturim, e paralizojnë...

* * *

Familja është elementi themelor i shoqërisë. Sa të respektuar të jenë pjesëtarët e familjes ndaj të drejtave dhe detyrave të njëri-tjetrit, aq e shëndoshë është shoqëria. Ndryshe, është e kotë t'i kërkosh në shoqëri dhembshurinë e respektin e humbur në familje...

Edukata dhe i riu

Edukata është një bukuri më vete dhe, te kushdo që të ndodhet, është për t'u imituar. Sigurisht, edhe nëse dikush është i paditur, po qe i edukuar, duket. Kombet e mangëta për nga kultura kombëtare e në edukatën kombëtare u ngjasin individëve injorantë, të trashë e rrugaçë, të cilët as besë nuk kanë në miqësi, as seriozitet në armiqësi! Ata që u besojnë të tillëve, gjithmonë pësojnë zhgënjim, ata që mbështeten në ta, herët a vonë mbeten pa mbështetje!

* * *

Edukatorët që s'kanë punuar si çirakë pranë një mjeshtri dhe s'kanë marrë edukatë nga një burim i shëndoshë, janë si shërbëtorë që u mbajnë pishën rrugës së të tjerëve. Paturpësia dhe përkëdhelia e dukur në fëmijët është pasojë e turbullirës së burimit ku ai është zhvilluar e zhvillohet. Parregullsia ndjesore, ideore dhe e veprimtimit në familje reflektohet e përforcuar në shpirtin e fëmijës. Dhe, natyrisht, nga ai në shoqëri...

* * *

Në shkolla, të paktën po aq sa në mësimet e tjera, duhet qëndruar mbi edukatën dhe kulturën kombëtare në mënyrë që të përgatiten breza me shpirt e karakter të shëndoshë, të cilët do ta kthejnë vendin në parajsë. Arsimimi është tjetër gjë, edukimi tjetër gjë. Shumica e njerëzve mund të bëhen arsimtarë, por janë të paktë ata që mund të bëhen me plot kuptimin e fjalës edukatorë!..

* * *

Mësimet që u jepet më pak rëndësi, në një kohë që janë më të rëndësishëm, janë kultura kombëtare dhe edukata kombëtare. Po qe se një ditë do të kthehemi për ta vënë në shfrytëzim këtë rrugë, do të kemi marrë vendimin më të qëlluar për përparimin e kombit.

* * *

Poeti është poet që në lindje. Imrul Kajsi nuk pati bërë shkollë. Ajnshtajni ikte nga shkolla, sepse mendimet i kishte të tjera. Njutoni pati marrë notë të dobët në matematikë, por teoria e tij është matematike. Kurse ne përpiqemi të trazojmë në kazanin e të tjerëve me qepshen tonë...

* * *

Shkolla e parë e fëmijëve, që e kanë shpirtin të shkëlqyer si pasqyrë e që regjistron shpejt si makinat fotografike, janë shtëpitë e veta, kurse edukatorët e parë, nënat. Përgatitja e nënave si edukatore dhe jo konsumimi i tyre majtas-djathtas është baza më e rëndësishme për ekzistencën dhe vazhdimësinë e një kombi.

* * *

I riu është fidani i forcës dhe zgjuarsisë. Po qe se edukohet e mësohet, mund të bëhet një Anté, një fuqi që u premtan zemrave ndriçim, e botës harmoni...

* * *

Shoqëria është një enë kristali, kurse të rinjtë, brenda saj si një lëng që merr formën dhe ngjyrën e enës dhe me atë duket. S'e di, apostujt e rregullit dhe harmonisë, të cilët u bëjnë thirrje atyre për përpulje dhe bindje, a janë në gjendje të kthehen e të hedhin një vështrim mbi veten e vet?..

* * *

Dëshirat u përngjajnë të ngrënave të ëmbla, kurse virtytet, të ngrënave pak të tharta a të kripura. Po qe se i riu lihet i lirë të zgjedhë, a është e nevojshme të thuhet se cilat do t'i zgjedhë e cilat do t'i lërë? Kurse ne jemi të detyruar t'i përgatisim ata si miq të virtytit e si armiq të imoralitetit dhe fëlliqësisë...

* * *

Gjer në çastin kur t'i shkohet në ndihmë me anë të edukimit, i riu është satelit i dëshirave dhe kënaqësive boshe të mjedisit ku është rritur, një i marrë e i përgjakur që sillet vërdallë diku shumë larg personalitetit dhe logjikës. Edukata e mirë që, duke e lidhur atë me të kaluarën e vet, do ta përgatisë për të ardhmen, do ta shndërrojë atë në hero të perspektivës!..

* * *

Lartësimi ose rënia poshtë e një kombi varen nga shpirti dhe vetëdija me të cilat do të pajisen brezat e tij, nga arsimit dhe edukata që do të marrin. Në kundërshtim me faktin që kombet me brezat e rinj të përgatitur mirë, janë të paracaktuar të përparojnë paprerë, regresi i kombeve që i nënvleftësojnë ata, është i pashmangshëm!..

* * *

Ata që kërkojnë të bëhen orakuj mbi të ardhmen e një kombi, po t'i hedhin sytë edukatës së dhënë të rinjve, kanë për të qenë orakuj qind përqind të saktë!..